REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

N/KRYETARI I K.K.T-së

Z. DAMIAN GJIKNURI

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Znj. TATIANA ALIKAJ

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr.31 Datë 24.08.2017

Kryetari i Bashkisë

Znj. FLORJANA KOKA

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË SARANDË

PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.3, Datë 16.10.2017

DPKZHT: **HARALLAMB KOLOI**

STUDIO KONSULENTE "DEA STUDIO" Nr.Liç. 4919/4 dhe "THYMIO PAPAYANNIS & ASSOCIATES INC"

Përmbajtja

1. PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE 5

1.1 NDARJA E TERRITORIT NË PESË SISTEME TERRITORIALE 5
1 Linjë expres interurbane 7
1 Linjë transporti detare 7
4 Linja Lokale (furgon) 7
1.2 ZONIMI SIPAS KATEGORIVE BAZË DHE NËNKATEGORIVE TË PËRDORIMIT TË PROPOZUAR TË TOKËS 8
1.3 NDARJA E TERRITORIT NË NJËSI ZHVILLIMI 21
1.4 POZICIONIMI I RRJETEVE TË INFRASTRUKTURËS SI EDHE KUSHTET TEKNIKE PËR REALIZIMIN E TYRE. 24
1.4.1 Transporti ekzistues 24
1.4.2. Infrastruktura publike ekzistuese 25
1.5 ZONAT E MBROJTURA KOMBËTARE, TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE MONUMENTEVE 37
1.6 ZONAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE URBAN 40
1.7 TIPOLOGJITË E PROPOZUARA HAPËSINORE DHE METODAT E NDËRHYRJES NË TERRITOR 43
1.8 PËRCAKTIMI I NJËSIVE QË DO T`I NËNSHTROHEN HARTIMIT TË PDV-VE SIPAS LIGJIT 50
1.9 SHPËRNDARJA E POPULLSISË DHE PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE 53
1.10 PLANI I STREHIMIT 59
1.11 PËRCAKTIMI I ZONAVE/NJËSIVE, KU DO TË ZBATOHEN INSTRUMENTAT PËR DREJTIMIN E ZHVILLIMIT SIPAS LIGJIT 61

2. PLANI I MBROJTES SË MJEDISIT 65

2.1 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E PEJZAZHIT NATYROR DHE KULTUROR 70
2.2 PARASHIKIMET PËR MBROJTJEN E ELEMENTEVE UJORE 72
2.3 PARASHIKIMET PËR SHTIMIN DHE/OSE ZGJERIMIN E HAPËSIRAVE TË GJELBRA. MBROJTJA E BIODIVERSITETIT 76
2.4 PARASHIKIMI I DY VARIANTEVE PËR ZGJIDHJE TË PROBLEMATIKËS SË EVIDENTUAR PËRSA U PËRKET HOTSPOTEVE 79
2.5 PARASHIKIMET PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË AJRIT 80
2.6 ZHURMAT DHE NDOTJA AKUSTIKE 83
2.7 PARASHIKIME PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE 83
2.8 PARASHIKIME PËR MBROJTJEN E TOKËS 84
2.9 VEPRIMI MBI ASETET E BASHKISË SARANDË/KOHEZIONI SOCIAL 84

3. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE 87

3.1 INFRASTRUKTURA PUBLIKE E PROPOZUAR 87
3.1.2 Infrastrukturë rrugore e propozuar 91
3.2 RRJETI I PROPOZUAR I INFRASTRUKTURËS SË SHËRBIMEVE PUBLIKE 95
3.2.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë 97
3.2.2 Rrjeti i propozuar i kanalizimeve 100
3.2.3 Rrjeti i energjisë elektrike dhe telekomunikacioni 107
3.2.4 Menaxhimi i mbetjeve urbane 108
3.2.5 Administrim mbetjesh dhe mbrojtja e mjedisit 109
3.2.6 Administrimi i burimeve natyrore dhe kulturore 110
3.2.7 Mbrojtje kombëtare, civile dhe kundër zjarrit 112
3.3 KONSIDERATA MBI PLANET E NIVELEVE TË TJERA DHE NDIKIMI I TYRE MBI TERRITOR 113
3.4 TIPOLOGJIA DHE SHPËRNDARJA NË TERRITOR E SHËRBIMEVE SOCIALE 115

4. PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PPV-VE 136

4.1 FAZAT E ZBATIMIT TË ZHVILLIMIT, TË NDARA NË PERIUDHA KOHORE BRENDA VLEFSHMËRISË SË PLANIT. 136
HARTA 23 – (21) FAZIMIT TË ZHVILLIMIT SIPAS NJËSIVE STRUKTURORE DHE INFRASTRUKTURAVE 143
4.2 KOSTO E PËRGJITHSHME PËR ZBATIMIN DHE AKTIVITETET KRYESORE TË FINACUARA TË SHOQËRUARA ME PLANIN E INVESTIMEVE KAPITALE. 143
4.3 NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË KUADRIN LIGJOR DHE ADMINISTRATIV NË NIVEL VENDOR 149
4.4 INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PPV-VE 150
4.5 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCËS PËR PLANET VENDORE 155
4.6 PËRCAKTIMET KRYESORE PËR TERMAT E REFERENCËS PËR PLANET SEKTORIALE 158
4.7 EVIDENTIMI I FAKTORËVE QË MUND TË SHKAKTOJNË NJË RISHIKIM TË PJESSHËM TË PPV-VE 159

5. SHTOJCA E PPV-VE 161

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

5.1. VLERËSIMET PËR PLANIN....161

6. RAPORTI PËR KAPACITETET INSTITUCIONALE....166

6.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË DEPARTAMENTIT TË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT BASHKIA SARANDË....167

6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki....168

6.1.2. Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit....169

6.1.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit....171

6.1.4 Vlerësimi i aftësive të stafit ekzistues për të vepruar në departamentin e propozuar....171

6.2 ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE MARRËVESHJET E ZBATIMIT....172

6.2.1 Përgatitja e një raporti të shkurtër, që përcakton marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim....172

6.2.2 Korniza e zbatimit, e cila përdor gjetjet nga pika 4.1 dhe identifikon fazën, në të cilën shkrihen propozime organizative, administrative dhe politike dhe/ose ndryshime që mund të prezantohen....172

7. DËGJESA ME PUBLIKUN....176

FORUMI....178

Lista e Tabelave

Tabela 1 Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale....Error! Bookmark not defined.
Tabela 2. Kategorizimi sipas Shtojcës III. VKM Nr.671....7
Tabela 3 Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë....Error! Bookmark not defined.
Tabela 4 Ndarja e territorit në njësi zhvillimi....22
Tabela 5 Kategoritë e Sistemit Rrugor....31
Tabela 6 Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në bashkinë Sarandë....37
Tabela 7 Njësitë strukturore, që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së....50
Tabela 8 Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDZRK-së....52
Tabela 9 Projeksionet e popullsisë 2011-2031, bashkia Sarandë....54
Tabela 10 Projeksionet e popullsisë 2011-2031, bashkia Sarandë....55
Tabela 11 Të dhënat për përllogaritjen e popullsisë së turizmit....56
Tabela 12. Statusi i banimit të banesës....60
Tabela 13 Kërkesat cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE-në....72
Tabela 14 Treguesit fiziko-kimikë të ujit të pijshëm....73
Tabela 15 Treguesit mikrobiologjikë të ujit të pijshëm të bashkisë Sarandë dhe objektiva....73
Tabela 16 Sipërfaqet e propozuara të zonave të mbrojtura, të trashgimisë kulturore dhe momumenteve....79
Tabela 17 Sipërfaqet e gjelbra dhe publike të shtuara....79
Tabela 18 Monitorimi i guroreve dhe rehabilitimi....80
Tabela 19 Vlerat kufi të ndotësve....81
Tabela 20 Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t'u monitoruar në bashkinë e Konispolit....81
Tabela 21 Objektivat për reduktimi e mbetjeve....84
Tabela 22 Monitorimi i tokës bujqësore....84
Tabela 23 Monitorimi i pyjeve dhe zonave të mbrojtura dhe të gjelbra....113
Tabela 24 Standardet e kërkuarapër shërbimet sociale në Shqipëri....116
Tabela 25 Projeksionet e popullsisë + Të dhënat për përllogaritjen e popullisë së turizmit....117
Tabela 26 Projeksionet e popullsisë + Të dhënat për përllogaritjen e popullisë së turizmit....125
Tabela 27 Modulet e trajnimit....173

Lista e Figurave

Figura 1 Gropa septike familjare....33
Figura 2 Humbje teknike te ujit....33
Figura 3 Sheshi Pavarësia në qytetin e Sarandës....34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 4 Bregdeti urban i Sarandës që është burimi më i vlefshëm turistik dhe hapësira më e gjallë publike e qytetit 35
Figura 5 Propozimi për vendodhjen e Qendrës Tregtare të Agrobiznesit në Sarandë 41
Figura 6 Grafiku i Projeksioneve të popullsisë për bashkinë Sarandë 54
Figura 7 Pozicioni i propozuar për strehim social 61
Figura 8 Ndërtime dhe grumbullime mbetjesh në grykëderdhjen e Bistricës 83
Figura 9 Pamje të strukturave të rritjes së midhjes në Liqenin e Butrintit 85
Figura 10 Grumbullime mbetjesh 86
Figura 11 Pozicioni i propozuar, aeroporti i Sarandës 87
Figura 12 Skema e propozuar për rigjenerimin urban për projektin Sunset Strip 89
Figura 13 Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore 96
Figura 14 Drejtimet Zhvillimit per Sistemi Infrastrukturor të Bregdetit të Jugut sipas PINS Bregdeti 114
Figura 15 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë 176
Figura 16 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë 177
Figura 17 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë 177

Lista e Hartave

Harta 1 - (18a) Pesë sistemet territoriale 8
Harta 2 - (18b) Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara 12
Harta 3-(18c.I) Nënkategoritë e përdorimit të tokës të propozuara, Sarandë Qytet 19
Harta 4 -(18c.II) Nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara, Ksamil 20
Harta 5 - (18i) Njësitë Strukturore 23
Harta 6 - (19c) Rrjeti rrugor dhe i vendparkimeve publike te propozuar 28
Harta 7 – (19e) Hapësirat publike, rrugët e biçikletave dhe këmbësore të propozuara 36
Harta 8 – (18g) Harta e objekteve dhe zonave të rëndësisë kombëtare të propozuara 39
Harta 9– (18d) Zonat, polet, korridoret ekonomike të propozuara 42
Harta 10– (18f) Harta e tipologjisë të ndërtimeve 44
Harta 11 (18f II) Harta e tipologjise së ndërtimeve 45
Harta 12 – (18e) Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar 49
Harta 13 - (18h) Zonat subjekt i PDV/PDZRK 53
Harta 14 – (18j) Shpërndarja e popullsisë dhe plani i strehimit 59
Harta 15 – (20) Instrumentat te Zhvillimit të propozuar 64
Harta 16 – (18g) Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore 69
Harta 17 – (19e) Hapesirat publike, rruget kembesore dhe te bicikleteve te proposuara 78
Harta 18 – (19g) Transporti Publik 90
Harta 19 - (19a) Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar 101
Harta 20 - (19b) Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar 106
Harta 21 - (19d) Rrjeti i furnizimit me energji të propozuar 108
Harta 22 - (2f) Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore 112
Harta 23 – (19f) Objektet e shërbimeve sociale 1355
Harta 24 – (21) Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe infrastrukturave 1422

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1. PLANI I PROPOZIMEVE TERRITORIALE

1.1 Ndarja e territorit në pesë sisteme territoriale

Një nga objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) është drejtimi i zhvillimit të sistemit urban të banimit dhe harmonizimi i tij me 4 sistemet e tjera, në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Në këtë kontekst, ruajtja, mënyra e përdorimit dhe, sipas rastit, konsolidimit të sistemeve të tjera territoriale, janë pjesë e këtij objektivi. Pikërisht për qëllime planifikimi dhe menaxhimi territori, ndahet në 5 sisteme territoriale, të cilat përcaktohen në nivel makroplanifikues që në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit, dhe detajohen përmes Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së PPV-së. Propozimet territoriale të prezantuara në Strategjinë e Zhillimit të Territorit të bashkisë Vlorë, të detajuara në këtë dokument, janë reflektuar edhe në sistemet territoriale të propozuara, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit (VKM nr.671), si më poshtë:

Sistemi urban. Ky sistem përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme në territor. Sistemi urban që i referohet organizimit të vendbanimeve të bashkisë Sarandë përbëhet konkretisht nga dy qendra urbane, Saranda dhe Ksamili, të cilat përqëndrohen në frontin bregdetar. Sistemi përbëhet nga zonat e vjetra rurale dhe nga zonat më të reja të banimit të krijuara, si pasojë e zgjerimit të Sarandës (pas viteve 1990). Zona e banuar zhvillohet paralelisht me konturet e maleve që e rrethojnë, gjithashtu dhe me sistemin e aksit rrugor. Bashkia Sarandë ka një vijë bregdetare të rëndësishme me funksione shërbimi, turizmi dhe argëtimi.

Sistemi infrastrukturor. Ky sistem përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës, në nivel kombëtar dhe në nivel vendor. Analiza dhe hartëzimi i këtij sistemi dëshmon për shumëllojshmërinë e gjerë të mjeteve të lëvizjes dhe përshkueshmërinë e mundshme në gjithë territorin nëpërmjet pranisë së një rrjeti të shpërndarë të rrugëve të shtruara dhe të pashtruara. Sistemi infrastrukturor i bashkisë Sarandë është ende i pazhvilluar, kryesisht në zonat natyrore në të cilat nuk mund të ngrihen qëndra urbane të mëdha. Rrjeti rrugor është gjithashtu në gjendje jo fort të mirë. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "infrastrukturë"(IN). Transporti detar operon vetëm gjatë sezonit të verës.

Sistemi bujqësor. Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore që ka si veçori thelbësore të saj pjellorinë e tokës, kanalet vaditëse dhe kulluese, si dhe rezervuarët në shërbim të tij. Bashkia Sarandë nuk ka fusha bujqësore me pjellori të lartë, por ajo kufizohet me një zonë të gjerë toke bujqësore në luginën e Vurgut. Përgjatë bregdetit si në zonën e Ksamilit ashtu dhe në Kepin e Skalës gjejmë sipërfaqe të mëdha të mbjella me ullinj që arrijnë deri në afërsi të vijës bregdetare.

Sistemi ujor. Të gjithë elementet që lidhen me ujin përbëjnë sistemin ujor. Zona paraqitet me një rrjet të pasur dhe të ndryshëm hidrografik. Duke përfshirë vijën bregdetare si dhe trupa ujorë si liqeni i Butrintit etj.

Sistemi natyror. I gjithë bregdeti i bashkisë Sarandë karakterizohet nga vlera të larta të pejzazhit për t`u ruajtur dhe për t`u mbrojtur. Brenda zonës urbane përgjatë bregdetit janë

evidentuar gjerësisht prishje të pejsazhit dhe ndotje të mjedisit të ardhura kryesisht nga hedhja pa kriter e materialeve të ndërtimit. Vija bregdetare gjithashtu është e bllokuar nga ndërtimet duke ulur aksesibilitetin në det dhe shfrytëzimin e këtyre hapësirave për publikun. Ndërtimet kanë ndikuar edhe në cilësinë e pejzazhit duke përmendur gërmimet e shkëmbinjve. Megjithatë, një pjesë e madhe e këtij territori është ende në gjendje natyrore të pabanuar. Shumë nga kodrat janë të mbuluara me pyje mesdhetare të zhvilluara mbi bregun e detit. Vija bregdetare është e karakterizuar nga një seri e vazhdueshme grykash, limanesh dhe gjiresh, disa prej tyre me plazhe me rërë të bardhë.

Siç shikohet nga tabelat e mëposhtme, përgjithësisht, PPV –ja e bashkisë Sarandë ka adaptuar një qasje konservatore përsa i përket konvertimit të sistemeve territoriale, duke u munduar të ruajë sa më shumë tokat e sistemit bujqësor dhe natyror. Për këtë arsye, PPV-ja propozon kryesisht tipologji ndërhyrjeje në territor që kanë të bëjnë me konsolidimin apo rigjenerimin e përdorimeve ekzistuese për tokës, me qëllim për të përmbushur nevojat ekzistuese edhe ato të propozuara për zhvillim e ardhshëm të bashkisë Sarandë.

Tabela 1: Ndarja e Territorit sipas Pesë Sistemeve Territoriale

Sistemet territoriale	Sipërfaqe (ha)	Sarandë	Ksamil	Total	Ndryshimi në %
Sistemi urban	Ekzistuese	551.79	274.65	826.44	**29.94%**
	E propozuar	712.48	361.38	1073.86	
Sistemi natyror	Ekzistuese	2041.30	1105.02	**3146.32**	**-4.79%**
	E propozuar	1943.30	1052.38	**2995.68**	
Sistemi bujqësor	Ekzistuese	1274.27	479.61	**1753.88**	**-5.98%**
	E propozuar	1207.60	441.40	**1649**	
Sistemi ujor	Ekzistuese	63.30	1874.50	1937.80	**0%**
	E propozuar	63.30	1874.50	1937.80	
Sistemi infrastrukturor	Ekzistuese	24.68	20.5	**45.18**	**17.93%**
	E propozuar	28.66	24.62	**53.28**	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Tabela 2. Kategorizimi sipas Shtojcës III. VKM Nr.671

SISTEMI URBAN	2031
Sipërfaqja e territorit urban	1073.86 ha
Sipërfaqja e infrastrukturës	53.28 ha
Popullsia Instat Census 2011	20.227 banorë / progresion
Popullsia Gj.Civile Aktuale	50.680 banorë
Strehimi social	0.7 ha
Shërbime administrative	1.23 ha
Shërbime sociale - arsim	1.73 m²/ba
Shërbime sociale - shëndetësi	0.76 m²/ba
Transporti publik	1 Linjë expres interurbane 1 Linjë transporti detare 4 Linja Lokale (furgon)
Ndarja në zona (njësi)	22 Zona ; 317 Njësi strukturore
Sipërfaqe të gjelbra	29.35 m²/ba
Sipërfaqe sportive	1.8 m²/ba
Hapësira kulturore dhe për rekreacion/banorë	0.06 m²/ba
Monumentet dhe objektet e trashëgimisë kulturore	25.4 ha
Detyrimet në lidhje me kërkesat fetare	1.86 ha
Dëndësia për ha	2.50 ba/ha
Parkime	2602
Indikatoret Gdp/sektorë/lloji bizneseve/çmimet/punësimi/punësimi për sektor/taksat vendore/borxhi/shpenzimet sipas sektorit	Turizëm bregdetar, natyror dhe kulturor
Pronat publike dhe private	115.39 ha
Parkime/banorë /25m2	18 Zona

SISTEMI BUJQESOR	2031
Sip. Territor bujqësor	1649 ha
Sip. Territor bujqësor primar	1306.90 ha
Sip. Territor bujqësor dytësor	378.25 ha
Sip. Territor bujqësor me sistem ujitjeje	0 ha
Sip. Territor bujqësor pa sistem ujitjeje	1669.30 ha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA



Harta 1 - (18a) Pesë sistemet territoriale

1.2 Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës

Komponenti themelor i Planit të Zonimit është harta e propozuar e përdorimit të tokës. Çdo zonë e propozuar, përfshin parimet e zhvillimit, që do të shprehet në formën e rregulloreve në fazën e ardhshme. Procesi i zonimit, në vetvete, ka një rëndësi strategjike për të bërë planifikimin dhe është i bazuar në praktikat më të mira dhe eksperiencën profesionale të Konsulentit. Një qasje sistematike, e cila merr në konsideratë një sërë parimesh udhëzuese, normash ekzistuese, si edhe kufizimet kryesore në nivel kombëtar, është hartuar për të mbështetur procesin e zonimit dhe për të minimizuar zgjedhjet arbitrare, duke synuar paralelisht planifikimin e një sërë rregullash të thjeshta dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar, i cili do të lehtësojë procesin e zbatimit.

Parimet gjithëpërfshirëse të zonimit

Parimet e procesit të zonimit, të përdorura në krijimin e Planit të Zonimit, kanë marrë parasysh evolucionin historik të zonës, si edhe diferencimin gjeografik dhe morfologjinë e territorit, të cilat krijojnë një strukturë hapësinore unike të bregdetit të bashkisë Sarandë e integruar në territorin e brendshëm. Në të njëjten kohë, procesi i zonimit përfshin edhe filozofinë e qendrueshmërisë, të miratuar në nivel global me konsideratë të veçantë në udhëzimet e politikave kombëtare dhe praktikat e suksesshme të ndjekura në vendet evropiane. Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor përpiqen të krijojnë barazi dhe drejtësi brenda zonës së planifikimit, duke ruajtur edhe rritjen e potencialit të zhvillimit për brezat e ardhshëm.
Një detyrë e rëndësishme në procesin e zonimit është identifikimi dhe propozimi i zonave urbane dhe rurale të zgjerimit për çdo njësi të zonës së studimit, si edhe përcaktimi i zonave të reja të zhvillimit. Kjo nënkupton një seri vendimesh që janë të bazuara në:
i) vizionin hapësinor për zhvillimin e ardhshëm sikurse është rënë dakord me Bashkinë;
ii) identifikimin e nevojave programore në bazë të parashikimeve shkencore, adaptimin e standarteve kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
iii) detajimin e hollësishëm të tokës për çdo lokalitet në studim;
iv) planifikimin ekzistues dhe rregulloren e kufizimeve.

Mënyra se si faktorë të ndryshëm janë marrë në konsideratë në procesin e zonimit të nënndarjeve, shpjegohet si më poshtë :

Modelet primare të përdorimit të tokës. Kjo përfshin evidentimin e përdoruesve primarë të tokave, që ndodhen në nënndarjet ekzistuese në nivel rajonal, duke përfshirë të gjithë territorin e Bashkisë. Një klasifikim i parë është bërë ndërmjet tokës urbane dhe asaj jourbane bujqësore dhe sistemeve natyrore të zonës së planifikimit. Zona është identifikuar fillimisht sipas përdorimit kryesor të tokës dhe, në rastet kur mbizotëron një larmi përdorimesh, duhet të bëhen nënndarje të tjera, që korrespondojnë me përdorimin ekzistues. Konsulenti ka përdorur klasifikimin e hartave PINS Bregdeti për klasifikimin e zonave si tokë urbane, tokë bujqësore, pyje dhe kullota.

Ndarja dytësore e përdorimit të tokës. Në një fazë të dytë, për ndarjen e zonave të ndryshme, duhen marrë parasysh karakteristikat e veçanta brenda një modeli të përdorimit kryesor të tokës. Kjo përfshin një studim të ndryshëm për zona të ndryshme, në të cilin bëhet dallimi mes zonave të banuara dhe zonave me karakter të përzier (banim i kombinuar me veprimtari të tjera), si edhe nivele të ndryshme të densitetit. Analiza është bërë në mënyrë të ngjashme, edhe pse me më pak hollësi për kategoritë jourbane të tokës, sidomos në zonat që janë identifikuar si zona zhvillimi nga vizioni hapësinor.

Zhvillimi historik. Formulimi i strukturës hapësinore do të thotë marrjen në konsideratë të proceseve të ndryshme të zhvillimit urban, të cilat kanë përcaktuar karakterin e pejzazhit, që është formuar nga vendndodhja e zonave dhe rrethinat e tyre kufitare. Kjo nënkupton një trajtim të diferencuar midis pjesëve malore dhe zonës në drejtim të detit, në lidhje me vendndodhjen e zhvillimeve të reja, si edhe mënyrën se si zona të ndryshme janë të lidhura me njëra - tjetrën. Në shkallë urbane, ajo përfshin konsideratat për zonat e ndërtuara në kohë dhe regjime të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

ndryshme, lagjet e vjetra në zonat historike dhe rolin historik të lokaliteteve të caktuara brenda qytetit.

Sistemi Infrastrukturor - Referenca për hierarkinë e rrjetit rrugor. Nënndarjet hapësinore të zonave të zhvillimit duhet të kryhen në përputhje me hierarkinë e rrjetit rrugor. Zonat homogjene të banimit (lagjet) dhe zonat periferike (fshatrat) duhet të përcaktohen dhe jo të përshkohen nga arteriet rrugore urbane (kryesore dhe dytësore), dhe ato ndërurbane (kombëtare ose rajonale). Vëmendje e veçantë i është kushtuar artikulimit të trafikut automobilistik në brendësi të qendrës së zonave tradicionale dhe atyre turistike, si edhe atyre që lidhen me ambientet ujore, me qëllim për të shmangur parandalimin e varësisë së zonave të banuara me detin. Kategorizimi i hierarkisë së rrjetit ekzistues dhe atij të ri rrugor në çdo zonë, u bë paralel me procesin e zonimit të shfrytëzimit të tokës.

Referenca të kufizimeve gjeografike. Nënndarja sipas kufizimeve gjeografike (lumenj, thyerje, kodra dhe fusha etj), është një qasje shumë praktike në procesin e përcaktimit me të hollsishëm të zgjerimeve urbane dhe atyre periferike, si edhe të zonave të reja të zhvillimit. Gjatë fazës së analizës Konsulenti identifikoi nëpërmjet Hartave Përjashtimore, fushat dhe kriteret e përjashtimit të zhvillimit, të bazuar në përkufizimin e zonave të larta, sipërfaqet e shpateve të pjerrëta, zonat e prirura për përmbytje, sikurse ato të mbrojtjes së burimeve ujore sipas legislaciont kombëtar dhe PINS-it Bregdeti. Në mënyrë të ngjashme janë vendosur një sërë kriteresh për zonat e mbrojtjes mjedisore dhe pejzazheve, të cilat marrin në konsideratë parametrat topografikë dhe vizualë, të tilla si mbrojtja e majave, grykave dhe luginave, deltave aktive, etj, sikurse përmendet në pikat e mëposhtme:

- *Mbrojtja e sistemit natyror.* Nënndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:
Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij ligji. Kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.
- *Sistemi bujqësor.* Nënndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me tokën bujqësore. Në veçanti:
Mbrojtjen e tokës bujqësore ekzistuese.
Mbrojtjen e pejzazheve kulturo - bujqësore, të cilat pasqyrojnë historinë e bujqësisë tradicionale në rajon, duke përfshirë ullishtat e lashta dhe pemët e tjera të papunuara së bashku me sistemin tarracor, që janë identifikuar nga zonimi i territorit.

Përveç faktorëve të mësipërm, ndarja e zonave dhe përcaktimi i zonave të zhvillimeve të reja, si edhe zonat e reja të zgjerimit, janë bazuar në parimet e mëposhtme duke marre në konsideratë udhëzimet ekzistuese dhe praktikat më të mira të vlerës universale, si me poshtë vijon:

i. *Përqendrimi i zhvillimit*
bazuar në parimet e PINS-it Bregdeti, zonimi ka për qëllim të mbështesë një numër të kufizuar polesh zhvillimi, të identifikuar aktualisht me ndikim të ulët, duke respektuar nevojën primare për të ruajtur vlerën e një pejzazhi thelbësisht të paprishur dhe të pazhvilluar në shkallë rajonale. Zonimi synon në këtë mënyrë të shmangë zhvillimet sporadike (të shpërndara, autonome), që ndikojnë në natyrën e virgjër të pejzazhit në tërësi të bregdetit jugor që shtrihet

në territorin e bashkisë Sarandë dhe kompromotojnë vlerën e saj të përgjithshme duke kufizuar përftimet potenciale në ato ekonomike.

ii. *Racionalizimi i zhvillimeve ilegale*

Zonat e zgjerimit urban duhet të përcaktohen për lehtësimin, racionalizimin dhe konsolidimin e zhvillimit ekzistues sporadik, dhe/ose të paligjshëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të politikës së planifikimit bregdetar, strategjive dhe planeve, si edhe me skemat përkatëse të planifikimit.

iii. *Përdorimi ekonomik i infrastrukturës*

Zonimi ka për qëllim të mbështesë shfrytëzimin ekonomik të infrastrukturës ekzistuese dhe asaj të propozuar, pa shkaktuar dëmtime gjatë përdorimin.

iv. *Homogjeniteti i zonave*

Është e nevojshme të sigurojë rregulla të plota në mënyrë të thjeshtë, që do të jenë të lehta për t'u zbatuar.

Përcaktimi i zonave duhet të marrë parasysh këta dy faktorë:

a. Sigurimin e një zone të një madhësie absolute, në mënyrë që të shmanget një strukturë e fragmentuar urbane dhe rregulloreje të komplikuar, duke ruajtur korrektësinë brenda morfologjisë urbane.
b. Të mund të përgjithësojë përdorimin sipas përdorimit kryesor në çdo zonë. Për shembull, një zonë rezidenciale do të jetë përshkruar si një zonë homogjene, pa pasur nevojën për të detajuar në një hartë të përdorimit të tokës hapësirat publike të hapura, zonat e parkimit që gjenden brenda tij, etj.

Bazuar në mjetet metodologjike të paraqitura më lart dhe përkufizimet e 14 kategorive bazë të tokës është përdorur sipas nenit 76 te VKM 671 të 2015. Sistemi i klasifikimit të zonave të përdorimit të tokës, të cilat janë analizuar më tej nënkategoritë, ose tipi i zënies së lejuar të tokës (apo e ndaluar) brenda çdo zone të përdorimit të përgjithshëm të tokës, në lidhje me destinacionin e tij të dëshiruar. Konsulenti ka konsideruar dokumentet e PPK-së edhe PINS-së Bregdeti të miratuar, si një udhëzues kryesor për të përcaktuar metodologjinë e përdorimit të tokës për planin lokal duke përfshirë dhe kufizimet e saj, si edhe sigurimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore të miratuara rishtazi për planifikimin territorial. Sistemi i propozuar i klasifikimit, i cili është paraqitur më poshtë dhe reflektuar në hartat e përdorimit të tokës, do të finalizohet në formulimin e Rregullores Lokale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA



Harta 2 - (18b) Kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara

1. **N- Tokë natyrore**

Nënndarjet bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat natyrore. Në veçanti:

Zonat e mbrojtura natyrore sipas ligjit 8906/2002 dhe zonat e mbrojtura të propozuara, përjashtohen nga zhvillimet/ndërtimet e banesave dhe turizmit, sipas rregullores së këtij Ligji. Kufizime të ngjashme aplikohen për burimet ujore, që mbrohen nga Ligji 8093/1996.

Përdorimi "Tokë natyrore", me kod "N", përfshin, sipas përcaktimeve të ligjeve për mjedisin dhe biodiversitetin, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, kullotat dhe tokat e pafrytshme.

Brenda kategorisë N- Tokë Natyrore janë identifikuar 8 nënkategoritë:

N1 – Rezervë strikte natyrore [**Zona A1** - Strikte e Mbrojtur (K.I)]

N2 - Zona për Rekreacion Natyror [**Zona A2** Park Kombëtar (K.II) Butrint]
N3 – Zona Buferike [**Zona B** Park Kombëtar (K.II) Butrint]
N4 – Zona Rekreative (Ecoturizëm) [**Zona D**, Park Kombëtar (K.II) Butrint] – Zona është lejuar të përdoret sipas parashikimit nga MP-ja. Për Butrintin dhe projektuar si zonë D.
N5 – Rrafshnaltat strategjike dhe luginat e thella. Brigjet bregdetare/ shpatet e larta/shkëmbinjt bregdetarë/ zonat me zhvillim të ndaluara/shkallë publike për në plazh – zonat me ndalim zhvillimi të përgjithshëm.
N6 – Zonat e mbrojtura të pejzazhit (definuar në kriterin vizual, zonat me zhvillim të ndaluar/ pejzazh publik) – Janë ndaluar vetëm funksionet lidhur me përdorimin rekreativ sikurse belvederet, shtigjet, zona pushimi, sinjalistika.
N7 – Tokë Natyrore (mbetet zonë natyrore) dhe që mund të lejohet të zhvillohet në disa raste me intensitet të ulët
N8 - Plazhet – Zonat me zhvillim të ndaluar.

2. B-Bujqësi
Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me toka bujqësore.

Brenda kategorisë B-Bujqësi janë identifikuar 6 nënkategoritë:
B1 – Tokë Bujqësore e mbrojtur fushore, përfshin kultivime me arra i referohet tokës me arra në luginën e Vourkos të lumit të Bistrica.
B2 – Tokë Bujqësore e mbrojtur kodrinore, përfshin kultivime me ullishte, pemëtore, vreshtë, i referohet kryesisht kultivimit me pemë ullishte tradicionale në Ksamil.
B3 – Tokë Bujqësore dytësore, si kultivime të përziera ose të segmentuara që mund të lejojnë disa zhvillime të agrikulturës, si depot e ndryshme dhe magazinat e fermave që kanë një intensitet të ulët).
B4 – Zona të dedikuara për aktivitete mbështetëse për bujqësinë dhe blegtorinë
B5 –Zona të propozuara me mundësi për zhvillimin e agroturizmit (nuk ekziston si nënkategori në rastin e bashkisë Sarandë).
B6 - Tokë e pafrytshme për rigjenerim (nuk ekziston në rastin e bashkisë Sarandë)

3. IN-Infrastrukturë
Këtu
përfshihen të gjithë komponentët e infrastrukturës që shërbejnë për transportin, mbetjet e ngurta dhe të lëngshme, furnizimin me ujë, naftën dhe gazin, biokarburantet, komunikimin elektronik, furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitja dhe mbrojtjen kundër zjarrit, sipas legjislacionit të posaçëm. Prandaj më poshtë janë identifikuar nënkategoritë specifike:

IN1 –Sip. rrugë kombëtare / Sip. rrugë interurbane / Sip. rrugë urbane parësore, parkig publik. Në këte nënkategori janë propozuar shumë elemente shtesë për parkimin publik brenda qytetit të Sarandës dhe në shëtitoren e Ksamilit.
IN2 - Terminali i Autobusave – I pozicionuar pranë stadiumit të Sarandës bazuar në propozimet e PPV-së.

IN4 - Porte / Marina. I referohet pasagjerëve ekzistues dhe Portit Tregtar të Sarandës dhe vendodhja e propozuar për Marina.
IN6 – Nënstacioni elektrik, për njësi / përfshin një zonë *buffer* të linjës së tensionit të lartë.
IN7-Ujësjellës-Kanalizime, përfshirë impiantin e trajtimit të ujëra vetëndotura, si dhe depot e ujit
IN8– Telekomunimkimi, që përfshin siperfaqen e antenave dhe një territor *buffer* 30m.
IN9 – Pika karburanti
IN10- Landfill / vend depositimi për zonën *bufferike*

4. U-Ujëra
Territoret që përfshihen në kategorinë ujëra përfaqësohen nga brigjet lumore dhe përrenjtë, sipas nënkategorisë. Në këto zona është rreptësisht i ndaluar çdo lloj zhvillimi.

U1 – Lumi, liqene, reservuare artificiale
U2 – Aquafarm. Ekziston brenda liqenit të Butrintit dhe Ksamil.
U3 – Ujërat bregdetarë (laguna, kripore, salinas)
U4 – Zonë e mbrojtur ujore. Kjo zonë i referohet pjesës përballë dhe brenda kufinjve të zonës së mbrojtur kombëtare. [**Zona A**, Park Kombëtar (K.II) Butrint]
U5 – Park Detar Shplodhës / Zone Rekreative Ujore. E propozuar nga PINS-i Bregdeti

5. A-Banimi
Zonat Rezidenciale përbëjnë dhe pjesën më të madhe të territorit të urbanizuar të bashkisë Sarandë, duke përfshirë këtu zonat e shtëpive parësore dhe dytësore. Disa nga shërbimet ndihmëse për turizmin janë përfshirë në këto zona, sigurisht sipas kushteve specifike për secilën prej tyre, sikurse edhe shërbime të tjera, që janë në përputhje me zonat rezidenciale. Zonat rezidenciale përfshijnë një shumëllojshmëri territoresh: i) Zonat ekzistuese urbane dhe ato fshatare me kufijtë e përcaktuar nga orto fotot e vitit 2013 dhe 2015; ii) Zonat e zgjeruara të propozuara për qendra urbane nga Konsulenti, për të mundësuar mbulimin e nevojave në të ardhmen, duke u bazuar në projeksionet programatike; iii) Zonat e reja të zhvillimit për shtëpitë e dyta; iiii) Zonat e trashëgimisë kulturore. Kategoritë e propozuara për zonat e zhvillimit rezidencial dhe shërbimet që i shoqërojne ato janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

Brenda kategorisë A- Banim janë identifikuar nënkategoritë:

A1–Qendra historike/vendbanim tradicional. Zona arkeologjike e Sarandës A dhe B
A2 – Zona banimi në qendrën e qytetit. – Zona qendrore e qytetit Sarandë
A3–Zona banimi me përdorim miks. Zona ekzistuese urbane Sarandës dhe Ksamil.
Tip 1: Zona miks me përdorim rezidencial turistik dhe tregtar
Tip2: Zona miks për rezidenca dhe funksione ekonomike (në hyrje të zonës së Sarandës)
A4–Zona banimi
A5 - Zona me shtëpi të dyta
Tipi 1: Shtëpi rurale(1-3 kate) – Ksamil
Tipi 2: Vila (1-3 kate)
Tipi 3: Blloqe apartamentesh me shumë kate - Sarandë
Tipi 4: Kompleks rezidencial.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

A6- Zona e strehimit social, u referohet kërkesave të Bashkisë në lidhje me grupet vulnerabël apo shtresat e tjera në nevojë, të cilët nuk janë të aftë të kenë ambiente banimi, por që është detyrë e Bashkisë t'i sistemojë dhe të rrisë cilësinë e jetesës së qytetarëve të saj.

6. S- Shërbimet

Këto shërbime janë të ndara në dy tipe kryesore: shërbime tregtare dhe turizëm, të cilat janë të ndara në 2 nënkategori për shërbime tregtare:

S1 – Dyqane, shërbime personale, zyra, biznesi,

S4 - Bare, kafe, restorante, shërbime plazhi, u referohet shërbimeve në plazh në zonën e Sarandës dhe shëtitores së Ksamilit.

Përdorimi i tokës dhe i strukturave në të për shërbime (S1) (S4), përfshin ato zhvillime të lejuara që bëhen për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturave përkatëse dhe ku, sipas rastit, jo më shumë se 10% e zonës dhe strukturave të saj shfrytëzohet për qëllime banimi, sipas sipërfaqes së ndërtimit.

Zonat e Zhvillimit Turistik, janë zonat e destinuara për zhvillimin e formave të ndryshme, të përgjithshme të një turizmi të interesit të veçantë, të cilat formojnë profilin e zonës, ashtu si ato janë identifikuar në fazën e mëparshme të studimit si pjesë e Vizionit dhe Strategjisë Territoriale.

Si rregull i përgjithshëm zonat e përcaktuara posaçërisht turistike, përjashtojnë aktivitete të tjera, të cilat nuk janë në përputhje me karakterin e zonës dhe zhvillimet rezidenciale, që nuk janë të lidhura me skemën e përgjithshme të zhvillimit. Kategoritë e propozuara të zonave të zhvillimit turistik, janë të përshkruara si më poshtë:

S2 - Turizëm brenda zonave të vendbanimeve (hotele)

S3 – Turizëm jashtë zonave të vendbanimeve (Resorte / Vila). Janë propozuar disa zona për resorte në gadishullin e Ksamilit dhe në Manastir dhe në pjesën veriore të zgjerimit të Sarandës.

S5 – Format speciale të turizmit (ekoturizëm dhe agroturizëm) (nuk ekzistojnë në Sarandë).

S6 – Infrastrukurë speciale për turizëm /Objekte si Spa, golf etj.

S7 - Kamping(nuk ekziston në Sarandë).

Kombinimi i rezidencave me zhvillimet turistike: Një nga qëllimet kryesore të zonimit është që të sigurojë përcaktimin e zonave atraktive dhe të përshtatshme për zhvillimin e turizmit, në mënyrë që të tërheqë investime në vende të veçanta duke siguruar cilësi të lartë të zonave të zhvillimit të ardhshëm. Kjo përfshin një politikë të ruajtjes së disa zonave të veçanta, në pjesën pranë bregdetit për lloje të ndryshme të turizmit duke vënë kushte, që të kufizojnë ose ndalojnë banesat apo tipe të tjera zhvillimi, në mënyrë që të shmanget konsumimi i burimeve të vlefshme bregdetare. Kjo parashikon një qasje të ndryshme për pjesë të ndryshme të territorit si më poshtë:

Përcaktimin e një numri të kufizuar të zonave të hotelerisë në pjesë të veçanta të bregdetit, që do të kombinohet me aktivitete tregtare, që janë të lidhura me turizmin, si bare, restorante dhe turizmin cilësor. Këto do të formojnë bazën për tërheqjen e vizitorëve, në varësi të përqendrimit ekzistues të popullsisë. Është propozuar gjithashtu që banesat atje, duhet të jenë të kufizuara në

10% të sipërfaqes totale të zonës. Hotelet familjare "shtrat dhe mëngjes" (B&B) ose ato të dhënies me qera është lloji kryesor i akomodimit turistik, që funksionon edhe sot në territorin e bashkisë Sarandë.

7. M-Trashëgimi dhe Monumente Kulture dhe Historike

Nënndarjet duhet të bazohen në respektimin e të gjitha rregulloreve përkatëse kombëtare dhe kufizimeve ligjore, në lidhje me zonat historike.

Monumentet e trashëgimisë kulturore me vlerë të jashtëzakonshme rregullohen me anë të një zonimi të veçantë hapësinor dhe udhëzimesh shoqëruese, të nxjerra sipas Ligjit 9048/2003. Zona tampon ose buferike të ruajtjes së pejzazhit prej 250 m, është për të siguruar ekzistencën e monumenteve të regjistruara si të tilla, duke iu referuar Ligjit 9048/2003.

M.1 - Zona Arkeologjike A
M.2 - Zone Arkeologjike B (buferike)
M3 - Kala / Monument Kulturor

8. IE-Ekonomi dhe industri

Zonat me aktivitete ekonomike industriale krijojnë tipin e tretë të kategorisë së përdorimit të përgjithshëm të tokës, që përfshin të gjitha pjesët e urbanizuara të territorit të bashkisë Sarandë, të cilat u takojnë aktiviteteve ekonomike që nuk duhet të shtrihen në zonat rezidenciale dhe/ose zonat për zhvillimin e turizmit. Këtu dallohen kategoritë, si më poshtë:

IE.1–Park industrial/Qendër logjistike (nuk kemi në Sarandë)
IE.2 –Zonë ekonomike/tregtare/garazhe të mëdhenj. Kjo nënkategori u referohet propozimeve ekonomike në hyrje të qytetit të Sarandës.
IE.3– Zona magazinimi dhe tregtimi/ Industriagro-përpunimi, u referohet zonave ekonomike në hyrje të Sarandës.
IE.4–Qendra rajonale agro-ekonomi. Kjo kategori është propozuar në Metoq dhe Cukë.
IE.5–Nxjerrje dhe përpunim mineralesh (guroret / fabrikat e çimentos), integruar në zonat IE3. Kjo nënkategori është propozuar përgjatë rrugës kombëtare drejt Himarrës.

9. IS-Institucione

IS.1 institucionet publike vendore / institucionet publike qendrore (administrata, gjykatat/ burgjet / mbrojtja civile / institucionet e mbrojtjes kombëtare, kompanitë që ofrojnë shërbime publike, mirëqenie sociale). Këto janë përqendruar kryesisht brenda zonës urbane të qytetit të Sarandës.

IS.2 Institucionet fetare

10. AR-Aktivitete Sociale dhe Rekreative

Përdorimi AR- Aktivitete sociale dhe rekreative (AR) përfshin fusha të ndryshme, si aktivitete sociale, kulturore dhe rekreative, sipas legjislacionit të posaçëm.

AR.1- Aktivitete kulturore

AR.2- Zona Sportive
AR.3-Zona të gjelbra dhe hapësira publike në zona të banuara. Janë propozuar në zgjerimin e shëtitores së Sarandës dhe Ksamilit
AR.4-Parku/ Zona e shplodhëse periurbane. Janë propozuar në parkun e ri bregdetar në kodrën e Marinës ne veri të qytetit të Sarandës
AR.5- Zona e gjelber izoluese

11. AS-Arsimi

Ky përdorim përfshin të gjitha trojet e rezervuara për institucionet arsimore apo institucionet ndihmëse në funksion të arsimit, ekzistues dhe të propozuara. Propozimet, siç shpjegohen në kapitullin përkatës të këtij dokumenti, janë bërë duke u bazuar mbi analizën e gjendjes ekzistuese dhe evidentimin e nevojave për planifikimin e infrastruktures arsimore, bazuar në parashikimet ligjore të VKM-së nr.671 (Neni 83) dhe legjislacionin sektorial përkatës. Në shumë raste, duke pasur parasysh që sipërfaqja e trojeve të rezervuara për institucionet arsimore është disa herë më e vogël se sa siperfaqja minimale e njësive strukturore të cilat akomodojnë edhe përdorime të tjera toke si Banim (A), Shërbime (S), etj. Nënkategoritë e evidentuara për këtë përdorim toke janë:

AS.1- Arsim parashkollor
AS.2- Arsim 9-vjeçar
AS.3- Arsim imesëm
AS.4- Arsim profesional
AS.5- Zonë universitare

12. SH-Shëndetësi

Ky përdorim përfshin të gjithë sipërfaqet territorial të rezervuara për institucionet shëndetësore apo strukturat ndihmëse në funksion të tyre, të klasifikuara sipas dy nënkategorive kryesore:

Sh.1–Zonë spitalore
Sh.2–Qendër shëndetsore/Ambulancë

13. V- I Veçantë

V1 Varreza

Strukturat dhe territoret që përfshihen në kategorinë të veçanta, janë zonat e varrezave publike, të dëshmorëve dhe varrezate fshatrave, me kodin (V.1). Këto zona shoqërohen gjithmonë me zonën e mbrojtur buferike. Varrezat e qytetit janë parashikuar të transferohen jashtë qytetit në drejtim të rrugës për Himarë, afër varrezës së vogël ekzistuese.

14. ZU- Zona Ushtarake

U referohet hapsirave dhe objekteve të klasifikuara si të tilla në territor sipas legjislacionit të posaçëm. Nuk ekzistojnë të tilla në bashkinë Sarandë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

Tabela 3: Ndryshimet e përdorimit të tokës sipas kategorive bazë

Kategoritë bazë te përdorimit te tokës	Sipërfaqe (ha)	Sarandë	Ksamil	Total	Ndryshimi në %
A	Ekzistuese	425.42	197.53	622.95	13.68%
	E propozuar	498.30	209.90	708.20	
IE	Ekzistuese	33.34	1.21	34.55	166.86%
	E propozuar	92.20	0.00	92.20	
B	Ekzistuese	1274.27	479.61	1753.88	-5.98%
	E propozuar	1207.60	441.40	1649	
S	Ekzistuese	31.72	70.19	101.91	52.19%
	E propozuar	44.80	110.30	155.10	
V	Ekzistuese	5.40	0.43	5.83	9.09%
	E propozuar	5.40	0.96	6.36	
U	Ekzistuese	63.30	1874.50	1937.80	0%
	E propozuar	63.30	1874.50	1937.80	
N	Ekzistuese	2041.30	1105.02	3146.32	-4.79%
	E propozuar	1943.30	1052.38	2995.68	
M	Ekzistuese	1.59	0.32	1.91	1617.27%
	E propozuar	8.90	23.90	32.80	
ZU	Ekzistuese	0.00	2.04	2.04	0%
	E propozuar	0.00	2.04	2.04	
IS	Ekzistuese	1.43	0.79	2.22	36.04%
	E propozuar	1.72	1.30	3.02	
AR	Ekzistuese	48.55	0.90	49.45	38.5%
	E propozuar	56.82	11.67	68.49	
AS	Ekzistuese	3.00	1.04	4.04	1.73%
	E propozuar	3.00	1.11	4.11	
SH	Ekzistuese	1.34	0.2	1.54	0%
	E propozuar	1.34	0.2	1.54	
IN	Ekzistuese	24.68	20.5	45.18	17.93%
	E propozuar	28.66	24.62	53.28	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Harta 3-(18c.I) Nënkategoritë e përdorimit të tokës të propozuara, Sarandë Qytet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Harta 4 -(18c.II) Nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara, Ksamil

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.3 Ndarja e territorit në njësi zhvillimi

Organizimi hapësinor i njësive dhe nënnjësive strukturore është një proces paralel me procesin e zonimit të përdorimit të tokës, i cili shërben si mjet themelor metodologjik për organizimin funksional të territorit të Bashkisë dhe planifikimin e shërbimeve sipas standardeve të planifikimit të miratuara në legjislacionin kombëtar. Caktimi i njësive dhe nënnjësive është i lidhur direkt me popullsinë ekzistuese dhe atë të planifikuar, dendësinë e popullsisë, numrin e parashikuar të turistëve dhe të vizitorëve, si edhe shpërndarjen e shërbimeve sociale (arsimi, kujdesi shëndetësor, kultura, sporti dhe gjelbërimi).
Përcaktimi i njësive dhe nënnjësive strukturore zbatohet vetëm për pjesën e urbanizuar të territorit të parashikuar, duke marrë në konsideratë formimin e zonave të vazhduara urbane apo njësive të ndara territoriale. Zonat janë njësi relativisht homogjene, ku përqendrohen një sërë karakteristikash të përbashkëta, si përdorimi i tokës, tipologjitë hapësinore, destinacioni i zhvillimit dhe profili ekonomiko – social. Kriteret në procesin e nënndarjes së zonës në njësitë strukturore, kanë marrë në konsideratë organizimin e territorit të Bashkisë në pesë njësi hapësinore të identifikuara, sikurse përcaktohen në fazat e mëparshme të punës, të cilat janë formuar nga grupimet e vendbanimeve urbane apo rurale, me funksionimin dhe lidhjet historike me njëri-tjetrin, në lidhje me plazhet, aktivitetet e tyre prodhuese, tokën dhe kultivimin e tyre.

Njësia strukturore përbën qelizën më të vogël të planifikimit dhe qelizën më të madhe të zhvillimit në një territor. Çdo kërkesë për zhvillim bazohet në treguesit e planifikimit dhe kushtet e zhvillimit që vendosen në njësinë strukturore përkatëse.

Numri i njësive strukturore është 307 (treqind e shtatë), të cilat janë përcaktuar duke ju referuar këtyre kritereve:

a. Kufizimi nga rrjeti rrugor kryesor ekzistues dhe/ose i propozuar, dhe sipas rastit edhe nga kufizues të tjerë natyralë e artificialë, të cilët krijojnë elemente me karakter qartësisht të matshëm në territor, dhe sipas rastit përfshijnë linja hekurudhore, vija ujore, lumenj, kanale të hapur, breza sanitarë dhe të tjera të kësaj natyre;
b. Ekzistenca e një ekuilibri midis përdorimeve dhe funksioneve brenda çdo njësie strukturore, që përcaktohet përmes treguesve të planifikimit dhe të zhvillimit, të cilët garantohen në çdo njësi përbërëse të njësisë strukturore;
c. Ekzistenca e funksioneve urbane që plotësojnë njëri-tjetrin dhe nevojat e popullatës urbane;
d. Bashkëkzistenca e përdorimeve të tokës dhe të strukturave në një njësi strukturore që janë të përputhshëm edhe nuk paraqesin raste të përdorimeve të ndaluara, ose sipas rastit ekzistenca e përdorimit homogjen të tokës dhe strukturave në të në të gjithë njësinë;
e. Garantimin e kompaktësisë dhe njëtrajtshmërisë së tipologjisë hapësinore ekzistuese ose të propozuar;
f. Ekzistencën e treguesve të njëtrajtshëm të planifikimit dhe të zhvillimit;
g. Ekzistencën e përdorimit homogjen të tokës dhe të strukturave në të;
h. Kufizimin nga rrjeti rrugor, pavarsisht nga kategoritë e rrugëve, nga linja hekurudhore, kanale të hapura, breza sanitarë, vija ujore, lumenj, dhe të tjera të kësaj natyre.

Tabela 4 Ndarja e territorit në njësi zhvillimi

Njësia Administrative	Vendbanim	Sipërfaqe (ha)	Zona	Njësi Strukturore
KSAMIL	BREDENESHIT	6,64	KS.UB.1	1
	BREDENESHIT	62,64	KS.UB.7	16
	BUTRINT	19,86	KS.UB.8	1
	BUTRINT	0,17	KS.UB.9	1
	KSAMIL	47,33	KS.UB.2	36
	KSAMIL	66,93	KS.UB.3	12
	KSAMIL	26,93	KS.UB.4	8
	KSAMIL	48,2	KS.UB.5	12
	KSAMIL	2	KS.ZU	1
	MONASTIRIT	21,25	KS.UB.1	9
	Sub-Total	**301,95**		**97**
SARANDË	CUKA	61,83	SA.UB.13	7
	GJASHTE	82,39	SA.UB.9	11
	METOQI	66,46	SA.UB.11	13
	SARANDA	32,64	SA.UB	4
	SARANDA	12,98	SA.UB.1	35
	SARANDA	38,25	SA.UB.2	21
	SARANDA	39,44	SA.UB.3	16
	SARANDA	37,51	SA.UB.4	11
	SARANDA	125,86	SA.UB.5	14
	SARANDA	40,45	SA.UB.6	5
	SARANDA	50,6	SA.UB.7	19
	SARANDA	118,08	SA.UB.8	55
	SHELEGARI	31,78	SA.UB.12	9
	Sub-Total	**738,27**		**220**
	TOTAL	**1040,22**		**317**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Harta 5 (18i) Njësitë Strukturore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.4 Pozicionimi i rrjeteve të infrastrukturës si edhe kushtet teknike për realizimin e tyre.

1.4.1 Transporti ekzistues

Saranda është jo vetëm një qendër e rëndësishme urbane por edhe kryqëzimi i disa prej korridoreve më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Kësisoj Saranda, përtej rrugëve detare preket nga dy akse rrugore të rëndësishme si: Korridori Blu dhe Unaza Gjirokastër-Sarandë-Igumenicë-Janinë. Korridori Blu është një korridor paneuropian, i cili kërkon të krijojë vazhdimësinë e aksit bregdetar i cili fillon nga Italia, Sllovenia, Kroacia, vazhdon më tej në Mal të Zi, lidhet me Shqipërinë dhe më pas vazhdon për në Greqi, ku lidhet më pas me rrugën Egnatia. Të qenit pjesë e këtij Korridori Strategjik Europian është tejet e rëndësishme dhe vjen si pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit Adriatiko Jonian. Saranda është pjesë e Unazës ndërkufitare Gjirokastër-Sarandë-Igumenicë-Janinë-Sarandë, e cila lidh katër qytete tejet të rëndësishme të Ballkanit Jugperëndimor me njëra-tjetrën. Kjo unazë është një itenerar i rëndësishëm tregtar por edhe turistik. Shkëmbimi i turistëve dhe fuqizimi i kësaj Unaze do të ofronte një rritje të mëtejshme ekonomike të këtij Rajon.

Aksesibiliteti dhe lidhshmëria janë shtyllat kurrizore për krijimin e Rivierës. Këtu qëndron arti i gërshetimit të gjërave të vëna së bashku, por në mënyrë të tillë që t`u lejojë zonave ruajtjen e identitetit vetjak. Reduktimi i kohës së udhëtimit për të aksesuar në destinacionet e Rivierës është i rëndësishëm me qëllim që udhëtimet turistike të mund të përballohen lehtësisht. Nga ana tjetër, distanca është një faktor kritik që përcakton parametrat e përvojës së jetuar. Për këtë arsye, një rrugë pejzazhistike bregdetare duhet të zgjasë për një kohë të mjaftueshme me qëllim që vizitorët të vlerësojnë pamjen dhe të perceptojnë kalimin nga pejzazhi bregdetar tek ai malor.

Aksesibiliteti i Rivierës mbetet në përgjithësi një problem si për udhëtimet ndërkombëtare ashtu edhe për lidhshmërinë rajonale. Ndërtimi i një aeroporti të dytë në bregdet është një parametër i rëndësishëm që mund të ndikojnë tendencat afatgjata të turizmit. Riviera mund të bëhet një destinacion ndërkombëtar që tërheq investimet e huaja direkte vetëm me një ndërlidhje të drejtpërdrejtë ajror me jo më shumë se 1 orë distancë me makinë nga pjesa më e madhe e qendrave të atraksionit urban. Kështu aeroporti, në mënyrë ideale, duhet të pozicionohet diku midis Vlorës dhe Sarandës pranë autostradës dhe korridorit të transportit publik/privat që lidh territorin nga veriu në jug. Ky duhet të funksionojë gjithashtu edhe si një korridor transporti publik (`*Bus Rapid Transit*` ose tren), që ndërlidhet me pjesën ballore të destinacioneve kryesore.

Pika e dytë është ndërlidhja nëpërmjet ujit. Korfuzi ka një aeroport, në të cilën akomodohen miliona turistë, e cila krijon një potencial të madh turistik për bashkinë Sarandë pasi është disa milje larg me anije. Kjo do të mund të arrihej në rast se do të lehtësohet hyrja dhe komunikimi me ishullin e Korfuzit nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese. Ndërtimi i një ure është ndoshta jo fort i përshatshëm (edhe pse për këtë do të duhej një studim i mirëfilltë fizibiliteti), por kjo do të lehtësonte shumë ndërlidhjen e rregullt përgjatë verës. Elementë të tjetë që nevojitet janë paketat turistike dhe ndoshta vizat ditore. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është fuqizimi i transportit ujor, domethënë përgjatë bregdetit me anije lundrimi, është një domosdoshmëri. Nëse të shkuarit përgjatë bregdetit me makinë është e mundimshme në të kundërt, të shkuarit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

me anije është i shpejtë dhe shumë më argëtues. Të gjitha rivierat kanë qasje në një port të madh, ku anijet turistike mund të parkohen dhe zbarkojnë me mijëra pasagjerë përgjatë udhëtimeve ditore. Kjo mundësi ekziston në të dyja qytetet kryesore, si Vlora dhe Saranda.

1.4.2. Infrastruktura publike ekzistuese

1.4.2.1 Infrasruktura rrugore

- Rrjeti infrastrukturor i njësisë administrative Sarandë është i prekur edhe nga ndikimet e investimeve dhe financimeve të jugut të Vlorës. Në këtë kuadër mund të theksojmë efektin pozitiv në segmentin Himarë-Qeparo i cili ndjek zhvillimet infrastrukturore nga jugu i Vlorës deri në Orikum ku ndërhyn bypass-i dhe bën shkurtimin dhe çlirimin e trafikut për destinacionin e Himarës dhe Sarandës. Aksesi rrugor i zonës përgjatë rrugës të modernizuar Qeparo–Sarandë, mund të konsiderohet i përshtatshëm dhe pa probleme të veçanta. Kjo rrugë siguron lidhjen me njësitë administrative të Delvinës, Gjirokastrës, si edhe rajonet e veriut dhe Epirin e Greqisë.
Rruga Fier - Gjirokastër–Sarandë aktualisht është në kushte jo shumë të përshtatshme.
Rrjeti rrugor, si në akset kombëtare ashtu dhe në arteriet kryesore që lidhin këto akse me destinacionet turistike dhe fshatrat, Metoq dhe Gjashtë është në kushte jo të mira fizike.
Mungesa e planit urbanistik gjatë gjithë 20 viteve të fundit reflekton direkt kaosin në infrastrukturën si urbane dhe rurale të Sarandës, ndonëse ka patur invesime nga bashkia Sarandë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit ajo vazhdon të mbetet problematike. Në vështrim të parë Saranda karakterizohet nga një rrugë e vetme qëndrore që ka funksion dhe hyrës dhe dalës në qytet. Kjo është rruga Skënderbeu Sh 8. Një numër i kosiderueshëm rrugësh urbane në Sarandë kanë nevoje për mirëmbajtje, asfaltim, ndriçim etj. Gjithashtu për shkak të mënyrës intensive të zhvillimit të ndërtimeve, infrastruktura nuk ka arritur të përshtatet me të njëjtën shpejtësi. Si rrjedhojë shumë rrugë kanë mbetur pa përfunduar.

Njësia Administrative Sarandë

Rrjeti rrugor kryesor. Saranda lidhet me rrjetin rrugor kombëtar nëpërmjet Qafës së Gjashtës Sh 8 2,5 km Qafës së Muzinës 26.5 km e cila e lidh me rrugën 2 të Rrjetit Bazë (SEETO) prej ku shkon në PKK-në e Kakavijës. Po nëpërmjet Qafës së Gjashtës lidhet me rrugën kombëtare të Bregut në drejtim të Vlorës 124 km, e cila është pjesë e korridorit Adriatiko Jonian (Korridori Blu).
Komunikimi në Qytetin e Sarandës mbështet nga pesë rrugë kryesore paralele dhe në disa akse kemi rrugët vertikale me to. Të gjitha rrugët e qendrës së qytetit janë jashtë standarteve dhe mungojnë distancat e trotuareve në shumë segmente të tyre. Rruga hyrëse kryesore në qytet është rruga 'Skënderbeu' 2.1 km, e cila vazhdon deri në qendër të qytetit, ku segmenti i fundit i qendrës 0.8 km është e tipit terciare. Hyrja e qytetit lidhet me qytetin e Sarandës nëpërmjet një rruge në Qafën e Gjashtës e cila është e paorganizuar. Kjo është një rrugë e kategorise B, interurbane kryesore me karrexhata të pavarura por të pandara me trafik ndarës, me 2 korsi'
Rruga që lidh Sarandën me Butrintin nëpërmjet Ksamilit është rregulluar dhe është në gjendje të mirë. Kjo është një rrugë e kategorise C, SH81 me gjatësi 17 km. Kjo rrugë e rindërtuar dhe sitemuar së fundmi duhet të përballoje trafikun turistik për të vizituar Butrintin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Rrjeti dytësor: Përsa i përket rrjetit dytësor të rrugëve në qytetin e Sarandës qytet, rrugët e brendshme ndërlidhëse të lagjeve të qytetit janë në gjendje të keqe edhe për shkak të investimit për rrjetin e ujësjellës-kanalizime. Ka mungesë parkimi në qendër të qytetit si edhe në hyrje dhe në dalje të tij. Qyteti gjithashtu nuk ka terminal të automjeteve për udhëtarët.
Siç u theksua më lart, qyteti i Sarandës ka 5 rrugë paralele me detin që lidhin rrugën hyrëse me pjesën veriore të qytetit duke krijuar dhe unaza në nivele të ndryshme skemike. Shumica e tyre janë me 1 kalim per të lehtësuar qarkullimin dhe problematike mbetet zgjidhja e ndërrimit të parkingeve.
Rruga që lidh portin e qytetit me portin e Limionit rreth 2 km është ndërtuar rishtas. Rruga është me dy kalime dhe me trotuar në të sy krahët por gjërësia e tyre është e limituar prej ndërtimeve dhe janë jashtë standartit.

Metoq
Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të madh të automjeteve veçanerisht gjatë sezonit të verës. Ato janë në gjendje të keqe dhe me dëmtime

Çukë
Rruga e Çukës shërben si unazë për qytetin dhe transporti urban për momentin bëhet nëpërmjet kësaj rruge Metoq - Çukë, duke ndihmuar në lehtësimin e trafikut përgjatë bregut. Kjo është rrugë e kategorise C me dy korsi me gjatës 6 km. Në zonat informale kemi mungesë rrugësh.
Gjashtë
Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të madh të automjeteve veçanërisht gjatë sezonit të verës. Ato janë në gjendje të keqe dhe me dëmtime. Përkatësisht si të tilla radhisim segmentet rrugore:
Shelegar
Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të madh të automjeteve veçanërisht gjatë sezonit të verës. Ato janë në gjendje të keqe dhe me dëmtime. Perkatesisht si të tilla radhisim segmentet rrugore:

Njësia Administrative Ksamil
Në këtë njësi kalon rruga nacionale Sarandë-Butrint (rruga Butrintit) që përbën dhe boshtin kryesor për zhvillimin e tij. Ksamili është një vendbanim i ri që pas viteve 1990 është zhvilluar si vend pushimi dhe sot përbën për nga rëndësia, qendrën urbane të dytë pas Sarandës në Bashki. Rruga kryesore që kalon përmes qytetit të Ksamilit SH81 me gjatësi 2 km e klasifikuar sekondare është në kondicione të mira. Rrugët e qendrës së qytetit janë të tipit rezidencial. Një pjesë e tyre janë të shtruara me asfalt. Rruga kryesore lidhëse e Ksamilit SH 81 është 5.7 m e gjerë, ndërsa rrugët e brendshme ndërlidhese janë të ngushta me gjerësi rreth 5 m. Rruga SH81 vazhdon në drejtim të Butrintit deri në pikën fundore të kanalit të Vivarit. Një rrugë paralele me të është rruga SH 98 që kalon nga Shkalla më pas në Butrint dhe përfundon në Çukë. Ndër rrugët dytësore më problematike përmendim segmentin Butrint - Shkallë 1.40 km.

Parkimet publike: Kryesisht në periudhën e verës çështja e parkimeve të automjeteve kthehet në një problem të vërtetë për vizitorët, duke evidentuar faktin që në zonë nuk ka asnjë parkim formal të administruar nga pushteti vendor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Rrjeti interurban: Rrugët interurbane lidhin qendrat urbane me rajone të tjera, qytetet dhe vendet me interes në te gjithë vendin. Ato ndryshojnë në qëllim, gjerësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga autostradat deri tek rrugët e vogla rajonale të qendrave urbane dhe të fshatrave, gjë që ka një ndikim relativ në moderimin e kufijve të shpejtësisë. Në kuadër të planit, rrugë ndërurbane mendohen të jenë:

- **Rruga kryesore interurbane** është një rrugë e vetme, rrugë me dy kalime, autostra, dëme, shpejtësi e lartë (me zona anësore rezervë), domethënë shtylla ekzistuese e rrugës kombëtare. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikohen si kategoria C.
- **Rruga dytësore interurbane** është një rrugë e vetme, me dy kalime ose me një kalim, që përbën lidhjet primare nga rruga kombëtare për në vendbanimet e veçanta dhe plazhet. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikohen si kategoria C.
- **Rruga lokale interurbane** është një rrugë e vetme, me dy kalime ose me një kalim me standarte më të ulëta të projektimit dhe të shpejtësive të trafikut, e cila lidh vendbanimet individuale dhe/ose zonat e zhvillimit dhe plazhet. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikohen si kategoria F.

Rrjeti urban: Rrugët urbane përbëjnë pjesë të rrjetit rrugor, që shtrihet brenda vendbanimeve urbane dhe rurale të Bashkisë. Ato ndryshojnë në madhësi dhe në shpejtësinë e udhëtimit, duke filluar nga rrugët kryesore në rrugëve për këmbësorë. Të gjitha rrugët urbane duhet të lehtësojnë qarkullimin e këmbësorëve, prandaj trotuarët janë të nevojshme. Për më tepër, shumica e tyre kanë nevojë për të mbuluar nevojat e rastit për parkime në rrugë. Madhësitë e trotuarëve dhe numri i vendeve të parkimit, duhet të përcaktohen, rast pas rasti, sipas nevojave dhe tipareve hapësinore të çdo vendbanimi. Më konkretisht rrugët urbane përfshijnë:

- **Rrugët kryesore urbane** janë rrugë me dy kalime, të projektuara për lëvizje të njëkohësishme përmes trafikut nëpër qytet, dhe për të lidhur nyjet e mëdha ose rajonet. Rrugët kryesore urbane gjenden në qendrat e aktiviteteve kryesore të qytetit, duke përfshirë edhe qendrën e tij dhe qendrat e lagjeve. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikikohen si kategoria D.
- **Rrugët dytësore urbane** janë orientuesit me dy kalime ose me një kalim të trafikut automobilistik në rrugët kryesore urbane, duke organizuar strukturën e qarkullimit të lagjeve të veçanta. Ato funksionojnë si plotësuese të rrugëve kryesore urbane dhe kanë standarte projektimi, në përgjithësi më të ulëta se të parat. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikikohen si kategoria E.
- **Rrugët lokale urbane** janë rrugët e mbetura me dy kalime ose me një kalim, që lidhen me rrugët dytësore dhe mundësojnë qasje të automjeteve në parcela të veçanta. Meqënese këto rrugë janë të lidhura ngushtësisht me zonat e banuara, vëmendje e veçantë duhet të adresohet për të siguruar hapësirat e duhura për lëvizjet e këmbësorëve dhe parkimin në anë të rrugës. Në bazë të Kodit Rrugor klasifikikohen si kategoria F.

Rrugët vetëm për këmbësorë janë të mbyllura për trafik automjetesh ose në çdo kohë ose gjatë orarit të caktuar dhe nxisin qarkullimin e këmbësorëve dhe përdorimin e biçikletave. Ato duhet të krijojnë një rrjet rrugësh për këmbësorët dhe hapësira publike të hapura, duke përcaktuar qarkullimin e këmbësorëve brenda zonave të vendbanimit. Ky lloj i rrugëve është

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

veçanërisht i rëndësishem për pjesët tradicionale të vendbanimeve, rrugët me gur të tipit historik dhe kalldrëmet.



Harta 6 (19c) - Rrjeti rrugor dhe i vendparkimeve publike te propozuar

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

Dimensionet e sistemit të rrjetit rrugor janë të paraqitura në tabelen 4 :











REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

Tabela 5 Kategoritë e Sistemit Rrugor											
Emërtimet		Rrjeti Inter Urban					Rrjeti Urban				
		Rrugë kryesore e Interurbane Autostrada/A2	Rrugë sekondare Interurbane A/B		Rrugë terciare Interurbane		Rrugë kryesore Urbane A/B	Rrugë sekondare Urbane A/B		Lokale Urbane A/B	
1	Numri i Korsive	2+2	1+1	1+1	1+1	1	1+1	1+1	1	1	1
2	Gjerësia e korsive (për drejtimin e trafikut)	3.75 x (2)	3.75	4.00	3.00	4.75	3.00	3.00	5.50	5.50	4.75
3	Gjerësia e krahut të rrugës	2.00 x (2)	1.75	0	0	0	0	0	0	0	0
4	Numri i trotuareve	0	0	0	0	0	2	2	2	2	2
5	Gjerësia e trotuareve	0	0	0	0	0	1.50	1.50	1.50	1.50	1.00
6	Numri i shenjave të pjesës anësore të rrugës	4	2	2	2	2	0	0	0	0	0
7	Gjerësia e shenjave të pjesës anësore të rrugës	0.50	0.50	0.50	0.50	0.5	0	0	0	0	0
8	Gjerësia mesatare e brezit ndarës qëndror	3.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9	Numri i anëve me parkim	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0
10	Gjerësia e korsisë së parkimit	0	0	0	0	0	2	0	1.50	0	0
11	Nr.i rrugëve për bicikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Gjerësia e rrugëve për bicikleta	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13	Gjerësia totale e rrugës	23.00	11.00	8.00	6.00	4.75	11.00	9.00	10.00	8.50	6.75
14	E drejtë kalimi	24.00	12.00	9.00	7.00	5.75	12.00	10.00	11.00	9.50	7.75
	* Rrugët me një drejtim – minimumi i gjerësisë së korsisë së rrugës me një drejtim duhet të jetë 3.00 metra										
	** Kufizimet e parkimit të specifikohen rast pas rasti										

1.4.2.2 Furnizimi me ujë

- Duke marrë në konsideratë hartën hidro-gjeologjike të Shqipërisë, morfologjinë me ujëmbajtës karstik të përhapur gjerësisht dhe malet e larta me shpate të pjerrëta drejt detit Jon, në jug të zonës bregdetare të Shqipërisë, me një mesatare efektive filtrimi në masivet karstike, e cila varion nga 1000 – 1300 mm/vit, mund të thuhet se në këtë zonë gjenden:

- Pasuritë ujore nëntokësore, janë relativisht të kufizuara, për shkak të zhvillimit të fenomenit të karstitit dhe sasisë së konsiderueshme të ujërave, që derdhen direkt në det;
- Rrjedhje ujore sipërfaqësore shumë të shpejta;
- Ndryshim sezonal të ndjeshëm të rrjedhjës;
- Përrenj përkohësisht të thatë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

Kompania e furnizmit me ujë është UK Saranda, sh.a., që furnizon qytetin por edhe Ksamilin. Qyteti i Sarandës ka dy burime ujore te furnizimit me ujë: Burimi i Navaricës, që ndodhet rreth 13 km në lindje të Sarandës. Uji merret nga burimi dhe transferohet në Sarandë nëpërmjet një tubacioni çeliku me diametër 250 mm me rënie të lirë. Kapaciteti i këtij burimi është një 120 l/sek. Pusi i Vrionit, që ndodhet rreth 3.5 km nga Saranda. Ujrat nëntokësorë nxirren dhe pompohen në zonën e shpërndarjes, gjë që rrit koston për shkak të përdorimit të energjisë elektrike. Tri puse të thellë përbëjnë një kapacitet total prej rreth 225 l/ sek. Ujëmbledhësi (puset) i Vrionit lidhet me linjën e transmetimit te Navaricës në afërsi të ujëmbledhësit dhe në këtë mënyrë furnizon edhe në rezervuarin në Qafën e Gjashtës.
Fshatrat Gjashtë, Metoq furnizohen me puse dhe me ngritje mekanike fshatrat Çukë dhe Shelegar furnizohen nga ujësjellësi i Çukës. Edhe pse të gjitha fshatrat kanë rrjetin e vet të tubacioneve ekzistuese, cilësia e tyre lë shumë për të dëshiruar, referuar parametrave te kërkuar teknikë, duke shkaktuar humbje të mëdha teknike dhe rënie të efikasitetit të shpërndarjes/furnizimit me ujë.

1.4.2.3 Rrjeti i Kanalizimeve

Grumbullimi dhe përpunimi i ujerave të ndotura është problemi më i madh në vend, pasi shumë pak qytete kanë impiante të trajtimit dhe përpunimit të tyre, dhe të gjitha ujërat e ndotura më së shumti shkarkohen direkt në det. Ky problem bëhet shumë serioz sidomos në qytetet turistike. Prej disa vjetesh sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është nën administrimin e pushtetit lokal. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit mbulojnë politikat e zhvillimit dhe problematikat teknike të sektorit. Për shkak të karakterit shkëmbor të shtresave nëntokësore dhe mungesës së shtresave ranore dhe përzjerjeve te saj, nuk ka filtrim të pjesshëm apo depërtim të ngadalshëm në thellësi. Kjo situatë është duke ndikuar në ndotjen e ujërave nëntokësore, sidomos kur puset për furnizimin me ujë janë të vendosura pranë gropave septike, duke përbërë kështu një rrezik të përhershëm për pellgjet ujore nëntokësore që përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës lokale. Shërbimet për sistemin e kanalizimeve kryhen nga ndërmarrja e UK-së Sarandë sh.a.
Me një projekt të mëparshëm është bërë e mundur mbledhja e ujërave të zeza për trajtim në impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura në qytetin e Sarandës. Ky impiant,që mbledh ujërat e ndotura të zonave Sarandë dhe Ksamil, është projektuar për një popullsi prej 70.000 banorë dhe ka një kapacitet prej 12,240 m3/ditë. Në shumë fshatra dhe njësi si Metoq, Shelegar etj., si dhe në zonat informale të qytetit të Sarandës kemi përdorimin e gropave septike.

1.4.2.4 Furnizimi me Energji dhe Telekomunikacioni

Furnizimi me energji i Sarandës është nën juridiksionin e Drejtorisë së Tensionit të Lartë Jugperëndim me agjenci në Sarandë. Kjo Agjenci mbulon Sarandën dhe Konispolin. Aktualisht rrjeti i shpërndarjes për bashkinë Sarandë realizohet nga nënstacionet:

Sarandë e vjeter 35/10 kv.

Sarandë e re 110/20kv.

Për gjithë jugun e Shqipërisë është në proces zgjerimi i rrjetit 110 kV. Unaza e Jugut përfshin linjën Babicë – Sarandë, 104 km e gjatë. Ndërtimi i kësaj linje ka mbyllur në unazë një pjesë të

rëndësishme të rrjetit elektrik 110 kV, që do të përmirësojë cilësinë e furnizimit me energji të zonës dhe gjithashtu garanton funksionimin e sigurtë të HEC-it Bistricë. Përmes ketij Projekti është zgjeruar dhe fuqizuar nënstacioni 400/110 kV Zemblak.

Telekomunikacioni. Rrjeti telefonik është kabllor, kryesisht në linja tokësore bakri dhe pjesërisht me ato ajrore. Albtelekomi ka hartuar projekte me qëllim futjen e shërbimeve të reja përveç thjesht ekzistencës së telefonit, të tilla si interneti i shpejtë dhe televizionit kabllor. Për këtë qëllim është e nevojshme qe të ndryshojë teknologjia ekzistuese e rrjeteve, zgjerimi dhe shtrirja e fibrave optike në mënyrë që të reduktohet gjatësia mesatare e linjave.
Aktualisht bashkia Sarandë ka një mbulim të kufizuar nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator nuk është në gjendje të mbulojë një pjesë të territorit të ish-komunës me telefoninë valore. Përdorimi i kabllove optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen nga operatorë të fuqishëm mobile si T-Mobile, Vodafone, Eagle.

1.4.2.5 Menaxhimi aktual i mbetjeve urbane

Mbetjet përpunohen në *landfildin* e Bajkaj. Ky Landfild i shërben bashkive të Delvinës, Sarandës, Himarës. I ndërtuar në një zonë kodrinore me lartësi rreth 150 m mbi nivelin e detit, në një sipërfaqe prej 12 há, landfilli do të ketë një kapacitet përpunues ditor prej 140 ton mbetje dhe kapaciteti depozitues në total është për 365.000 m 3 mbetje për një periudhë shfrytëzimi prej 25 vitesh. Ai ndodhet afërsisht 12 km në veri të qytetit të Sarandës, në distancë 1,5 km nga fshati Bajkaj dhe 1,4 km nga fshati Palavli. Sasia vjetore e mbetjeve të ngurta (shtepiake) për bashkinë Sarandë është 10.000
Vendosja e kolektorit të ujrave urbane në vitin 2003, ka ulur dukshëm pjesën më të madhe të shkarkimeve të këtyre ujërave në Gjirin e Sarandës. Sidoqoftë shkaku kryesor i ndotjes me tregues bakterialë janë mosfunksionimi i duhur i impianteve të trajtimit të ujërave dhe shkarkimet urbane të patrajtuara. Aktualisht evidentohet një mungesë e strukturave të mirëfillta mbledhëse dhe shkarkuese në shumë zona të banuara të Ksamilit.

Figura 1 Gropa septike familjare

Burimi: Foto nga Ekspertet

Figura 2 Humbje teknike te ujit

Burimi: Foto nga Ekspertet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.4.2.6 Hapësirat e gjelbërta dhe publike

Hapësira publike është hapësira e jashtme, si trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme, në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat. Hapësira publike përfshin rrugë kalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në të përdorimit publik pavarësisht nga regjimi juridik i tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas Ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit". Plani i Përgjithshëm Vendor ka analizuar hapësirat publike ekzistuese dhe ka ardhur me disa propozime për përmirësimin dhe shtimin e tyre. Shëtitoret dhe bulevardet në Sarandë karakterizohen nga një bimësi e pemë të reja dhe të rritura. Të kombinuara me trotuarët e gjerë, disa prej tyre mund të karakterizohen si "akse pedestriane të gjelbërta"

Figura 3 Sheshi Pavarësia në qytetin e Sarandës

Bregdeti urban i Sarandës është elementi më i njohur i qytetit dhe burimi kryesor turistik. Atje janë përqendruar shumica e shërbimeve turistike, hapësirat më të frekuentuara publike dhe pikat e takimit për vizitorët dhe komunitetin lokal. Megjithatë ky burim i vlefshëm është nën kërcënim të madh.

Gjatë dekadave të fundit tendencat e zhvillimit të shpejtë urban kanë rezultuar në zgjerimin e qytetit përgjatë bregdetit, kryesisht në jug, por edhe në gadishullin e Kodrës së Limionit me zhvillimin e hoteleve private dhe shërbimeve turistike, të cilat kanë zaptuar bregdetin duke bllokuar qasjen në det. Sot pjesa e vetme e bregdetit që mbetet e hapur si një zonë shëtitore publike është pjesa përballë qendrës historike nga porti deri në hotel Butrinti. Mungesa e aksesit publik kufizon tërheqjen turistike të qytetit, por edhe krijon probleme për pronarët e hoteleve të cilat janë të vendosur në vijë të dytë në bregdet dhe duan të sigurojnë qasje në plazh për klientët e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Figura 4 Bregdeti urban i Sarandës që është burimi më i vlefshëm turistik dhe hapësira më e gjallë publike e qytetit
Burimi: Foto nga Ekspertët

Bashkia e Sarandës është e informuar për këtë problem dhe kërkon ta trajtojë duke shqyrtuar opsionet e ndryshme në mënyrë që të zgjerojë zonën e shëtitores publike dhe të sigurojë qasje në det. Konsulentit i është kërkuar të bëjë sugjerime të bazuara në planifikim dhe në zgjidhjet teknike në mënyrë që të përcaktojë deri në çfarë pike duhet të zgjerohet shëtitorja dhe se si kjo duhet bërë. Gjithashtu duhet konsideruar nëse ekziston mundësia e një rruge të vazhduar nga Saranda deri në Ksamil. Pas kësaj kërkese, ekspertët bënë një analizë të gjendjes gjatë gjithë bregdetit të Sarandës për të vlerësuar mundësitë ekzistuese dhe kufizimet.

Në bazë të kësaj ankete është bërë një klasifikim i bregdetit në tri kategoritë e mëposhtme:

- Zonat ku mund të zgjerohen shëtitoret publike me përdorim turistik. Këto do të jenë kryesisht zona të urbanizuara, ku do të përqëndrohen funksionet rekreative. (Zonat e përcaktuara me ngjyrë të verdhë në hartë)
- Zonat ku përdorimi i bregdetit do të mbetet privat por ku duhet të krijohet qasja publike në det në vende të veçanta ndërmjet pronave private (zona e përcaktuar me ngjyrë blu në hartë).
- Zonat ku karakteri i bregdetit do të mbetet natyral. Në këto zona nuk është e nevojshme ndërtimi një shëtitoreje urbane, por aksesi publik mund të sigurohet nëpërmjet një shëtitore pejzazhistike që do të vijojë përgjatë bregdetit (zonat me ngjyrë të gjelbër në hartë).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA



Harta 7– (19e) Hapësirat publike, rrugët e biçikletave dhe këmbësore të propozuara

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.5 Zonat e mbrojtura kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve

Saranda është qyteti më i pasur në vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane. Kjo trashëgimi e pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, përbën bazën më të rëndësishme për të promovuar zhvillimin e imazhit aktual të Sarandës, si një destinacion i turizmit klasik botëror, si dhe për të tërhequr tregun e turizmit të veçantë. Me VKM-në Nr. 676 date 20.12.2002, VKM Nr. 531 datë 31.10.2002, VKM 693 ndryshuar me VKM Nr.134 datë 20.02.2013 kanë përfituar statusin e zonës së mbrojtur në bashkinë Sarandë monumentet dhe zonat.

Qyteti i Sarandës, në veçanti, ka qenë një port i rëndësishëm në lashtësi nga shekulli i 3-të dhe sot ka një muze etnografik. Butrinti është entiteti arkeologjik dhe natyror më i rëndësishëm për rajonin e Sarandës e më gjerë. Ky është një Park Kombëtar dhe një vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe përbën një nga atraksionet kryesore të Shqipërisë jugore, duke ofruar turizmin dhe disa aktivitete kulturore. Zonë e Trashëgimisë Botërore, Butrinti përfaqëson objektin kulturor më të rëndësishëm të bashkisë së Sarandës dhe zonën arkeologjike më të njohur të Shqipërisë.

Trashëgimia kulturore në rrethin e Sarandës përbën një nga thesaret më të rëndësishëm të historisë dhe artit, jo vetëm për rajonin më jugor të vendit, por edhe të Shqipërisë. Qyteti është i pasur në vlera të rralla të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane.

Në qytetin e sotëm të Sarandës janë gjetur gjurmë ndërtesash të Periudhës perandorake Romake. Ndërmjet monumenteve të zbuluara të kësaj kohe tërheqin vëmendjen mbeturina godinash disa kthinëshe, të cilat janë vendosur pranë bregut të detit.

Bashkia Sarandë, pas ndërhyrjeve restauruese, apo mirëmbajtëse dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme nga ana e specialistëve, informon se këtë vit 13 kështjella, 21 tempuj dhe objekte kulti, 5 qytetërime të lashta dhe dhjetra monumente të tjera, krenari e trashëgimisë kulturore, janë gati të mirëpresin turistët dhe vizitorët për të parë nga afër ambientet dhe historinë që ofrojnë.

Tabela 6 Lista e monumenteve të natyrës dhe e zonave të mbrojtura në bashkinë Sarandë

Nr.	Sarandë	Emërtimi
1	Ksamil	Pylli i Butrintit (II)
2	Ksamil	Ishujt e Ksamilit (II)
3	Sarandë	Pllakat e Sarandës (III)
4	Ksamil	Liqeni i Butrintit (II)
5	Ksamil	Kanali i Vivarit (II)

Zona të mirëfillta banimi ndeshen brenda kufirit të vjetër të vendbanimeve, me ndërtesa të periudhës para viteve 1990, por gjithashtu dhe me zgjerime që janë bërë në drejtim të dy maleve, Nakos dhe Eremis. Banesa me disa funksione, hotele, ambjente argëtimi i ndeshim kryesisht në vijën/fasadën bregdetare, ndërsa godina banimi dhe me funksion komercial pothuajse në të gjitha ndërtimet e reja përgjatë akseve rrugore të rrjetit rrugor kryesor. Hapësirat e lira publike që ekzistojnë në vendbanim nuk janë të mjaftueshme.

Vendbanimet Gjashtë, Metoq dhe Çukë, që kanë varësi të drejtpërdrejtë nga Saranda si nga pikëpamja territoriale ashtu dhe përsa i përket shërbimeve, ruajnë karakter rural (Gjashta dhe Metoqi më shumë dhe Çuka diçka më pak), pavarësisht përpjekjeve për urbanizimin e tyre, sidosmos pas viteve 1990, me godina dhe funksione të reja (Çuka). Të gjitha vendbanimet shtrihen në formë amfiteatrale dhe paralelisht me konturet e majave.

Karakteristikat e përbashkëta të vendbanimeve janë godinat private të vogla njëkatëshe, me oborre dhe kafshë shtëpiake, rrjeti rrugor në gjendje të keqe, mungesa e hapësirave të lira publike, infrastruktura sociale në nivele elementare (shkolla, kisha, xhami, kënde lojrash, varreza). Në territoret përreth vendbanimeve ndeshemi me objekte të shpërndara rurale, depo (ambjente) për ruajtjen e lëndëve të ndërtimit, auto-ofiçina si dhe rrënoja të aktiviteteve të dikurshme. Ka gjithashtu dhe sipërfaqe të konsiderueshme me kultura bujqësore.

Në veri të Ksamilit, vendbanimi i Manastirit është një zonë me struktura të rralla, ndodhet në pjesën më të ulët të malit Dema (me lartësi 90 m), me shtrirje në formë rrezeje që del nga një rrugë kryesore gjarpërore dhe që përbën një devijim të rrugës nacionale Sarandë-Ksamil. Nëse dikush lëviz në këtë vendbanim, zbulon të dhëna të rëndësishme, si nga pikëpamja historike ashtu dhe nga ajo ndërtimore, si në përgjithësi ashtu edhe në veçanti. Me interes është qendra historike e qytetit dhe zona që e rrethon, që shtrihet në një sistem me blloqe ndërtimi me thellësi të vogla që ndodhen ndërmjet rrugëve paralele dhe trotuareve pingul me shkallë, për shkak të diferencave në nivelet e lartësisë. Mjaft ndërtesa janë të periudhës komuniste të qytetit të vjetër. Si godinat e pakta të ruajtura nga kjo kohë përmendet sot Muzeu i Trashëgimisë Kulturore, që i përket periudhës përpara vitit 1945, kohës kur ky vendbanim kishte lidhje ekskluzive me portin dhe selinë italiane dhe gjermane, në Luftën e II^{te} Botërore. Rrënojat e murit rrethues të qytetit egzistojnë në qendrën "historike", në perimetrin rrethues të vendbanimit, në blloqet e ndërtimit dhe në det. Kjo zonë përfshin "qendrën historike" (A) dhe zonën e zgjeruar (B) pjesë e rëndesishme në lindjen e aksit rrugor të tërthortë, rrugën Adem Shena, midis rruges Lefter Talo (4^{t}) dhe rrugës Gjergj Araniti (5te) dhe një pjesë në perëndim, në kufi të hapjes së re të aksit të 5^{të}.

Brenda këtyre kufijve, shquhen lagjet e vjetra por me karakter urban me funksione të ndryshme, në qendrën historike dhe më në lindje me blloqet e ndërtimit ndërmjet rrugës Skenderbeu (2te) dhe rrugës Lefter Talo (4te), ndërsa zona tjetër e vjetër ka banesa të mirëfillta, me godina të vjetra rurale njëkatëshe me kopshte dhe kafshë shtepiake si dhe pallate që i përkasin periudhes para viteve 1990, që ndodhen në kushte mesatare, pa dalje dhe me shumë rrugë të paasfaltuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Harta 8 – (18g) Harta e objekteve dhe zonave të rëndësisë kombëtare të propozuara

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.6 Zonat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban

Vizioni dhe strategjia e zhvillimit territorial të bashkisë Sarandë e shikon rolin e qendrës së Sarandës të lidhur ngushtë me turizmin rajonal dhe zhvillimin e agronomisë. Plani Kombëtar dhe PINS-i Bregdeti e shikon funksionin e Sarandës si një vitrinë (ekspozim) për promovimin e produkteve agrikulturore vendase duke krijuar në Sarandë një pol buqësor dhe agropërpunuese që kombinon funksionet e "prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtisë.

Bashkia Sarandë ka pamjaftueshmëri dhe mungesë të hapësirave të disponueshme për zhvillimin e shërbimeve, mbështetje për zhvillimin e agroekonomisë dhe aktiviteteve ekonomike, sikurse janë garazhet e mëdhenj dhe depot. Aktivitetet ekonomike aktuale janë duke u zhvilluar në mënyrë spontane përgjatë rrugës kryesore hyrëse për në qytetin e Sarandës, një mënyrë që krijon probleme të shumta me trafikun dhe me një impakt negativ (zhurmë dhe rrëmujë) tek banorët që përdorin rezidencat.

Plani i Sarandës parashikon përqendrimin e zonave ekonomike dhe shfrytëzimin e zgjerimit institucional në projektime zonash kolektive, në mënyrë që të mos krijojë problem me trafikun dhe të limitojë impaktin negativ në zonat e vendbanimeve. Këto zona receptor janë alokuar përgjatë aksit të rrugës kryesore në zonat fushore në hyrje të qytetit ndërmjet fshatrave ekzistues të Metoqit, Gjashtës, Shelegurit dhe Çukës. Në mënyrë të veçantë:

Industria e lehtë (njësitë e riciklimit) dhe zonat e përpunimit në rrugën e Delvinës nga Shelegar deri tek kryqëzimi. Aty do të përqëndrohen të gjithë funksionet me impakt të mesëm, si garazhe të mëdhenj, fabrika e çimentos etj.

Një zonë tregtare në afërsi të urës së lumit Kalasa me qëllim që të përqendrohen të gjitha funksionet tregtare në mbështetje të turizmit dhe të ekonomisë së shtëpive të dyta, të tilla si supermarket i madh, qendër tregtare, dyqane mobiljeje, pajisje për shtëpi, materiale etj

Një zonë për agroekonomi dhe tregti bujqësore dhe panaire lokale për promovimin e produkteve vendore (vitrine) është propozuar të jetë e vendosur në Metoq përgjatë rrugës që vjen nga Konispoli, ku ekzistojnë një numër objektesh dhe dhe depo të papërdorura.

Pozicionimi i territorit mes dy kodrave, tashmë i kompromettuar nga përdorime të ngjashme, nuk ndikon negativisht, por është një lidhje e mirë me zonat bujqësore të Voulkos (Finiqit) dhe Konispolit.

Çuka është menduar poli i dytë mbështetës për funksionimin e agrobiznesit (depove bujqësore. Zonat ekzistuese të materialeve të ndërtimit dhe magazinat për pajisje, përgjatë rrugës kryesore, janë të integruara në zonim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 5 Propozimi për vendodhjen e Qendrës Tregtare të Agrobiznesit në Sarandë

Zonat ekonomike janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Sarandës por edhe në njësinë adminsitative Ksamil të Bashkisë Sarandë. Totali i zonave ekonomike të bashkisë Sarandë i shprehur në hektarë është 95.41 ha. I shprehur në njësi administative :

- Saranda ka një siperfaqe të dedikuar për zonat ekonomike prej 94.20 ha
- Ksamili ka një sipërfaqe të dedikuar për zonat ekonomike prej 1.21 ha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Harta 9– (18d) Zonat, polet, korridoret ekonomike të propozuara

1.7 Tipologjitë e propozuara hapësinore dhe metodat e ndërhyrjes në territor

Gjatë fazës së analizës territoriale kanë qënë të identifikuara tipologjitë e zonës urbane të bashkisë Sarandë, sipas situatës ekzistuese të zhvillimit. Kjo analizë ka përfshirë të gjithë sistemin urban për të gjithë territorin e Bashkisë (shiko nënçështjen 2.2 dhe hartën 13 dhe 13.a13.b)

Për qytetin e Sarandës analiza tipologjike ka ndjekur faza të ndryshme, kryesisht në zhvillimin historik të qytetit:

- Zona e Qendrës Historike. Kjo zonë përfshin "Qendrën Historike" (A) dhe zonën e zgjeruar (B), pjesë e rëndësishme në lindjen e aksit rrugor të tërthortë, rrugën Adem Shena, midis rrugës Lefter Talo (4^{t}) dhe rrugës Gjergj Araniti (5te) dhe një pjesë në perëndim, në kufi të hapjes së re të aksit të 5te.
- Zona rezidenciale në veri të Qendrës Historike deri në rrugën e pestë.
- Zona e "Kodra Limanit" është një zonë rezidenciale qendrore e mbindërtuar me ndërtesa të tipit socialist dhe blloqet e reja rezidenciale me shtëpi dhe shtëpi të dyta që ndjekin linjë të njëjtë me topografinë e kodrës.
- Rajonet jugore–juglindore. Në veri të zonës së mësipërme, sipër rrugës bregdetare janë përqëndruar më shumë hotelet stock dhe shtëpi të dyta.
- Rajoni verior i qytetit dhe zonat kodrinore në perëndim mbi rrugën 5 me pjerrësi tepër të lartë përbëhen nga zona rezidenciale me mungesë lidhjeje me rrugët dytësore dhe shërbime si dhe me një përqindje të lartë të ndërtimit informal.
- Zona Ballinës ujore është zona poshtë rrugës detare, e cila është zënë kryesisht me blloqe banimi të larta dhe përdoret për turisëm dhe shtëpi të dyta (S 2.A5), po ashtu si shërbime plazhi (S4).
- Zona e fshatrave rurale me karakter kodrinor orientohet drejt lindjes dhe kryesisht funksionimit rezidencial me disa përdorime bujqësore Gjashtë, Metoq, Çuka, Shelegur)

Për qytetin e Ksamilit tipet kryesore që janë identifikuar, po i citojmë më poshtë:

- Qendra e vjetër e qytetit të Ksamilit;
- Zona e turizmit në bregdetin e Ksamilit;
- Zgjerimi i banimeve pas viteve 1990, i cili zaptoi pjesën më të madhe të zonave urbane, përbën kombinimin midis shtëpive të ngjeshura dhe shtëpive me funksionim turistik "dhoma me qera";
- Zgjerimet e përdorimit të tokës për banim me karakteristika të ngjashme në reliev kodrinor.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANE · SEKRETARIA



Harta 10– (18f) Harta e tipologjisë të ndërtimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Harta 11 (18f II) - Harta e tipologjise së ndërtimeve

Dendësim/Mbushje urbane e tokës: Kodi [DENDES] - është procesi i densifikimit të një njësie të sistemit urban pjesërisht të zhvilluar dhe kryesisht homogjene për nga kategoria e përdorimit të tokës, me struktura të të njëjtit karakter, funksion, përdorim, tregues të planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit me ato të pronave/strukturave me të cilat kufizohet. Kjo mënyrë ndërhyrjeje synon përdorimin sa më efiçent të tokës truall si dhe rrjeteve të infrastrukturave publike. Kjo lloj ndërhyrje vlen vetëm për zonat urbane ekzistuese dhe duke iu referuar zonave relativisht të vogla të tokës vakante në mes të territoreve të urbanizuara ose pjesërisht të urbanizuara. Ata zakonisht nuk kërkojnë një PDV.

Mbushja urbane nënkupton zhvillimin e parcelave bosh/të pandërtuara me ndërtime të reja, me tregues zhvillimi të ngjashëm me ato të të gjithë zonës, që do të thotë se treguesit në nivel parcele ngelen të njëjtë me treguesit që mbizotërojnë në zonë, ndërsa treguesit në nivel njësie do të rriten si pasojë e dendësimit. Kjo lloj ndërhyrjeje nuk ndryshon në asnjë rast karakterin dhe tipologjinë e ndërtimit. Ndërhyrjet infrastrukturore janë përmirësuese, por jo thelbësore.

Për bashkinë e Sarandës kjo lloj ndërhyrje i referohet tipeve të mëposhtme:

- Zonë urbane e pambushur brenda qytetit të Sarandës (A3)
- Zona të pambushura me ndërtime për shërbime turistike dhe shtëpi përgjatë zonës bregdetare të Sarandës (S2, A5)

Konservimi Urban Historik / Konservimi Natyror: Kodi: [KONSERV] - është procesi i ruajtjes dhe i mbrojtjes së një territori ose ndërtimi të caktuar, në formën e tij ekzistuese origjinale. Kjo kupton tërësinë e veprimeve të ndërmarra nga Bashkia apo çdo person juridik ose fizik, të cilat synojnë ruajtjen e një përdorimi, strukture dhe territori uban, të veshur me vlera ekonomike, sociale, historike e kulturore dhe mjedisore në kohë, dhe të raporteve që ajo

krijon me mjedisin natyror apo të ndërtuar që e rrethon, për të realizuar zhvillim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm në fuqi .Konservimi ka dy aplikime të ndyshme duke ju referuar urbanizimit dhe territorit natyror. Konservimi urban nënkupton ruajtjen e karakterit, tipologjive dhe përdorimit ekzistues të zonave të caktuara të qytetit dhe të fshtrave. Shkalla e ndërhyrjeve në lidhje me rritjen e intensitetit dhe strukturat e ndërtimit është minimale, ndaj treguesit e propozuar përputhen ose janë përafërsisht të barabartë me ato të gjendjes ekzistuese. Në qytet dhe qendrat e fshtarave ndërhyrjet nënkuptojnë rehabilitimin e infrastrukturave, shërbimeve publike, banesave, elementëve të dezainit urban. Këto ndërhyrje aplikohen në zonat e kompleksève të banimit me koncepte hapësinore të qarta të ndërtuara para viteve '90.

Për bashkinë e Sarandës Konservimi Urban i referohet:

- Zonës arkeologjike A, B (M1, M2) / Qendra Historike (A1)
- Monumenteve të trashëgimisë kulturore zona (M3) / Kalaja e Sarandës, Manastiri i Sarandës, zona arkeologjike e Butrintit, etj)
- Konservimi Natyror i referohet territoreve brenda sistemit natyror dhe sistemit të ujit, të cilat formojnë burime të vlefshme natyrore të Bashkisë që meritojnë të jenë të mbrojtur nga zhvillimi. Janë të përfshira në këtë kategori kombëtare zona të mbrojtura sipas legjislacionit ne fuqi (N1, N2, N3 dhe U1, U3, U4) dhe zonat e mbrojtura të propozuara nga PPV-ja duke iu referuar kategorive të zonimit (N5, N6)

Koncepti i Konservimit është aplikuar edhe në zona të tjera të cilat nuk i përkasin sistemit natyror dhe ujor, por janë të mbrojtura nga zhvillimi me anë të zonimit të tyre të caktuar nga PPV-ja, përkatësisht:

- Toka bujqësore e kategorive (B1, B2) nën Konservimi Bujqësor me kuptimin e mbrojtjes së përdorimit të tokës për qëllime bujqësore.
- Sipërfaqet e gjelbra dhe hapësirat publike, pyjet përreth, janë kthyer streha (AR3, AR4)
- Në Sarandë fushat kryesore të destinuara për Konservimin Natyror janë:
- Parku Kombëtar i Butrintit
- Shpatet malore në zonat bregdetare të Bashkisë
- Zonat e trupave ujorë tampon në Liqenin e Butrintit, Kanali i Çukës, lumi Kalasa;
- Plazhet me rërë (N8) dhe pjesët natyrore të bregdetit Ksamil, buzë detit;
- •Zonat e mbrojtura pejzazhe - kodrat e qytetit të Sarandës dhe pjesë të Gadishullit të Ksamilit;

Konsolidim Urban Kodi: [KONSOL] është procesi i zhvillimit të territorit, i cili ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e infrastrukturës dhe strukturës urbane ekzistuese duke nxitur ndërtimin brenda zonave të urbanizuara. Konsolidimi Urban korrespondon me kuptimin e zhvillimit kompakt urban. Ai kupton zhvillimin e zonave të urbanizuara me qëllim mbrojtjen e tokave bujqësore dhe shfrytëzimin efiçent të infrastrukturave publike. Procesi kryesor është ai i realizimit të ndërtimeve të larta, pra me rritje të intensitetit si në nivel zone ashtu edhe në nivel parcele, dhe/ose i rritjes së lartësisë dhe/ose gjurmës së objekteve përmes shtesave, dhe ndërtimi i infrastrukturave të shërbimit. Këtu nënkuptohet gjithashtu rikualifikimi dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

përforcimi i strukturës urbane i atyre zonave, të cilat kanë një skelet hapësinor, ose fillesa të tij të mirëpërcaktuara, por për arsye të ndryshme në zona kanë ndodhur shumë ndryshime.
Konsolidimi Urban vlen për pjesën më të madhe të zonave ekzistuese urbane të qyteteve shqiptare duke iu referuar kryesisht zhvillimit pas viteve 1990 përmes proceseve të ndërtimit informal apo të zhvillimit me densitet të ulët shpërndarës që mund të çojë në përdorimin joefikas të tokës.
Një përcaktim i dytë i konsolidimit Urban i referohet përqendrimit të aktiviteteve ekonomike në zona të specializuara për një komunitet të caktuar nëpërmjet planit. Duke pasur parasysh që aktivitetet ekonomike kanë ndjekur si model një zgjerim zhvillimi të ngjashëm dhe zhvillim spontan. Në këtë rast lind nevoja për një përqendrim të tyre në mënyrë që mund të minimizohet ndikimi negativ për përdorime të tjera dhe për të rritur efektin e mundshëm pozitiv në klaster.

Për bashkinë Sarandës zonat kryesore të destinuara për Konsolidim Urban janë:
- Të gjitha zonat e vendbanimeve rurale, banim (e A4)
- Zonat urbane informale, banim (A4)
- Zonat shtëpitë e dyta (A5)
- Zonat e organizuara / receptorë për aktivitete ekonomike (IE2,3,4)

Rigjenerim/Rikualifikimi: Kodi [RIGJEN] Nënkuptohet ringjallja, rikthimi i funksineve të mëparshme, ose rehabilitimi, rikthimi i vetive natyrale pejzazhistike të zonave të degraduara të cilat në gjendjen aktuale e kanë humbur atë. Shkalla e ndërhyrjeve në këto zona varion që nga ndërhyrjet ndërtimore e deri tek sistemimet e terrenit, krijimi i brezave të gjelbër, apo trajtimet pejzazhistike për të ritheksuar vlerat estetike të qytetit dhe fshatrave. Rikualifikimi ekonomik zbatohet në zona ekonomike, të cilat kanë degraduar por nga pozicioni i tyre në qytet, mbeten përsëri të rëndësishme për të funksionuar si të tilla. Rikualifikimi ambjental pejzazhistik zbatohet në territore të lira të cilat për efekte ambientale apo pejzazhistike propozohen të kthehen në breza të gjelbër sanitar dhe rekreativ. Koncepti i rikualifikimit i referohet kontekstit të sistemeve natyrore dhe bujqësore.
• Rikualifikimi në sistemin urban synon të realizojë përmirësimin e cilësisë së mjedisit urban, duke u fokusuar kryesisht në hapësirat dhe burimet publike;
• Rikualifikimi në sistemin natyror i referohet konceptit të rehabilitimit të pejzazhit dhe natyrës në rastet e zonave me dëmtime mjedisore ose zona të degraduara;
• Rikualifikimi në sistemin e bujqësisë i referohet rastit të tokës së papunuar si dhe tokave me pjellori të ulët;

Për bashkinë Sarandë zonat kryesore të projektuara për Rigjenerim/Rikualifikim janë:
- Akupunturë urbane-(AR3, AR4)-zona për shëtitore publike;
- Toka buqësorë të kripëzuara (B6) (Liqeni Butrintit);
- Zonat e rigjenerimit natyror (N2, N3, N6)- Pyllëzimi i kodrave të Sarandës, përbalë Ksamilit

Rizhvillim: Kodi [RIZHVIL] është procesi i zhvillimit dhe i rindërtimit të një zone, e cila është e ndërtuar, por e degraduar dhe kryesisht me mungesa të funksioneve kryesore. Rizhvillimi është një veprim në procesin e planifikimit, në njësitë me dendësi të mesme deri të

lartë banimi dhe përdorimi, i cili ka për qëllim të rivlerësojë treguesit e zhvillimit të njësisë. Kryhet në zona të zhvilluara më parë, duke ndryshuar tërësisht strukturën e ndërtimeve ekzistuese, funksionet e tyre dhe/ose treguesit e zhvillimit (Intensitet, Ksht, Kshr, Kshp). Zonat e dedikuara për rizhvillim janë gjithmonë subjekt i PDV-së.

Për bashkinë e Sarandës fushat kryesore të destinuara për Rizhvillim janë:

- Programi rizhvillimit urban për "Sunset boulevard" në qytetin e Sarandës, (Projekti Pilot i propozuar nga Plani)
- Rizhvillimi i portit komercial të qytetit të Sarandës në zonën rekreative, (Projekti Pilot i propozuar nga Plani)
- Rizhvillimi i "Fabrikës" zonë industrial
- Magazinat e braktisura bujqësore në Metoq, rizhvillimi në qendra tregëtare për produkte bujqësore. (IE4)

Urbanizim, Kodi: [URBAN]

Eshtë procesi i ndryshimit të territorit nga përdorim rural në urban. Urbanizimi është i lidhur me rritjen graduale të përqindjes së popullsisë që jeton në zonat urbane dhe mënyrat në të cilat çdo shoqëri i përshtatet këtij ndryshimi. Ky proces ka filluar në Shqipëri kryesisht në periudhën pas viteve 1990 deri në fillim të viteve 2000 dhe ka kryer një ndryshim të rëndësishëm të përdorimit të tokës nga bujqësore dhe natyrore në favor të sistemeve urbane. Në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm demografik dhe mbrojtjen e tokës primare bujqësore dhe natyrore janë propozuar për urbanizimin zona shumë të vogla përmes PPV.
Procesi i urbanizimit në kontekstin e zonës së studimit për Bashkinë Sarandë i referohet kryesisht zonave të propozuara për zhvillimin e turizmit si:

- hotele dhe resorte (ST2, ST3);
- shtëpi të dyta të kufizuara (A5);
- zona ekonomike ne pjesen e pasme te qytetit te Sarandes (IE2, IE3, IE4)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Harta 12 – (18e) Mënyrat e ndërhyrjes së propozuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

1.8 Përcaktimi i njësive që do t`i nënshtrohen hartimit të PDV-ve sipas ligjit

Zonat dhe njësitë strukturore, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-ve janë të përcaktuar sipas tipologjive kryesore të zonave si edhe mbi bazën e detyrime ligjore për ato njësi që do t`i nënshtrohen hartimit të PDV-së. Klasifikimet e njësive vijojnë si më poshtë:

. Tipologjitë kryesore të zonave të projektuara për PDV janë:

a. Zonat e propozuara për format e organizuara të investimeve turistike (resorte-vila). Nënkategoritë S3 (ose/dhe S2).
b. Zonat e zgjerimeve rezidenciale me sipërfaqe më shumë se 5 ha, sidomos në zonat bregdetare turistike. Nënkategoritë A4, A5.
c. Zonat e propozuara të aktiviteteve të organizuara ekonomike me sipërfaqe më shumë se 5 ha ose me ndikim të mesëm ambjental. Nënkategoritë IE1-4.
d. Zonat me prioritet zhvillimi, të projektuara nëpërmjet zonimeve të PPV për rizhvillim, ristrukturim ose rikonceptim.
e. Zonat e ndërtimeve informale.
f. Tipologjitë kryesore të zonave, ku nuk ka detyrim për hartim të PDV-ve janë:
g. Qendrat historike të qytetit dhe qendrat e vendbanimeve tradicionale, ku leja e zhvillimit është shqyrtuar rast pas rasti sipas kritereve morfologjike. Nënkategoritë A1, M1, M2.
h. Zonat ekzistuese urbanistike të qyteteve (të periudhës së pasluftës), ku është zbatuar më parë një plan rregullator dhe ku ekziston një rrjet rrugësh dhe vija ndërtimi. Nënkategoritë A2, A3, A4.
i. Qendrat ekzistuese të vendbanimeve rurale (të periudhës së pasluftës), duke përfshirë zgjerimet e vogla deri në 25% e që nuk ndodhen në zonën bregdetare, duke iu referuar kryesisht vendbanimeve primare të popullsisë lokale. Nënkategoritë A3, A4.
j. Zona për përdorim publik, për përdorime të veçanta dhe infrastrukturë. Kategoritë SH, AS, IS, ZU, IN, V.

Të gjitha njësitë strukturore që janë subjekt i PDV-së në bashkinë e Vlorës dhe i përkasin zonave me rëndësi kombëtare, si dhe ndodhen brenda Vijës Blu, do të hartohen me **"PDZRK".**

Njesitë strukturore, që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së janë të renditura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 7 Njësitë strukturore, që do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së

Njësia administrative	Vendbanimi	Kodi i zonës	Kodi i njësisë	Sip. (ha)
KSAMIL	MONASTIRIT	KS.UB.1	KS.UB.1.162	13,10
			KS.UB.1.244	3,00
			KS.UB.1.246	3,97
	KSAMIL	KS.UB.2	KS.UB.2.498	6,38
		KS.UB.4	KS.UB.4.3	12,49
			KS.UB.4.356	12,17
		KS.UB.5	KS.UB.5.140	11,07

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

			KS.UB.5.382	4,34
			KS.UB.5.403	0,07
			KS.UB.5.405	9,65
			KS.UB.5.407	12,72
	BREDENESHIT	KS.UB.7	KS.UB.7.314	0,93
			KS.UB.7.315	20,15
			KS.UB.7.316	17,42
			KS.UB.7.456	6,10
			KS.UB.7.462	7,50
			KS.UB.7.463	0,49
SARANDE	METOQI	SA.UB.10	SA.UB.10.206	18,98
		SA.UB.11	SA.UB.11.30	9,58
			SA.UB.11.120	8,83
			SA.UB.11.203	9,96
			SA.UB.11.348	6,15
			SA.UB.11.349	5,77
			SA.UB.11.350	4,77
	SHELEGARI	SA.UB.12	SA.UB.12.26	0,61
			SA.UB.12.27	7,18
			SA.UB.12.343	3,03
			SA.UB.12.344	1,48
			SA.UB.12.345	1,40
			SA.UB.12.346	4,88
			SA.UB.12.347	11,23
	CUKA	SA.UB.13	SA.UB.13.24	6,09
			SA.UB.13.197	19,13
			SA.UB.13.205	12,34
			SA.UB.13.313	23,93
	SARANDA	SA.UB	SA.UB.171	18,30
		SA.UB.1	SA.UB.1.119	0,28
		SA.UB.3	SA.UB.3.37	4,30
			SA.UB.3.216	7,87
			SA.UB.3.231	1,91
			SA.UB.3.275	8,17
			SA.UB.3.351	4,12
			SA.UB.3.478	0,52
		SA.UB.4	SA.UB.4.40	4,62
			SA.UB.4.42	2,33
			SA.UB.4.44	1,59
			SA.UB.4.214	10,25
			SA.UB.4.232	0,45
			SA.UB.4.277	3,69
		SA.UB.5	SA.UB.5.115	10,41
			SA.UB.5.116	10,08
			SA.UB.5.278	10,15
			SA.UB.5.280	5,89
			SA.UB.5.281	3,41
		SA.UB.6	SA.UB.6.208	16,64

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

			SA.UB.6.209	3,68
			SA.UB.6.211	19,13
		SA.UB.7	SA.UB.7.218	0,15
			SA.UB.7.220	6,14
			SA.UB.7.223	28,41
			SA.UB.7.304	3,38
		SA.UB.8	SA.UB.8.136	0,36
			SA.UB.8.204	18,73
			SA.UB.8.273	3,62
			SA.UB.8.274	14,70
			SA.UB.8.303	2,37
			SA.UB.8.310	7,71
			SA.UB.8.311	5,36
			SA.UB.8.312	13,63
	GJASHTE	SA.UB.9	SA.UB.9.56	0,22
			SA.UB.9.207	12,62

Njësitë strukturore qe do t'i nënshtrohen hartimit të PDZRK-së janë të renditura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8 Njësitë strukturore që do t'i nënshtrohen hartimit të PDZRK-së

Njësia administrative	Vendbanimi	Kodi i zonës	Kodi i njësisë	Sip. (ha)
KSAMIL	MONASTIRIT	KS.N	KS.N.130	88,532
	BREDENESHIT	KS.N	KS.N.483	61,112
	BUTRINT	KS.N	KS.N.488	49,371
	BUTRINT	KS.N	KS.N.501	0,000
SARANDE	SARANDA	SA.UB.5	SA.UB.5.166	30,103

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA



Harta 13 - (18h) Zonat subjekt i PDV/PDZRK

1.9 Shpërndarja e popullsisë dhe parashikimet demografike

Bazuar në Rregulloren e Planifikimit të Territorit, Neni 81 pika 2, përcakton se "Standardet e Planifikimit ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territore urbane dhe kategorizohen, sipas rastit, për grupe popullsie: a) deri në 10,000 banorë, b) mbi 10,000 banorë". Në këtë kontekst, numri i banorëve, verifikimi i tyre, inventari sa më i saktë i numrit të popullsisë ose atyre personave që parashihet t'u shërbejë, është kusht paraprak për çdo investim projekti dhe procesi vendimmarrjeje. Duke vlerësuar pasaktësitë për përcaktimin e numrit të saktë të popullatës në diferencat që ekzistojnë midis dy burimeve të ndryshme për popullsinë, sugjerohet që për efekt

të planifikimit të përdoret burimi i Gjendjes Civile, ndërsa për projektim të përdoren burime alternative informacioni me shkallë më të ulët gabimi. Popullësia sipas Gjendjes Civile aktualisht në Sarandë është 50 680 banorë.

Projeksionet e popullisë në bashkinë Sarandë deri në vitin 2031, janë bazuar në metodologjinë e përdorur nga INSTAT-i që ka kryer llogaritjet dhe parashikimet e popullsisë për gjithë Shqipërinë dhe në veçanti për qarqet e saj. Në këtë rast projeksionet për Qarkun e Vlorës të parashikuara nga INSTAT janë përdorur për të kryer projeksionet e popullsisë për bashkinë Sarandë dhe njësitë adminsitrative përbërëse të kësaj Bashkie.

Tabela 9 Projeksionet e popullsisë 2011-2031, bashkia Sarandë

Njësia administrative	2011	2016	2021	2026	2031
Sarandë	17233	17905	18077	17940	17750
Ksamil	2994	3111	3141	3117	3083
Bashkia Sarandë	20227	21016	21218	21056	20834
Në përqindje	100	103.9	104.9	104.1	103.0

Burimi: INSTAT 2011, vlerësimet e konsulentit



Figura 6 Grafiku i Projeksioneve të popullsisë për bashkinë Sarandë

Burimi: Punuar nga Ekspertët

Siç shihet nga tabela dhe figura e mësipërme në bazë të projeksioneve të INSTAT-it, popullsia rezidente e bashkisë Sarandë për vitin 2031 parashikohet të shkojë në 20834 me një rritje prej vetem 3% në krahasim me vitin bazë të marrë në këto projeksione 2011. Nivelin më të lartë të popullsisë bashkia Sarandë parashikohet ta arrijë në vitin 2021 me 21218 banorë, me një rritje prej 4.9% banorë më shumë se në vitin 2011.

Me të njëjtat proporcione janë llogaritur edhe ndryshimet e popullsisë brenda njësive administrative të bashkisë Sarandë. Kështu, qyteti i Sarandës parashikohet të rritet në vitin 2031 me 17740 banorë nga 17233 që ishte në vitin 2011.

Rritja e popullsisë është një nga treguesit themelorë të progresit të çdo shoqërie. Kjo pasi një rritje e qëndrueshme e saj jo vetëm flet për një popullsi të shëndetshme nga pikëpamja e moshës mesatare të saj dhe evitimit të tendencës së "plakjes" së popullsisë, por gjithashtu një rritje me baza të qëndrueshme krijojë premisa për përthithjen në tregun e punës të një numri më të madh të forcës punëtore në mënyrë që të garantohet një rritje e qëndrueshme ekonomike.

Projeksionet e popullisë në bashkinë Sarandë deri në vitin 2031, janë bazuar në metodologjinë e përdorur nga INSTAT-i që ka kryer llogaritjet dhe parashikimet e popullsisë për gjithë Shqipërinë dhe në veçanti për qarqet e saj. Në këtë rast projeksionet për Qarkun e Vlorës të parashikuara nga INSTAT janë përdorur për të kryer projeksionet e popullsisë për bashkinë Sarandë dhe njësitë adminsitrative përbërëse të kësaj Bashkie.

Tabela 10 Projeksionet e popullsisë 2011-2031, bashkia Sarandë

Njesia administrative	2011	2016	2021	2026	2031
Sarandë	17233	17905	18077	17940	17750
Ksamil	2994	3111	3141	3117	3083
Bashkia Sarandë	20227	21016	21218	21056	20834
Në përqindje	40454	42032	104.9	104.1	103.0

Burimi: INSTAT 2011, vlerësimet e konsulentit

Dendësia e popullsisë në bashkinë e Sarandës, sipas regjistrimit të fundit të INSTAT-it dhe parashikimeve zyrtare është mesatare. Në një territor të përgjithshëm prej 7.915.76 ha, popullsia e parashikuar në 2031 do të jetë 21056 persona, e cila korrespondon me 2.66 banorë për hektar. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqendruar në qytet dhe ne zonën periurbane të qytetit të Sarandës. Shpërndarja territoriale e popullsisë në bashkinë e Sarandës ndikohet nga dy faktorë bazë:

a) Efekti i kombinuar i emigrimit të jashtëm dhe migrimit të brendshëm, sipas tendencave të viteve pas 1990, ka ndikuar ndjeshëm në përzierjen e popullsisë në qytet, shoqëruar me zvogëlimin e përgjithshëm të numrit të banorëve të vjetër, që kanë lëvizur në Tiranë apo Greqi, duke mbajtur shtëpitë e tyre të vjetra, si shtëpi të dyta ose duke i rizhvilluar si apartamente me qira. Ndërkohë, ata janë zëvendësuar nga migrues të brendshëm nga zonat rurale dhe malore të Shqipërisë, që kanë populluar zonat periurbane dhe disa pjesë të bregdetit (Ksamil, Manastir) përmes zhvillimit informal. Një fenomen tjetër është vërejtur rënia në mënyrë të ndjeshme e numrit të lindjeve. Efektet e kombinuara të lindshmërisë së ulët dhe largimeve në shkallë të gjerë, kryesisht të të rinjve, përshpejtuan ritmin e moshimit të popullsisë dhe kjo vihet re në pothuajse të gjitha bashkitë.

b) Karakteri turistik i zonës është i lidhur me luhatjet e larta sezonale të popullsisë të lidhura me ekonominë e turizmit. Është vlerësuar se, popullsia aktuale në periudhën e verës rritet tre deri në katërfish. Ky fenomen është pasqyruar përmes dendësimit të konsiderueshem të

zonës kryesore urbane të Sarandës dhe zgjerimit përgjatë bregdetit, që korrespondon me zhvillimin e shtëpive të dyta dhe të shërbimeve turistike (hotele, bare, restorante) dhe jo popullsi të përhershme.

Në mënyrë që të përshtatet me luhatjet sezonale të popullsisë, plani ka marrë në konsideratë grafikun e popullsisë së turizmit. Kjo e fundit përfshin të gjitha llojet e banorëve të përhershëm dhe sezonal të zonës në periudhën e verës, përkatësisht popullsia rezidente sipas INSTAT-it, qytetarët e kthyer, pronarët e shtëpi të dyta, turistët, vizitorët e përditshëm dhe punëtorët sezonalë (shih raportin e vizionit dhe strategjisë territoriale, seksioni 4.5.9). Popullsia e turizmit në Sarandë në bazë të dhënave zyrtare arrin në 57149 persona.

Tabela 11 Të dhënat për përllogaritjen e popullsisë së turizmit

Indikatorët	Njësi Administrative	
	Sarandë	Ksamil
Popullsia Rezidente	17233	2994
Popullsi e rikthyer në periudhën e verës	16813	3829
Pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore	3500	150
Turistët (per day)	6300	2000
Visitorë Ditorë	2000	1000
Të punësuarit sezonalë	1185	145
Total sub-njësive vendore	47031	10118
Totali	57149	

Burimi: Punuar nga ekspertët sipas të dhënave nga INSTAT-i, 2016

Objektivat kryesore të propozimeve të zonimit të PPV-ve në lidhje me shpërndarjen territoriale të popullsisë së turizmit në bashkinë e Sarandës ka qenë:

- Ruajtja e nivelit të dendësisë ekzistuese në qytetin e Sarandës, duke promovuar ripërdorimin dhe rikualifikimin e zonave ekzistuese dhe parandalimin e zgjerimit të mëtejshëm urban në pjesën kodrinore (zona A1, A2, A3, A4)
- Integrimi i zonave informale ekzistuese dhe i zonave të fshatrave në pjesën periurbane të Sarandës (zona A4)
- Konsolidimi i zonës ekzistuese urbane të Ksamilit në nivelet e dendësisë ekzistuese dhe planifikimi për një zgjerim të kufizuar urban në drejtim të jugut për shtëpi të dyta (zona A5)
- Ruajtja e pjesës urbane të bregdetit të Sarandës dhe Ksamilit vetëm për zhvillimin e turizmit (zona S2, S3, S4).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Krijimin e kushteve për investime të reja turistike të cilësisë në zonën bregdetare të Sarandës-Ksamilit dhe rritjen e numrit të turistëve dhe vizitorëve të përditshëm duke kaluar nga turizmi informal në atë formal (zona S2, S3, S5).

Shpërndarja e zonave të zhvillimit është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11a Shpërndarja e zonave të zhvillimit

	Zona Rezidenciale	Shtëpi të dyta	Zona turistike		
	A1/A2/A3/A4	A5	S2	S3	S5
Sarandë	415.02	93.83	33.70	0	0
Ksamil	178.25	0.76	49.39	61.45	0
Total	593.27	94.59	83.09	61.45	

Burimi\ GIS Database

Siç shihet në tabelë, shpërndarja e zonave të popullsisë së përhershme i referohet dy poleve urbane të Sarandës dhe Ksamilit. Saranda përfshin 64% të totalit të zonave të banimit, kryesisht ekzistuese, ku është përqëndruar 85% e popullsisë së përgjithshme të përhershme. Rreth 50% e kësaj toke ka dendësi të ulët në mesatare (16-24 persona / 1000 m2), që korrespondon me banesat informale (Lagjja Varreza, Bredenesh, kodrat e Sarandës), strehimin rural (Gjashtë, Metoq, Çukë) të përziera me zona vilash/apartamente të përdorura si shtëpi të dyta, duke e kthyer popullatën me intensitet 0,6-1,2. Zonat e mbetura të banimit kanë përdorime të ndryshme, duke përfshirë ato tregtare, turistike dhe funksione institucionale të qendrës së qytetit me dendësi mesatare më të lartë (32-65 persona /1000 m2), që i korrespondon intensitetit 1,2-2,2. Pjesë e stokut të ndërtesave të banimit, kryesisht lagjja e Kodra, Limani dhe zona bregdetare nga hotel Butrinti deri në plazhin Mango përdoren për shtëpi të dyta nga pronarët ose jepen me qira në sezonin e verës në mënyrë formale apo informale.

Dendësia e popullsise rezidente në Ksamil është dukshëm më e ulët dhe varion nga dendësi e ulët në zonat e banuara në brendësi (10-16 persona /1000 m2) me intensitet deri në 0.8 në dendësi mesatare në zonat me përdorim të përzier pranë bregdetit me funksione banim dhe turizëm (16-24 persona/1000 m2), që korrespondon me intensitet 0,8-1,2. Në Ksamil, një pjesë e stokut të ndërtesave për banim përdoren si apartamente apo dhoma me qira.

Ekskluzivisht zonat e shtëpive të dyta në Sarandë, janë përcaktuar si zona me vila me dendësi të ulët (8-12 persona për 1000m2) të vendosura përgjatë buzës së kodrave me intensitet 0.4 dhe në zonat e mbushjes urbane në Ksamil me intensitet 0.6. Zonat e propozuara për hotele janë të përqendruara në bregdetin e Sarandës, ndërsa zonat e propozuara për resorte janë të vendosura përgjatë bregdetit të Bredeneshit, Manastirit dhe Ksamilit. Dendësia e parashikuar e popullsisë në zonat e hoteleve është mesatare (16-24 persona /1000m2), që i korrespondon intensitetit 0.8-1.4 dhe dendësi e ulët në zonat e resorteve (3-6 persona në 1000 m2), që korrespondon me intensitet 0.25-0.4.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Shpërndarja territoriale e popullsisë e parashikuar nga zonimi i PPV-ve është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 11b Shpërndarja e populsise territoriale

	Rezident të përhershëm, qytetare të kthyer dhe shtëpi bosh	Popullsia në shtëpitë e dyta	Numri i turistëve, përdoruesve		
	A1/A2/A3/A4	A5	S2	S3	S5
Sarandë	66.108	9499	1241	0	0
Ksamil	23.447	69	4703	2120	0
Total	89.555	9.568	5.944	2120	0

Burimi\...GIS Database.

Me këto propozime konsulenti është përpjekur të krijojë kushte për një zhvillim të qëndrueshëm në bashkinë e Sarandës në dekadat e ardhshme. Rritja e popullsisë është një nga treguesit themelorë të progresit të çdo shoqërie. Kjo sepse një rritje e qëndrueshme e saj jo vetëm flet për një popullsi të shëndetshme nga pikëpamja e moshës mesatare të saj dhe evitimit të tendencës së "plakjes" së popullsisë, por gjithashtu një rritje me baza të qëndrueshme do të krijojë premisa për përthithjen në tregun e punës të një numri më të madh të forcës punëtore në mënyrë që të garantohet një rritje e qëndrueshme ekonomike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Harta 14 – (18j) Shpërndarja e popullsisë dhe plani i strehimit

1.10 Plani i Strehimit

Sipas të dhënave zyrtare për popullsinë rezidente për vitin 2011, në Sarandë figurojnë rreth 5952 familje rezidente. Duke iu referuar kësaj shifre do të vlerësojme situatën aktuale të strehimit në Bashki si dhe shpërndarjen e ndërtimeve sipas njësive administrative. Në total në të gjithë bashkinë Sarandë në vitin 2011 janë numëruar gjithsej 12355 banesa. Shpërndarja e tyre pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Bashkia Sarandë	Tabela 12. Statusi i banimit të banesës			
	Gjithsej Total	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
Ksamil	1312	796	48	468
Sarandë	11043	5072	1788	4183
Total	**12355**	**5868**	**1836**	**4651**

Burimi: INSTAT, Census 2011

Aktualisht në territorin e bashkisë Sarandë përveç shtëpive sezonale të evidentuara më lart, janë mbi 2000 apatamente stok, të cilat në të ardhmen nëpërmjet skemave të ndryshme mund të vihen në efiçencë dhe një pjesë e tyre me instrumentat përkatës mund të përdoren nga Bashkia për të përmbushur nevojat për strehim social.
Procesi më i rëndësishëm në një Bashki, është përcaktimi i trojeve publike dhe regjistrimi i tyre në pronësi të institucioneve publike përkatëse. Kjo do të mundësojë këto institucione publike për të aplikuar për kreditë e ndryshme ose projekte që financojnë strehimin social sipas politikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqënies Sociale. Pronësia e truallit është kusht i domosdoshëm për çdo vendimmarrje në lidhje me strehimin social. Forma të tjera të zhvillimit për strehimin social në të ardhmen, mund të përdorin instrumenta financiarë si: marrje me qera nga Bashkia e godinave nga stoku i banesave.
Një alternativë tjetër për bashkinë Sarandë është zhvillimi me kusht i zonave të reja të zhvillimit, ku një pjesë të destinohet/ përcaktohet për banesa sociale në kuadrin e ndërtimeve të reja. Po kështu bashkia Sarandë, pranë zonës së Lekursit, ka dy godina banimi të përfunduara me destinacion shtëpi sociale, por në të njëjtën kohë planifikohet për të ardhmen një zonë rezervë (e përbërë nga dy parcela) për ndërtime sociale. Kjo zonë ndodhet mbi portin e peshkimit.

Janë dy struktura ekzistuese të vendosura në një zonë të re A6 me sipërfaqe 3500 m2 dhe intensitet 2.0 = 7000 m2 dhe një standard prej 15-17 m2 për person, ku mund të banojnë të paktën **450 persona.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 7 Pozicioni i propozuar për strehim social

1.11 Përcaktimi i zonave/njësive, ku do të zbatohen instrumentat për drejtimin e zhvillimit sipas ligjit

Për zhvillimin dhe zbatimin e PPV-ve janë përcaktuar një seri instrumentash nga Ligji nr. 107/2014 dhe nga Manuali i Instrumenteve Financiare për zhvillimin e tokës (USAD-it 2016). Qeverisja vendore për zbatimin e PPV-ve mund të shfrytëzojë këto instrumenta. Në këtë paragraf do të përshkruhen shkurtimisht instrumentat kryesorë për zhvillimin e tokës, ndërsa ato financiare janë përshkruar me parë.

Ky instrument është një nga më të ndershmit për t'u zbatuar. Edhe pse mund të mos jetë gjithmonë më transparenti. IKN-ja i lejon një zhvilluesi të ndërtojë me një intensitet më të lartë (i kufizuar për zhvillimin e banesave) në zona të caktuara të Bashkisë me kushtin e përmirësimeve publike. Ose ndryshe t'u sigurojë para (që të rrisë intenstitetin e ndërtimit) një tjetër strukturë (publike), që do t'i bëjë këto investime për të përmirësuar cilësinë e mjedisit për komunitetin. Një kërkesë për një instrument të tillë janë rregulloret transparente dhe të qarta, në mënyrë që të jetë e qartë për zhvilluesin dhe komunitetin se, cilat janë përfitimet e të dyja palëve dhe cilat janë pritshmëritë reale. Gjithashtu Bashkia duhet të hartojë, edhe për zonat që nuk janë subjekt i PDV-ve, Planet e Zhvillimit të Infrastrukturave Publike, të cilat do të parashikojnë shtrirjen e rrjetit rrugor dhe infrastrukturat e tjera mbi dhe nëntokësore. Në çdo rast këto instrumenta edhe kur janë iniciativa private do të kontrollohen dhe mbikqyren nga autoriteti vendor gjatë procesit të hartimit, në mënyrë që të garantohet zbatimi i PPV-ve dhe mbrojtja e interest publik në zonë. Ky instument ndërmerret për zonat e rizhvillimit dhe ato të mbushjes urbane sipas hartës përkatëse me kodin **18h,** dhe në të gjitha rastet sipas kodeve të njësive në tabelat përkatëse.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Transferimi i së Drejtës për Zhvillim

TDZH është një instrument i menaxhimit të tokës, që e transferon zhvillimin nga zonat ku një qeveri lokale do të donte të shihte më pak zhvillim, në zonat ku qeveria lokale shikon me shumë vend për zhvillim (vetëm zhvillimin e banimit) në konsistencë me PPV-në. Ky instrument mund të aplikohet vetëm mbi bazën e dakordimit vullnetar midis pronarëve të tokave. Nevojitet edhe një llogaritje e saktë e vlerës së tokës. Gjithashtu, monitorimi i ndryshimeve të vlerës së tokës është me rëndësi të madhe. Meqë vlerësimi i tokës dhe pronës në Shqipëri është i vështirë pasi tregu nuk është transparent (oferta dhe kërkesa), ky instrument do të përballet me disa vështirësi për t'u zbatuar.
Në bashkinë Sarandë është propozuar të zbatohet instrumenti i TDZH në kodrat rreth qytetit të Sarandës (zona N.6) për parcelat që kanë statusin e pronësisë "truall". Janë projektuar si "toka për t'u dhënë" dhe potencialisht do t'u transferohen të drejtat e zhvillimit me intensitet 0.05. Të drejtat e zhvillimit të këtyre tokave transferohen në zonat e tjera në afërsi të kanalit të Çukës (zonat A.4, A.5), të cilat janë projektuar nga PPV-ja si "zona marrëse" me potencial rritje që i korrespondon intensiteti 0.4.

E drejta e preferimit

E drejta e preferimit është e drejta në dobi të një autoriteti të planifikimit, në kuptim të këtij ligji, për t'u preferuar në radhë para çdo personi privat në blerjen, në të njëjtat kushte, të një pasurie të paluajtshme, në pronësi private, që është objekt shitjeje dhe ndodhet në një zonë vendimtare për realizimin ose mbrojtjen e një interesi publik. Pasuria e blerë nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së preferimit përdoret vetëm për interesin publik konkret, për të cilin është zgjedhur. Nëse autoriteti përgjegjës i planifikimit vendos ta shesë pasurinë e blerë me preferim brenda 5 viteve nga data e blerjes, ai është i detyruar të njoftojë ish-pronarin e saj ose trashëgimtarët e tij, nëse kanë interest ta riblejnë atë pasuri.
Në Sarandë propozohet të aplikohet instrumenti i të drejtës së preferimit për të gjitha zonat e hartuara në PPV me kategori të përdorimit të tokës AS (arsim), SH (shëndetësi) dhe IS (institucione). E drejta e preferimit i referohet kryesisht shërbimeve të reja publike të propozuara, të projektuara në truall me pronësi private.
Instrumenti i së drejtës së preferimit aplikohet gjithashtu në disa zona të projektuara për hapësira publike dhe zona të reja të gjelbërta (zonat AR.3 dhe AR.4) për t'i dhënë mundësi Bashkisë të marrë një pjesë të tokës, që mund të ketë pronësi private. Në Sarandë propozohet të aplikohet e drejta e preferimit në Kodrën e Marinës (zona AR.4-id) dhe në shëtitoren e Ksamilit (zona AR.3).
Ky instrument është i ilustruar në hartën përkatëse me kodin **20.**

Servituti publik

Servituti publik është barra që i ngarkohet një prone në dobi të një prone tjetër për interes publik. Ai nuk përjashton përdorimin e pasurisë së paluajtshme ose të një pjese të saj, që nuk cënon realizimin e servitutit publik.

Servituti publik mund të përcaktohet nga dokumenti vendor apo kombëtar i planifikimit ose të diktohet nga një kërkesë për ndërtim. Kur servituti bazohet në një dokument planifikimi në fuqi, ai zbatohet ndaj një kërkese ndërtimi.

Cdo servitut publik, i vendosur mbi parcela të caktuara, transferohet në parcelat e reja të krijuara në të njëjtën vendndodhje fizike, si pasojë e një procesi nënndarjeje dhe/ ose bashkimi të parcelave për qëllim zhvillimi. Servituti publik qëndron në fuqi pa afat në rast se akti që e krijon atë nuk përcakton një afat përfundimi.

Të drejtat dhe detyrimet mbi servitutin publik janë ato të përcaktuara në Kodin Civil e legjislacionin në fuqi për servitutet.

Në bashkinë e Sarandës, instrumenti i servitutit publik propozohet të aplikohet në zona turistike specifike përgjatë vijës bregdetare, ku kërkohet të sigurohet mundësi kalimi publik drejt detit. Servituti publik nuk e kufizon zhvillimin e këtyre zonave, por u kërkon pronarëve privatë të ofrojnë mundësi kalimi publik drejt detit nëpërmjet pronës së tyre. Këto zona tregohen në hartën 18c (nën-kategoritë në përdorim të tokës) si "akses publik".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA



Harta 15 – (20) Instrumentat te Zhvillimit të propozuar

2. PLANI I MBROJTES SË MJEDISIT

Vlerësimi për Planin

Vlerësim i përgjithshëm. Turizmi dhe industria e peshkimit (peshkimi, akuakultura etj.) përbëjnë sot bazën e aktiviteteve ekonomike në bashkinë e Sarandës. Zhvillimi jo i qëndrueshëm i këtyre 25 viteve të fundit ka sjellë një situatë jo normale në këtë Bashki. Plani i Përgjithshëm Vendor synon të normalizojë këtë situatë, duke e krijuar dhe duke e shndërruar zonën në një atraksion turistik i cili konkuron globalisht.
Nivelet e monitorimit deri më sot në këtë Bashki kanë qenë të pakënaqshme, gjë e cila lidhet me shumë faktorë. Duke qenë se sot tendenca e turizmit ecën në drejtim të rritjes së kërkesave lind nevoja për një monitorim të vazhdueshëm. Mungesa e kapaciteteve monitoruese si teknologjike ashtu edhe njerëzore e vështirëson monitorimin, për këtë arësye ekspertët kanë përpunuar një sistem monitorues të thjeshtë i cili reflekton një nivel mesatar zhvillimi dhe kërkesash për aftësi të stafit, për një bashki evropiane të një niveli të mesatar. Sistemi përputhet me të gjitha kërkesat kombëtare dhe parashikon edhe kërkesa të reja për t`u integruar në të ardhmen të cilat mund të lindin si rrezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare që do të mund të nënshkruhen nga qeveria shqiptare.
Në varësi nga niveli i ekspertizës së administrimit të Bashkisë, të sistemit ekzistues të monitorimit kombëtar, në varësi dhe të kompleksitetit të zhvillimit dhe të disa parametrave të tjerë mjedisor, sistemi i monitorimit të VSM-së luhatet nga mjaft i thjeshtë në mjaft i ndërlikuar, të dyja këto duke u bazuar si në të dhënat e grumbulluara deri më tani e deri tek mjetet e monitorimit dhe metodologjia.
Sistemi i përdorur për monitorimin e VSM-së është bazuar kryesisht në ato pak të dhëna që janë gjetur dhe grumbulluar nga administrata aktuale për fusha të ndryshme, nga të dhëna në nivel kombëtar si dhe në kërkimet e bëra për realizimin e Planit të Përgjithshëm Vendor si dhe mbi bazën e potencialit të eksperteve. Ekspertët u munduan të optimizojnë midis kërkesës dhe realitetit për realizimin e matjeve të mundshme për realizimin e monitorimeve.
Disa nga gjetjet më kryesore si kombinime të masave mjedisore që duhen marrë gjatë zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor do të grupohen në nënçështjet më të rëndësishme si më poshtë:

Zonat e mbrotjura dhe biodiversiteti. Bashkia Sarandë është një territor me larmi terrenesh (karakterizohet nga fusha, kodra dhe male të larta) dhe habitatesh (kullota, fusha, pyje etj) e si rrjedhojë ajo ka një shumëllojshmëri biodiversiteti. Gjithashtu ajo përfshin edhe trajtimin e zonave të mbrojtura me VKM dhe që zhvillohen sipas një plan menaxhimi të miratuar. Zona në studim ka rreth 282 ha me pyje dhe rreth 530 ha kullota. Plani i Përgjithshëm Vendor merr në konsideratë trupat ujore si liqeni i Butrinit, ku respekton planin e menaxhimit ekzistues, lagunën e Alinurit, lumin e Bistricës si të rëndësishme jo vetëm si rezerva ujore por edhe si zonë Ramsar, ku gjejnë mundësi strehimi një numër i madh shpendësh dhe llojesh ujore por edhe për ujitje. Kjo përbën një element të rëndësishëm të objektivave të VSM. Plani respekton objektivat kombëtare (B1, B3) dhe ato ndërkombëtare. Gjithashtu në Plan shqyrtohen mënyrat e zhvillimit të qëndrueshëm duke respektuar habitatet.

Menaxhimi i Burimeve Ujore- Burimet ujore në Bashkinë Sarandë janë të shumta ku mbrojtja e tyre dhe shtrirja e rrjetit të shpërndarjes përbëjnë një nga objektivat kryesore të VSM-së. Në Planin e paraqitur është trajtuar gjerësisht problematika pasi *së pari*, vihen në dukje investimet e fundit në infrastrukturën e rrjetit të ujit të pijshëmn si dhe sugjerimet përkatëse për sigurimin e ujit të pijshëm sidomos në zonat rurale si Gjashtë, Metoq. Aty ka nevojë të përmirësohet sistemi i furnizimit me ujë, pasi aktualisht furnizimi me ujë bëhet me pus ndërsa në fshatrat e tjerë realizohet nga ujësjellësi i Çukës. Sidoqoftë plani vë në dukje nevojën për investime për të mundësuar pompimin e ujit të pijshëm në të gjithë zonën dhe në sasinë e nevojshme si për periudhën që i takon sezonit turistik ashtu edhe për furnizimin e ujit për banorët duke përmirësuar kështu cilësinë e shërbimeve dhe të jetës së tyre. Krijimi i zonave buferike përreth burimeve ujorë të Vrionit dhe atyre të Navaricës, që ndodhen përkatësisht rreth 3.5 km dhe 13 km larg Sarandës janë të domosdoshme dhe përbëjnë një kapacitet total prej rreth 225 l/ të rezervuarëve si dhe menaxhimi i tyre do të siguronte pastërtinë e tyre. Ujrat nëntokësore nxirren dhe pompohen në zonën e shpërndarjes, gjë që rrit koston për shkak të përdorimit të energjisë elektrike.

Mbrojtja e Tokës. Mbrojtja e tokës përbën një nga objektivat kryesore të VSM-së të bashkisë Sarandë. Plani thekson krijimin e hapësirave të gjelbra si dhe krijimin e një korridori ekologjik përgjatë bregut duke krijur akses për të gjithë në bregdet sidomos në zonën e bregdetit të qytetit të Sarandës. Pjesën e tokës në zonën rurale me karakter bujqësor plani shtron nevojën për mbulim me ujë për ujitje gjë e cila do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e agroturizmit, si një mundësi për përmirësimin e jetës në zonë. Plani parashikon investime për riaftësimin e tokave në rrezik përmbytje në zonën fushore përmes rigjenerimit të sistemit të drenazhimit apo atij kullues ekzistues, përmirësimin e bonitetit të tokave, ruajtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet e shpërndara të karakterit industrial apo familjar etj, duke reflektuar kështu plotësimin e objektivave kombëtare (MT1, PT4, BJ-5) dhe ndërkombëtare. INT-3, ME-8, INT-1, ME-1, ME-4). Gjithashtu planifikimi i ndërtimeve brenda zonave ekzistuese të fshatrave do të ndikojë në përmirësimin e peisazhit rural, në mbrojtjen e tokës bujqësore nga mbulimi i saj nga ndërtimet e shpërndara.

Cilësia e Ajrit. Në bashkinë Sarandë monitorimi i ajrit është realizuar nga institucionet përkatëse por afërsia me detin, zonat me pyje dhe prania e ulët e investimeve bëjnë që ajo të karakterizohet nga një cilësi ajri e pastër. Qyteti i Sarandës në zonën e postës së qytetit, pranë shëtitorës ka vlera më të larta të NO_2 krahasuar me qytete të tjera me popullsi më të madhe por dhe me numër automjetesh më të lartë, por sidoqoftë ato mbeten brenda normave të BE-së. Po ashtu cilësia e dobët e rrugëve dhe trafiku i lartë në periudhën e sezonit veror lëvizja e automjeteve krijon ngritjen e grimcave të pluhurit si dhe çlirim të gazeve të djegies së naftës dhe benzinës të një cilësie jo të mirë. Plani parashikon investime në infrastrukutën përkatëse që do të sjellin minimizimin e këtyre presioneve. Objektivat e VSM-së i përfshijnë në mënyrë indirekte çështjet e mësipërme duke plotësuar edhe objektivat përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndotja akustike- Monitorimet e kryera në mënyrë sporadike nga Ministria e Mjedisit në Sarandë regjistronjë një vlerë mesatare prej 63.9 dB në një kohë që norma e BE-së është 55 dB.

Burimet kryesore të zhurmave janë trafiku urban dhe rrugor, tregëtia (zhurmat profesionale dhe mjedisore), ndërtimi dhe zhurma në godinat e shërbimit, fqinjët pranë shtëpisë, aktivitete argëtuese, koncertet e hapura, diskoteka, lokale dite apo nate. Faktor tjetër me një peshë shumë të konsiderueshme është shpejtësia e ulët e lëvizjes së mjeteve, mungesa e theksuar e vendparkimeve të përkohshme apo të përhershme, gjëndja motorike e automjeteve në qarkullim, mosha e vjetër e tyre që sjell uljen e parametrave optimale të certifikatës teknike të automjetit, etj. Përfshirja e zhurmave, si një element i rëndësishme në vlerësimin e indikatorëve të shëndetit mjedisor si dhe hartimi i paketave të informimit dhe edukimit mbi efektet negative që shkaktojnë zhurmat në popullatë do të përmirësonte kushtet dhe cilësinë e jetës së popullatës.

Menaxhimi i Mbetjeve dhe kanalizimet e ujrave të ndotura. Menaxhimi i mbetjeve është një ndër presionet mjedisore të Bashkisë i cili gjen zgjidhje në Plan, në mënyrë të veçantë problemi i vend-hedhjes së tyre dhe ai i përpunimit. Mbetjet përpunohen në landfillin e Bajkaj. Sasia vjetore e mbetjeve të ngurta për bashkinë Sarandë është 10.000 t. Problematike mbetet situata me dy vend-grumbullimet përkatësisht në Vollodesh dhe Limjon, kjo e fundit depoziton mbetjet e inerteve në breg të detit duke shkaktuar ndotje dhe mbushje në zonën pranë Teqesë. Pjesa e Vollodeshit sot përdoret për hedhjen e inerteve. Gjithashtu VSM-ja do të kërkojë edhe planin e menaxhimit të plotë të mbetjeve dhe listën e projekteve prioritare lehtësuese si për reduktimin dhe eliminimin e aktiviteteve ekzistuese te pakontrolluara të depozitimit të tyre, ashtu dhe për zhvillimin e qëndrueshëm te sistemit të mbetjeve për të ardhmen e Bashkisë.

Zhvillimit i qëndrueshëm i turizmit, zhvillimi i infrastrukturës, restaurimi i monumenteve dhe trashëgimisë arkitekturore. Zhvillimi i turizmit në bashkinë e Sarandës ka pësuar lëkundje të ndryshme gjatë 5 viteve të fundit. Në vitin 2015 ka një rënie me 10000 turistë vendas dhe një shtim me po të njëjtën numër me turistë të huaj. Mungesa e një infrastrukture moderne dhe e një strategjie ku të përfshihet turizmi kulturor, agroturizmi, etj ka bërë që në këto vite numri i turistëve të mos ketë rritje të ndjeshme. VSM përmes objektivave të saj të lidhura me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm synon të orientojë Planin në drejtimin e duhur. Mundësia e ndërtimit të një aeroporti në afërsi të Sarandës do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e turizmit dhe në krijimin e vendeve të punës, por sidoqoftë do të kërkohet një Vlerësim Mjedisor i thelluar i cili të analizojë në hollësi të gjitha pasojat dhe të mirat të lidhura me të.

Sistemi i monitorimit. Qëllimet dhe objektivat e VSM si dhe masat zbutëse lidhur me mjedisin janë paraqitur edhe në raportin përkatës. Më qëllim që VSM-ja të ketë një përdorim praktik për administratën e Bashkisë dhe për shtresat e interesuara, do të ishte e nevojshme vendosja e një numri indikatorësh dhe një sistemi monitorimi që do ta bënin atë sa më të thjeshtë dhe praktik, duke përdorur si burimet ekzistuese ashtu dhe aktivitetet shtesë.

Sistemi i monitorimit do t'u mundësojë grupeve të interesit:

a. Monitorimin e progresit drejt objektivave të VSM-së
b. Monitorimin e efekteve mjedisore që vijnë nga zbatimi i PPV-ve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

c. Identifikimin e efekteve negative të paparashikuara mbi mjedisin apo të paralajmërohen në stade të hershme
d. Mundësimin për veprime korrigjuese të përshtatshme

Sistemi i indikatorëve të monitorimit, i qëllimeve dhe metodave të matjes do të paraqiten në tabelat e mëposhtme.
Një proces rishikimi dhe monitorimi është përgatitur për t'u përfshirë në një raport vjetor, që do të hartohet nga sektori i mjedisit në administratën e Bashkisë (me ndihmën e eksperteve kur është e nevojshme) dhe që do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak.
Ekspertët kanë propozuar që informacioni i mjedisit të përditësohet çdo 6 muaj me qëllim për të siguruar një paralajmërim të në kohë të përshtatshme në rastet e një dëmtimi serioz mjedisor, pavarësisht që raporti i monitorimit të VSM është vjetor.
Sistemi i monitorimit do t'u mundësojë grupeve të interesit të Bashkisë të vlerësojnë nga pikëpamja mjedisore, strategji dhe programe të tjera që mund të zbatohen në të ardhmen, duke ndjekur iniciativat e Këshillit Bashkiak dhe mundësi apo programe të BE-së. Procesi i monitorimit të VSM-së duhet të ecë që sot e tutje paralelisht me zbatimin e PPV-ve duke u bërë pjesë integrale e tij.
Të gjithë qëllimet dhe të dhënat janë të bazuara në objektivat e PPV-ve dhe standartet kombëtare. Në rrugën e zbatimit mundet që Shqipëria të harmonizojë edhe më tej standardet e saj me ato të BE-së apo nga marrëveshje ndërkombëtare të reja (p.sh. për cilësinë e ajrit, objektivat për klimën dhe efektin serrë etj), duke bërë kështu të mundur që sistemi i monitorimit të përmirësohet me këto objektiva të reja (si dhe arritje të tjera të rëndësishme).
Poshtë janë siguruar disa të dhëna bazë ekzistuese lidhur me gjendjen aktuale si dhe disa vlera normale për parametra të ndryshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA



Harta 16 – (18g) Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

2.1 Parashikimet për mbrojtjen e pejzazhit natyror dhe kulturor

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Sarandë është zhvilluar në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së, ofron mekanizmat për mbrojtjen e zonave pejzazhistike dhe pejzazheve të veçanta që dallojnë edhe në nivel rajonal si dhe për krijimin e një pejzazhi të një cilësie të lartë. Masat për mbrojtjen e pejzazhit parashtrohen si më poshtë:

Mbrojtja, përmirësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pejzazhit urban dhe pamor (ruajtja e trashëgimisë kulturore) dhe përmirësimi i strukturës se vendbanimit

1. Mbrojtja, përmirësimi dhe rivendosja e cilësisë dhe karakterit të pejzazhit, restaurim të monumenteve dhe trashëgimisë arkitekturore, i modelit të vendbanimeve, identitetit pamor të qytetit.

- Rritja e kërkesës për restaurim e objekteve të trashëgimisë arkitekturore si pasojë e rritjes së aksesit dhe lëvizshmërisë. Rekomandohet të promovohen projekte që mundësojnë restaurimet e objekteve të trashëgimisë kulturore si nga ana e pushtetit vendor dhe shoqërisë civile. Objekti kulturor më i rëndësishëm i bashkisë Sarandës, që është njëkohësisht dhe zona arkeologjike më e njohur e Shqipërisë, mbetet Parku Kombëtar i Butrintit si një Zonë e Trashëgimisë Botërore.
- Përmirësimi i parkut të Butrintit dhe zonës përreth Kanalit të Vivarit, zbulimi i murit të lashtë dhe Manastirit të Shën Gjergjit, përmirësimi i sinjalitikës me shenja dalluese dhe aksesueshmërisë për këmbësorët, do ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e trashëgimisë arkitekturore dhe kulturore të Bashkisë. Futja e lojrave ujore, e korsisë për bicikleta, zgjatja e rrugës panoramike do të evidentojë edhe më tej identitetin turistik të bashkisë Sarandë. Rekomandohet të respektohen zonat e përcaktuara nga VKM-ja si edhe planet përkatëse të menaxhimit.
- Spostimi i varrezave nga brigjet e detit dhe rehabilitimi i zonës përreth tyre do të përmirësoje ndjeshëm identitetin pamor të këtij territori. Rekomandohet rritja e kontrollit mbi territorin nga ana e Bashkisë përmes strukturave të policisë bashkiake dhe restaurimi i banesave në afërsi të zonës.
- Rikualifikimi i zonës së magazinave të vjetra që janë elemente interesante arkitektonike për t`u restauruar dhe ripërdorur do të ndihmojë në përmirësimin estetik të zonës. Ripërdorimi i depove të vjetra do të krijojë një urbanistikë të re të zonës, ndërsa ndërtimi i terminalit të ri të autobusëve do të sjellë një qendërzim të ri duke inkurajuar flukse të këmbësorëve në shëtitoren përgjatë bulevardit.
- Efekti sinergjik është dhe rikualifikimi do të shoqërohet me investime edhe në sistemin e shpërndarjes së ujit të pijshëm, kanalizimeve etj. Rekomandohet të shtohet gjelbërimi në zonën e terminalit. Rekomadohet vendosja e rregullave morfologjike, si pjesë e rregulloreve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë me qëllim që të rregullojë ndërtimin në pjesën historike të vendbanimeve dhe të monitorojë në mënyrë efektive zbatimin e tyre.
- Pastrimi nga ndërtesat e braktisura, rikualifikimi i zonës kodrinore dhe pyllëzimi do të ndikojë në mënyrë të dyfishtë mbi pejzazhin dhe identitetin pamor të qytetit. Rekomandohet përcaktimi i zonës buferike përreth parkut dhe vendosja e rregullave morfologjike dhe atyre të ndërtimit në periferi të qytetit dhe në fshatra përmes planeve të detajuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Promovohet ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së pejzazhit dhe i përmirësimit të identitetit pamor të vendbanimeve përmes projekteve. Ruajtja e cilësisë së plazhit dhe përmirësimi i identitetit pamor do të ndikojë për një periudhë afatgjatë në mënyrë sinergjike në rritjen e numrit të turistëve në zonë. Me qëllim ruajtjen e pejzazhit Bashkia duhet të përforcojë kontrollet për shmangien e dëmtimeve të pejzazhit dhe të përcaktojë një numër masash për të shtuar gjelbërimin në zonat e zhveshura.
- Përmirësimi i mjedisit urban dhe tipareve karakteristike për fshatrat e Sarandës, krijimi i lehtësirave të reja sportive, integrimi i zonës informale të Sarandës do të ndikojnë në identitetin pamor dhe do të rivendosë cilësinë e pejzazhit së bashku me përmirësimin e cilësisë së ndërtimeve dhe pastrimin nga ndërtimet e papërfunduara dhe të shpërndara. Rekomandohen të shtohen mjediset sportive publike që do i shërbejnë turistëve dhe banorëve
- Zgjerimi i vijës së ndërtimit në disa fshatra dhe në zonën e varrezave në Sarandë, me qëllim përfshirjen e ndërtimeve informale, do të ndikojë pozitivisht në pejzazhin arkitekturor të këtyre zonave por nga ana tjetër mund të shtojë ndërtimet e reja në këto zona të ngarkuara. Të rishikohet procedura e dhënies së lejeve të ndërtimit në këto zona.
- Grumbullimi i aktiviteteve tregtare në zona të përcaktuara do të përmirësojë pejzazhin e zonave turistike të Sarandës dhe Ksamilit duke përforcuar identitetin turistik të tyre.

2. Reduktimi dhe parandalimi i zhvillimit të shpërndarë dhe përmirësimi i strukturës së vendbanimit, i zhvillimit të papajtueshëm të përdorimit të tokës në zonën bregdetare me qellim densifikimi mduke perdorur masat mbrojetese te meposhte:

- Ndërtimi dhë përmirësimi i infrastukturës rrugore, i ndërlidhjes midis fshatrave të Bashkisë por edhe të bashkive fqinje do të ofrojë shërbime të lidhura me qendrat e tyre duke kushtëzuar në këtë mënyrë edhe ndërtimet e reja pranë tyre, me ndikim pozitiv në drejtim të ruajtjes së tokës bujqësore por edhe të zonës bregdetare. Rekomandohet zgjerimi i rrjetit të transportit publik në qendrat e zonave të banimit.
- Pastrimi i kodrave të Sarandës nga ndërtimet e braktisura dhe përcaktimi i vijës së ndërtimit në fshatra do të ndikojë në reduktimin e ndërtimeve të shpërndara.
- Mbrojtja e pemishteve me ullinj si dhe përcaktimi i një numri të kufizuar të ndërtimeve në bregdet do të reduktojë zhvillimin e shpërndarë në këtë zonë. Rekomandohet kufizimi i lejeve të ndërtimit përtej zonave ekzistuese të ndërtuara.
- Kufizimet në lartësi në Ksamil me jo më shumë se 2-3 kate dhe me intensitet 0.25-0.4, kufizimet në lartësi të strukturave të reja përgjatë gjithë qytetit, të cilat do të jenë jo më shumë se 3-4 kate dhe me një intensitet që nuk e tejkalon 0.8, pastrimi nga ndërtimet në zonat informale dhe ndërhyrjet në disa zona në bregdet, bllokimi i ndërtimeve për 10 vjet në Sarandë, do të ndikojnë në përmirësimin e strukturës së vendbanimit. Nga ana tjetër efektet akumuluese të ndërtimeve që do të realizohen do të shtojnë presionin mbi qytet si pasojë e kërkesës për rritje të kapaciteteve. Rekomandohen të ulet ritmet e ndërtimeve dhe të shtohen hapësirat publike përmes blerjes së tokës nga ana e Bashkisë në zonat e mbindërtuara.
- Largimi i aktiviteteve prodhuese dhe i shërbimeve që lidhen me ndërtimin, etj, largë strukturave të banimit, do të ndikojnë pozitivisht në tërësinë e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË

2.2 Parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Sarandë, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe orientimet bazë të VSM-së duhet të këtë parasysh:

Përmirësimin e cilësisë së jetësës përmes mbrojtjes së trupave dhe burimeve ujore të zonës dhe zhvillimit të infrastrukturës përkatëse.

1. Mbrojtja dhe përmirësimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, detit dhe zhvillimi i mjedisit të zonave bregdetare

- Deti përbën burimin kryesor të të ardhurave direkte dhe indirekte të bashkisë Sarandë dhe për këtë arsye ai është një element shumë i rëndësishëm për këtë Bashki. Deti duhet monitoruar për të përcaktuar zonat e ndotura dhe ato të pastra. Ndërkombëtarizimi i përbërjes së turistëve vitet e fundi e bën të detyrueshme krahasimin e parametrave të ujit me ato të standardeve europiane. Bashkia ka detyrimin ligjor dhe është përgjegjëse për marrjen e kampioneve të ujit në zonat e plazheve. Bashkia duhet të kryejë të paktën pesë (5) monitorime nëpërmjet kampionëve të ujit të marra në plazhet e identifikuara për çdo sezon plazhi, duke filluar nga një kampion për sezonin para fillimit të sezonit veror dhe katër të tjera gjatë sezonit veror. Si sezon plazhi të konsiderohet nga 1 qershori deri në 1 shtator dhe parasezon nga 15 maji deri në 31 maj.

Tabela 13 Kërkesat cilësore të ujërave të plazheve në përputhje me BE-në

Direktiva e KE për cilësinë e ujërave të plazheve (76/160/EEC)		
Parametra	**Udhëzim**	**I detyrueshëm**
Mikrobiologjike		
Totali i coliform (Numri/100ml)	≤500 [1]	≤10,000 [3]
Foecal coliform (Numri/100ml)	≤100 [1]	≤2,000 [3]
Fiziko-kimike		
Vajra minerale (mg/l)	≤0.3 [2]	Jo film dukshme në sipërfaqen e ujit dhe pa erë [3]
Substanca me sipërfaqe aktive (mg/l)	≤0.3 [2]	Jo shkumë te qëndrueshme [3]
Fenol (mg/l as C_4H_3OH)	≤0.005 [2]	Nuk ka erë specifike ≤ 0.05 [3]

Shënim1: ≥80% te mostrave - Shënim 2: ≥ 90% te mostrave - Shënim 3: ≥ 95% te mostrave

Është shumë e rëndësishme për zonën dhe Bashkinë që të mund të kryejë këtë monitorim të këtyre parametrave brenda vitit 2017. Rezultatet e monitorimit duhet edhe të shërbejnë si bazë për masat e nevojshme që duhen marrë. Rezultatet duhen të bëhen të njohura me mënyra të ndryshme për publikun, si dhe përmes faqes së internetit të Bashkisë. Bashkia në bazë të rezultateve mund të hartojë një hartë me cilësinë e ujërave dhe plazheve.

-Bashkia në bashkëpunim me institucione të tjera duhet të monitorojë dhe të ulë disa vlera të parametrave të ujit të pijshëm në përputhje me ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare si Direktiva */98/83/EC apo standarded e OBSH.* Disa parametra kimikë, mikrobiologjikë, pesticide dhe komponime organike janë plotësisht jashtë monitorimit dhe nuk kanë asnjë vlerë për to. Është shumë e rëndësishme për shëndetin publik që këto parametra të jenë nën monitorim për t'u mbajtur në nivelet e lejuara. Të gjitha zonat përreth burimeve ujore duhet të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

konsiderohen dhe të shpallen Zona Sanitare të Mbrojtura bazuar kjo edhe në Ligj (Ligj Nr. 8093, 21.3.1996, Nr. 111/2012).

Tabela 14 Treguesit fiziko-kimikë të ujit të pijshëm

Nr	Treguesit kimike	Vlerat e monitoruar a të ujit të pijshëm në bashkinë Sarandë	Standarde Kombëtare ml/ujë	Max	Objektiva nga 2018 (Direktiva e Këshillit 98/83/EC & te tjera)
1	Shija dhe era (numër hollimi)			2deg12^{0}C, 3deg25^0 C	E pranueshme nga konsumatoret dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
2	Ngjyra dhe pamja e jashtme (mg/l shkalla Pt/Co)		1	20	E pranueshme nga konsumatoret dhe nuk ka ndryshim jo të rregullt
3	pH		6,5-8,5	9,5	≥ 6.5 dhe ≤ 9.5
4	Konduktiviteti elektrik (µS/cm)		400		2500
5	Kalcium (mg/l)		75	200	200
6	Lëndët pezull (mg/l)				0
7	Turbullira (FTU)		0.4	4	Nuk ka udhëzime
8	Alkaliniteti (mg ekv/l)			n.v	Acc.pH
9	Karbonate (mg/l)				250
10	Bikarbonate (HCO^-_3) (mg/l)		H_2O not $CaCO_3$	n.v	Ac.pH
11	Amonjak (mg/l)		0	0,05	0.50
12	Nitrite (mg/l)		0	0,05	0.5
13	Nitrate (mg/l)		25	50	50
14	Fortësia Totale (^{O}german)			20	36-71
15	Fosfate (mg/l)		0,4	2,5	2.5
16	Lëndë Organike (mg/l)		1	3	3
17	Klorure (mg/l)		25	200	250
18	Sulfate (mg/l		25	250	250
19	TDS (mg/l)		500		≤1500
20	Magnez(mg/l)		20	50	0.05

Burimi: Standards - Air Quality - Environment - European Commission & ISHP

Tabela 15 Treguesit mikrobiologjikë të ujit të pijshëm të bashkisë Sarandë dhe objektiva

N°	Treguesit mikrobiologjike	Pus i përbashkët para Klorinimit	Vlerat në Bashki	Standarde kombëtare ml/ujë	Objektiva nga 2016 Direktiva e Këshillit 98/83/KE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

					ml/ujë
1	E. Coli			0/100	0/250
2	Strept			0/100	0/250
3	Pseudomonas aeruginosa			n.v	0/250
4	Numri i kolonive 22°C			n.v	100/ml
5	Numri i kolonive 37°C			n.v	20/ml

Burimi: Standards - Air Quality - Environment - European Commission & ISHP

Alternativa e Projektit për krijimin e një ure lidhëse me Korfuzin do të sillte shqetësim për biodiversitetin ujor si dhe do të ndikonte në pejzazhin e zonës bregdetare. Sidoqoftë ndikimi i përgjithshëm do të varet nga marrëveshjet e zbatimit. Për këtë është i nevojshëm realizimi i një VNM-je për ndërtimin e urës dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ndërtimi i Portit të Jahteve" në pjesën urbane të bregdetit (përballë hotel Butrintit) në qytetin e Sarandës do të ndikojë negativisht në pastërtinë e ujit të detit dhe plazhit të qytetit të Sarandës dhe mjedisit të zonës bregdetare përreth saj. Për këtë janë të nevojshme hartimet e rregulloreve për portin e jahteve. Më konkretisht, mjetet e lundrimit nuk duhet të derdhin mbetje, të përdorin tualetet e tyre, të lëvizin me shpejtësi 10 km/orë në afërsitë bregut, të përdorin rrugët ujore hyrëse të përcaktuara, furnizimet me karburant të bëhet sipas kushteve të mirëpërcaktuara, etj.

- Ndërtimi i shëtitores do ndikojë shumë në rregullimin e mjedisit të zonës bregdetare përmes përmirësimit të vijës së ballinës së bregdetit të Sarandës si dhe në pejzazhin e këtij bregdeti. Një efekt sinergjik me realizimin e kësaj shëtitoreje paralele me bregun, është disiplinimi i derdhjes së ujrave të ndotura nga bizneset përgjatë bregut duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e ujit të detit. Rekomandohet forcimi i rolit të policisë bashkiake në kontrollin e vijës bregdetare për bllokimin e aktiviteteve që shkarkojnë mbetjet në det.
- Krijimi i parkut dhe mundësia e spostimit të varrezave të qyetit të Sarandës, do të ndikojë në cilësinë e ujit të detit dhe në përmirësimin e mjedisit të zonës bregdetare në këtë pol të ri të qytetit. Rekomandohet që para hapjes së zonës bregdetare të parkut, të kryhen analizat e ujit të detit dhe të krahasohen rezultatet me ato të standardeve kombëtare dhe të BE-së.
- Pastrimi i zonave kodrinore të Sarandës nga ndërtesat e braktisura, vendosja e rregullave për ndërtimet e papërfunduara, përcaktimi i kufijve të vendbanimeve dhe vendosja e rregullave morfologjike dhe atyre të ndërtimit në periferi të qytetit dhe në fshatra përmes planeve të detajuara do të ndikojë në ruajtjen e ujërave nëntokësore. Janë të nevojshme vendosja e masave për zbatimin e rregulloreve gjatë ndërtimit në zonat e gjelbërta.
- Përmes ruajtjes së karakterit natyror të bregdetit të zonës Sarandë-Ksamil, caktimit të zonave tampon do të ndikohet pozitivisht zhvillimi i zonës bregdetare duke ruajtur karakterin e tyre. Lejimi i zhvillimeve të reja rezidenciale në zonat e përcaktuara në bazë të kritereve të mbrojtjes së pejzazhit do të ndikojë negativisht në këtë bregdet, pasi zona është mjaft e ngarkuar me ndërtime të tilla. Rekomandohet të evitohen ndërtime të tilla në zonën

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

e bregdetit duke i lënë më shumë hapësirë zonave për plazh dhe të intensifikohen ndërtimet në njollat ekzistuese të ndërtimit. Të aplikohen standarde ndërtimi si në zonat e ndjeshme natyrore dhe të shoqërohen me gjelbërim me lartësinë e ndërtimit.

- Pastrimi i plazheve dhe kontrolli i cilësisë së ujit do të ndikojë pozitivisht në mbajtjen e cilësisë së ujit nën kontroll duke e klasifikuar atë sipas kategorizimeve ndërkombëtare. Alternativat e furnizimit me ujë nga "Tatzati"ose "Syrit të kaltërt` si dhe zëvendësimi i tubacionit Vrion-Rezervuar i qytetit do të ndikojë pozitivisht në furnizmin me ujë dhë në cilësinë e ujit të pijshëm. Rekomandohet të afishohet nga Bashkia lista e plazheve shoqëruar me cilësinë e ujit të tyre. Të kryhen rregullisht analizat e ujit të pijshëm me kampione të ujit të marra në shumë pika. Të mbrohen sipas ligjit burimet.
- Grumbullimi i aktiviteteve tregtare në zona të përcaktuara do të rrisë kontrollin e organeve përgjegjëse mbi mënyrën dhe sasinë e trajtimit të mbetjeve duke ndikuar pozitivisht në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe trupave ujor (lumenj, përrenj). Ky efekt do të varet shumë nga shkalla e bashkëpunimit privat-bashki. Rekomandohet të rritet zbatueshmëria e Ligjit Nr.9115.
- Zgjerimi i aktivitetit ekonomik mund të ketë një impakt pozitiv mbi rrjetin e shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe në kushtet kur menaxhimi i mbetjeve është sipas standardeve ndikimi mbi trupat ujore do të ishte i papërfillshëm. Rekomandohet përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve nga ana e Bashkisë.
- Zhvillimi i akuakulturës sidomos në rastet e sipërfaqeve ujore të mbyllura mund të ndryshojë statusin ekologjik të ujit. Rekomandohet të rritet zbatueshmëria e Ligjit Nr. 111/2012
- Krijimi i të ardhurave dhe rritja e punësimit përmes bizneseve të lidhura me detin, liqenin do të rrisë ndërgjegjësimin për ruajtjen e këtyre trupave ujore. Rekomandohet organizimi i fushatave sensibilizuese për peshkimin sipas sezoneve dhe për sasitë e lejuara. Rritja e kontrollit të institucioneve përkatëse në këtë drejtim.

2. Përmirësimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve dhe trajtimit të ujrave të zeza dhe të ndotura

- Nevoja për të standartizuar turizmin do të nxisë investimet publike dhe private për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe ujrave të zeza si dhe riciklimin e tyre në drejtim të plotësimit sipas standarteve më të mira për të qenë globalisht të konkurueshëm. Kjo kërkon plotësimin e Direktivës Evropiane për ujrat e ndotura CD 91/271/EEC dhe Ligjin Nr. 8102, datë 28.03.1996 (azhornuar me Ligjin nr. 9352, datë 3.3.2005; Ligjin Nr.9584, datë 17.07.2006 dhe Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008).
- Rritja e numrit të vizitorëve si pasojë e krijimit të polit të ri rekreativ në portin e peshkimit dhe në gadishullin Kodra e Marinës në Bashkinë Sarandë do të shtojë gjenerimin e mbetjeve dhe ujrave të zeza. Ky komponent në një periudhë afatmesme do të ndikojë pozitivisht pasi investimet në zonë do të përfshijnë edhe menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujrave të ndotura. Zbatimi i Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 (azhornuar me Ligjin nr. 9352, datë 3.3.2005; Ligjin Nr.9584, datë 17.07.2006 dhe Ligjin nr.9915, datë 12.05.2008).
- Ulja e ritmit të ndërtimeve dhe integrimi i zonave informale do të ndikojë pozitivisht në uljen e sasive të mbetjeve të ngurta si dhe trajtimin e ujrave të zeza.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · SEKRETARIA · TIRANE

2.3 Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra. Mbrojtja e Biodiversitetit.

Plani i Përgjithshëm Vendor, në përputhje me direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe strategjinë e mjedisit, ka patur parasysh shtimin, zgjerimin e hapësirave të gjelbërta me qëllim **ruajtjen e zonave të mbrojtura dhe rritjen e cilësisë së mjedisit natyror, mbrojtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e shëndetit publik.**

Krijimi i korridorit mjedisor me një gjatësi prej më shumë se 2,5 km përgjatë bregut do të shërbejë për të gjithë qytetarët dhe turistët duke rivitalizuar të gjithë elementët e bregdetit si dhe përmirësimin e aksesit të vijës së dytë më lart të ndërtimeve. Zbatimi i këtij Projekti do të rrisë sipërfaqet e gjelbërta në zonën urbane të Sarandës, gjë e cila mungon duke realizuar në të dyja anët e shëtitoreve mbjelljen me pemë me kurorë të gjerë dhe me lartësi të ulët.

Rehabilitimi i gadishullit dhe krijimi i parkut tek Kodra e Marinës do të sjellë përmirësimim e sipërfaqes së gjelbërt të qytetit, të pejzazhit që do të ndihmojnë në përmirësimin e biodiversitetit dhe shtimin e habitateve. Pasurimi i parkut me bimësi mesdhetare si dhe caktimi i një zonë buferike ku të mos lejohet asnjë aktivitet ndërtues do të kontribuonte në cilësinë e jetes në qytet.

Krijimi i ekoparkut ndikon pozitivisht në zgjerimin e hapësirave të gjelbërta në qytetin e Sarandës, kështu për një periudhë afatgjate ka një efekt pozitiv sinergjik në mbrojtjen e shëndetit publik. Gjithshtu mbjellja e luleve nëpër shkallare dhe tarracat e çative të shtëpive do të ndikojë pozitivisht. Rekomandohet gjithashtu edhe mbjellja e ekoparkut dhe e shtigjeve me pemë mesdhetare me kurorë të gjelbër, duke mundësuar krijimin e korridorit mjedisor përmes qytetit.

Zona periurbane e Sarandës do të shëndërrohet në një korridor mjedisor. Pyllëzimi i kodrave përreth saj do të krijojë mundësinë për mbrojtjen nga erozioni, pasurimin me habitatet, shtimin e zonave të gjelbërta dhe përmirësim e biodiversitetit. Impakti mbi ekosistemet natyrore do të jetë i madh. Pyllëzimi do realizohet sipas udhëzimeve të ekspertëve të pyjeve në përputhje me klimën e Sarandës. Duhet të sigurohen hapësira të mjaftueshme parkimi si kusht i nevojshëm për të mundësuar fluksin e turistëve. Të përcaktohet edhe zona buferike sipas ligjit për parqet natyrore.

Ruajtja e pejzazhit të bregdetit Sarandë – Ksamil duke përcaktuar edhe zonat buferike, shtimi i pejzazheve të mbrojtura, etj. do të ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e biodiversitetit, të habitateve dhe llojeve. Rekomandohet që në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, AKZM Bashkia duhet të përcaktojë grupin e specialistëve për të vlerësuar zonat prioritare natyrore që të marrin statusin e"mbrojtur".

Mbrojtja nga ndërtimet dhe pastrimi nga ndërtimet e braktisura dhe të papërfunduara i kodrës së Sarandës e cila do të shërbejnë si "mushkëria" e qytetit. Rekomandohen kufizime të ndërtimeve në kodrat e Sarandës në të cilat është i lejueshëm një intesitet që nuk e tejkalon 0.05 me një taksë të caktuar zhvillimi dhe gjobitje për ndërtimet e papërfunduara.

Ndërtimet në afërsi të kepit të Stillos që është një zonë e mbrojtur ndikojnë negativisht mbi të duke dëmtuar habitatet, biodiversitetin dhe strukturën në tërësi të tij dhe nga ana tjetër edhe impakti mbi natyrën do të jetë i madh për shkak të aktivitetit që do të shtohet në zonën përreth duke sjellë një degradim të elementëve mjedisore. Rekomandohet të shmangen

ndërtimet në afërsi të zonës së mbrojtur për të minimizuar efektin negativ të tyre mbi elementët e mjedisit.

Zgjerimi i zonave ekonomike mund të ketë ndikim negativ mbi disa elementë të mjedisit si biodiversiteti apo dëmtimi i pejzazhit. Rekomandohet të realizohen VNM-ja në lidhje me ndërtimet dhe ndryshimet e kufijve të vendbanime ekzistuese dhe atyre ekonomike. Nevojiten masa për zbatimin e rregulloreve të ndërtimit.

Industria e peshkimit mund të ndikojë negativisht në drejtim të biodiversitetit detar (peshkimi dhe akuakultura). Rekomandohet të kufizohet dhënia e lejeve për akuakulturë dhe të rritet kontrolli në lidhje me akuakulturën dhe peshkimin dhe të respektohet marrëveshjet, konventat, protokollet ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë.

Restaurimi dhe rehabilitimi i zonave arkeologjike, nxitja e eko-turizmit dhe e formave të tjera të saj, ndikon pozitivisht në ndërgjegjësim kundrejt të mirave që burojnë prej e tyre. Respektimi rigoroz i distancës për zonat tampon. Rekomandohet krijimi i programeve ndërgjegjësuese lidhur me ruajtjen e mjedisit nga ana e Bashkisë dhe e shoqërisë civile, hartimi i rregulloreve për ruajtjen e parqeve dhe publikimi i tyre.

Promovimi nga ana e Planit për aplikimin e metodave të kultivimit të prodhimeve "bio"në zonë dhe zhvillimi i eko-turizmit me të gjitha format e tij do të ndikojë pozitivisht në rritjen dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta, ruajtjen e biodiversitetit dhe habitateve, në shëndetin e popullatës dhe sigurisht në industrinë e turizmit

Projektidea që lidhet me investimet për aeroportin prekin një sipërfaqe relativisht të madhe të tokës bujqësore dhe se korridoret e fluturimit mund të kalojnë mbi hapësirën e zonave të mbrojtura, kjo do të ketë një ndikim të përhershëm në biodiversitetin e zonës dhe reduktimin e zonave të gjelbërta.

Investimet në infrastrukturën rrugore pranë zonave të ndjeshme natyrore dhe bregdetare do të japin një impakt negativ në rast se nuk zbatohen rregulloret për investime të kësaj natyre. Hapja e rrugës nga veriu do të jetë një investim i madh me ndikim në pejzazhin e qytetit të Sarandës.

Janë të nevojshme hartimi dhe afishimi i rregulloreve me 10 udhëzimet më të nevojshme për zonat e ndjeshme (si psh të mos shqetësohen speciet, të disiplinohen shërbimet private dhe publike për mbetjet, qeset etj, mos marrjen e suvenireve nga vendet arkeologjike etj).

Harta bashkangjitur tregon vendet e ndërhyrjes së propozuar për shtimin e hapësirave të gjelbërta të bashkisë Sarandë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË SEKRETARIA



Harta 17 – (19e) Hapesirat publike, rruget kembesore dhe te bicikleteve te proposuara

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

Tabela 16 Sipërfaqet e propozuara të zonave të mbrojtura, të trashgimisë kuturore dhe momumenteve

Njësia Administrative	Rezervë strikte natyrore, zona të mbrojtura pejzazhistike	
	Ekzistuese N1, N2, N3, M3 (në ha)	Të propozuara N5, N6 (ne Ha)
Saranda	27.39 ha	1864 ha
Ksamili	457.52 ha	302.69 ha
Totali	**484.91 ha**	**2166.69 ha**

Burimi GIS Database

Tabela 17 Sipërfaqet e gjelbra dhe publike të shtuara

Njësia administrative	Sip. sportive, Sip. të gjelbra, Hapësira publike	
	Ekzistuese AR.3, AR.4 (ne Ha)	Të propozuara AR. 3, AR.4 (ne Ha)
Sarandë	16.31 ha	46.37 ha
Ksamili	0.26 ha	12.76 ha
Totali	**16.57 ha**	**59.13 ha**

Burimi GIS Database

2.4 Parashikimi i dy varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar përsa u përket hotspoteve

Në bashkinë e Sarandës problematika mjedisore nuk ka të bëjë me ekzistencën e një hotspoti të mirëfilltë, por është e lidhur me zonat dhe aktivitete të cilat paraqesin rrezikshmëri në rast se nuk ndërhyhet për mënjanimin e tyre. Ajo është e lidhur kryesisht me praninë e portit dhe të marinave, ndërtimeve në bregdet kur rreth 52000m^2 i janë marrë detit, me grumbullimet e mbetjeve në zonat e pautorizuara dhe më pak e lidhur me guroret.

Prania e porteve në zonën e Sarandës dhe shtimi i numrit të turistëve, bën që atje të operojnë anije peshkimi të kapaciteteve të ndryshme, anije udhëtarësh (tragete të linjave ndërkombëtare), anije të transportit të mallrave etj. Afërsia me Greqinë e rrit këtë numër anijesh në mënyrë të ndjeshme. Sasia e karburantit të konsumuar në harkun e një vitit bazuar edhe në të dhënat detare të administratës portuale si dhe të studimeve të kryera e tejkalon sasinë prej 900 000 litrash. Ndikimi negativ në mjedisin detar të Sarandës dhe zonave përreth (zona e ndikimit deri në 500 m) vjen si pasojë e sasisë së naftës së shkarkuar në mjedisin detar, si rezultat i mosdjegies së plotë të naftës në motorët. Dihet se rreth 10% e ujit nga mbetjet e motorëve të anijeve të peshkimit është mbetje, duke i detyruar ato t'i nxjerrin jashtë në det. Këtu mund të shtohet edhe derdhja e ujit që përdorin anijet çisternë që mbushin depozitat e tyre për qëllime të ekuilibrimit të tyre. Nisur nga shtimi aktivitetit turistik dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

ekonomik portet dhe marinat në këtë bregdet do të përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm nga ku lind dhe nevoja e një monitorimi të rreptë dhe kontrolli të zbatimit të rregulloreve për të shmangur katastrofat si në rastin e petroliferës në Vlorë. Gjithashtu në trupin e anijeve rriten lloje të cilat dëmtojnë llojet endemike që gjenden në gjirin e Sarandës.

Ky është një problem sot që haset në të tëra ato vende ku ka marina dhe porte. Duke qenë se shpeshherë ato janë pjesë të infrastrukturës turistike dhe të transportit dhe shmangia e ndërtimit të tyre bëhet e vështirë, pasi do ndikonte negativisht mbarëvajtjen e e këtyre industrive, atëhere alternativa e vetme mbetet shmangia e ndikimit të tyre negativ në mjedis. Shmangia e ndotjes se ujit të detit nga portet dhe marina do mund të bëhet në rast se zbatohen rregulloret dhe aktet nënligjore të Ligjit nr. 9410 për portet turistike në Republikën e Shqipërisë nga njëra anë dhe nga ana tjetër duke përfituar nga eksperienca ndërkombëtare ku dallojnë zbatimi i rregulloreve të personalizuara lidhur me mirëmbajtjen, furnizimin me ujë, përdorimin e tualeteve, të bojrave, riparimeve etj (https://dnr.mo.gov/pubs/pub1188.pdf).

Grumbullimi i mbetjeve në hapësira jo të autorizuara është një problem tjetër i nxehtë që dëmton rëndë imazhin e Bashkisë, mjedisin, turizmin dhe shëndetin e popullsisë. Në grykëderdhjen e Bistricës, ku dhe lumi hyn në kufirin e Bashkisë vihen re mbetje të depozituara të kategorive të ndryshme si rezultat i prurjeve por edhe i hedhjes në mënyrë abuzive. Ngritja e një grupi pune të posacëm me një afat kohor të kufizuar, i cili do të evidentonte dhe do të mundësonte largimin e këtyre mbetjeve, i mbështetur me bazën materiale të nevojshme do siguronte një pastrim të menjëhershëm të këtyre vendgrumbullimeve të pautorizuara. Gjithashtu edhe organizimi i pastrimeve vullnetare me iniciativën e Bashkisë dhe të shoqërisë civile, ku do të përfshihej edhe popullata e interesuar pranë këtyre zona do të përbënte një alternativë më pak të kushtueshme por me ndikim më të madh në ndërgjegjësimin e popullatës. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në pastrimin e këtyre zonave por edhe në parandalimin e ndotjes së tyre në të ardhmen.

Në territorin e bashkisë Sarandë, rrugës për në Himarë, gjenden gurore monitorimi i të cilave është e një rëndësie të veçantë megjithëse aktualisht ato nuk përbëjnë një shqetësim.

Riliçensimi dhe rinovimi i lejeve për këto industri është një proces i një rëndësie të veçantë dhe duhet të bëhet në respekt të ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse (udhëzim 3, Maj 2006 Ministria e Mjedisi, Ligj për Vlerësim e Thelluar Mjedisor. Në mënyrë të veçantë për guroret është e rëndësishme aplikimi i udhëzimit në pikat e nenit 14 (a, b, c, d).

Tabela 18 Monitorimi i guroreve dhe rehabilitimi

Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i rinovimit të licencës për guroret pa vlerësimin paraprak mjedisor nga Agjencia e Vlerësimit Rajonal të Mjedisit	100%	2017
Rehabilitimi i guroreve ekzistuese sipas Direktives 3, Maj 2006 MoEFËA	100%	2018

2.5 Parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Në analizën e gjendjes aktuale në bashkinë Sarandë, vlerësimi i cilësisë së ajrit është monitoruar nga institucionet përkatëse, por jo në mënyrë të rregullt sipas standardeve. Nga

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TËRRITORIT TIRANË SEKRETARIA

rezultatet e pjeshme ai nuk rezulton shqetësues, por duke marrë parasysh zhvillimin e zonës Bashkia duhet të sigurojë dhe të synojë që parametrat e cilësisë së ajrit të mbeten brenda kufijve të përcaktuara si normale nga Direktiva *2008/50/EC për cilësinë e ajrit si dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Ligjin nr. 162, date 04.12.2014 " Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit".* Bashkia duhet të monitorojë nivelin e ndotësve në mënyrë periodike sidomos gjatë sezonit veror, dy herë gjatë muajve korrik dhe gusht dhe të paktën njëherë jashtë këtij sezoni. Në varësi të monitorimeve Bashkia duhet edhe të marrë masat e nevojshme për uljen apo ruajtjen e vlerave brenda standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Strategjia e mjedisit 2015-20 përcakton objektivat e qeverisë shqiptare për një numër ndotësish si:(i) ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane; (ii) arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NOx - 40 μ/ m³, për PM10 - 40 μ/ m³, për PM2,5-25 μg/m³ dhe 20 μg/m³ dhe SO_2-125 μ/ m³ per 24 orë ose 20 μ/ m³ në vit.

Tabela 19 Vlerat kufi të ndotësve

Periudha e monitorimit				Objektiva nga 2016
Ndotësit (μg/m³)	Metoda	Vlera e periudhës mesatare	Standarde AL (μg/m³)	Standarde e BE (μg/m³)
Pluhuri total	gravm		140	80
PM 10	Ads		40	40
O_3	Ads		120	110
NO_2	Ads		50	40

Burimi: ISHP

Tabela 20 Niveli kufi i ndotësve të ajrit për t'u monitoruar në bashkinë e Konispolit

Ndotësit	Përqendrimi	Periudha mesatare	Te monitorohet dhe zvogëlohet nga viti
Grimcat e Imëta (PM2.5)	25 μg/m3	1 vit	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2015
Dyoksidi i Squfurit (SO2)	350 μg/m3	1 ore	Vlera Limit ka hyrë në fuqi 1.1.2014
	125 μg/m3	24 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
Dyoksid Azoti (NO2)	200 μg/m3	1 ore	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
	40 μg/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 1.1.2014
PM10	50 μg/m3	24 orë	Vlera Limit është në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

			fuqi 1.1.2013
	40 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2014
PLUMB (Pb)	0.5 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Monoksid Karbon (CO)	10 mg/m3	Maksimalja ditore 8 orë mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2013
Benzen	5 µg/m3	1 vit	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Ozon	120 µg/m3	Maksimalja ditore 8 orë mesatarja	Vlera Limit është në fuqi 1.1.2010
Arsenik (As)	6 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Cadmium (Cd)	5 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Nikel (Ni)	20 ng/m3	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
Hidrokarbure aromatike policiklike	1 ng/m3 (i shprehur si përqendrim i benzenit (a)pirene)	1 vit	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2016
PM2.5 Përqendrim i ekspozuar i detyruar	20 µg/m3 TME (Treguesi mesatar i ekspozimit)	Bazuar në mesataren e 3 viteve	Vlera Limit hyn ne fuqi 31.12.2018

Burimi: ISHP

Përmirësimi i cilësisë së karburanteve, i rrjetit rrugor dhe zgjerimi i transportit publik, rrijta e korsive për biçikletat, përdorimi i taksive ujore do të mundësojnë të rritet shpejtësia e lëvizjes dhe ulja e trafikut gjatë sezonit në rrugët kryesore të qytetit nga njëta anë dhe nga na tjetër kontrolli mbi kantieret e ndërtimit do të ndikojnë që niveli i ndotjes në bashkinë Sarandë parashikohet mbetet brenda intervalit të vlerave të lejuara të standardit kombëtar dhe ndërkombëtar (tabelat 12 dhe 13).

Gjithashtu, Bashkia duhet të marrë masat për të siguruar transparencën lidhur me informacioni mbi cilësinë e ajrit për grupet e interesit dhe publikun.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

2.6 Zhurmat dhe ndotja akustike

Të dhënat mbi ndotjen akustike në bashkinë e Sarandës mbeten brenda intervaleve të lejuara me përjashtime (sipas një sondazhi të realizuar gjatë periudhës të vlerësimit të territorit) në zonën pranë hotel Butrinit, ku gjatë sezonit veror lokalet e natës krijojnë shqetësime me muzikën e tyre. Sidoqoftë kjo muzikë mbyllej pas orës 24.00. Një bazë të dhënash lidhur me nivelin e zhurmave në zonë sigurisht që do të ndihmonte shumë në përcaktimin e saktë të masave që duheshin marrë në zonat më të ndjeshme për të siguruar një zonë turistike të shëndetshme dhe relaksuese.
Në përgjithësi **vlera e synuar për zhurmat** nuk duhet të kalojë vlerën maksimale prej ***Lmax-56 dB*** gjatë ditës dhe ***45 dB*** gjatë natës në të gjitha zonat e Bashkisë. Për të realizuar këtë duhen marrë masa të përshtatshme që të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat kombëtare dhe ato ndërkombëtare e sidomos me Direktivën e Zhurmave në Mjedis 2002/49/EC.

2.7 Parashikime për menaxhimin e mbetjeve

Bashkia e Sarandës për nga sasitë e llogaritura gjeneron në tërësi rreth 28 800 t mbetje në vit, pra sasia është modeste.
Grumbullimi i mbetjeve në hapësira jo të autorizuara dhe mungesa e riciklimit është një problem i nxehtë që dëmton rëndë imazhin e Bashkisë, mjedisin, turizmin dhe shëndetin e popullsisë. Ndotja e ujërave të lumit të Bistricës është një tjetër problem i nxehtë, që lidhet me mungesën e kulturës qytetare. Në grykëderdhjen e tij, ku dhe lumi hyn në kufirin e Bashkisë vihen re mbetje të depozituara të kategorive të ndryshme si rezultat i prurjeve, por edhe i hedhjes në mënyrë abuzive.

Figura 8 Ndërtime dhe grumbullime mbetjesh në grykëderdhjen e Bistricës
Burimi: Foto te Eksperteve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Në tabelën e mëposhtme jepen disa objektiva që synojnë në reduktimin kohor dhe riciklimin e mbetjeve për vitet në vijim.

Tabela 21 Objektivat për reduktimi e mbetjeve

Parimi	Objektiva	Nga viti
Asgjesimi i mbetjeve qe shkojnë në landfill	Reduktimi në masen 45%;	2020
Riciklimi dhe ripërdorimi	Mbledhja e diferencuar e mbetjeve nga 35%	2020
Përmirësimi i asgjësimit përfundimtar dhe monitorimi	Të gjitha mbetjet e mbledhura me 100%	2017
Shmangia e asgjësimit në shtretër të lumenjve dhe rrugëve anësore	Të gjitha mbetjet 100%	2017
Asgjësimi në landfille në mënyrë të kontrolluar	Në masën 35%	2017
Monitorimi i mbetjeve të industrisë së peshkut dhe akuakulturës	Shmangia e rritjes se peshkut në gjire të mbyllura nga 100%	2017
Portet e reja dhe ekzistuese (marina)	Shmangia e derdhjes së naftës dhe mbeturinave të tjera në det	2017

2.8 Parashikime për mbrojtjen e Tokës

Toka bujqësore në bashkinë e Sarandës është me sipërfaqe shumë të kufizuar ku një pjesë të konsiderueshme të saj e zë pemtaria. Monitorimi i saj është mjaft i rëndësishëm sidomos në kushtet kur presioni i zhvillimit po e redukton atë në mënyrë konstante. Grupi i ekspertëve ka vendosur dy objektiva lidhur me gjendjen aktuale të tokës bujqësore me qëllim përmirësimin e gjendjes së saj pas aprovimit të Planit.

Tabela 22 Monitorimi i tokës bujqësore

Parime	Objektiva	Viti
Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore nën ujë	Me 10%	2019
Rritja e sipërfaqes së tokës me bonitetit të lartë	Me 10%	2020

2.9 Veprimi mbi asetet e bashkisë Sarandë/kohezioni social

Bashkia Sarandë është shumë e pasur në asete ku përfshihet potencialisht Parku i madh i Butrinit me vlera të larta natyrore dhe kulturore, plazhet e mrekullueshme përgjatë bregdetit, në pjesën veri-perëndimore të saj duke përfshirë Ksamilin dhe ishujt e tij me bukuri dhe pasuri të rrallë natyrore. E gjithë kjo nëse do të shihet nga pikëpamja e zhvillimeve turistike do të përkthehet në një fuqizim të rëndësishëm ekonomik. Një aset i rëndësishëm është gjithashtu dhe popullsia vendanse e cila domosdoshmërisht duhet të integrohet dhe të kualifikohet me qëllim

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANE · SEKRETARIA

që t`i përgjigjet standarteve të punësismit dhe shërbimit të qytetit/zonës turistike të Bashkisë. Duke analizuar asetet dhe pasuritë e zonës vërehet sa më poshtë:

Asete të rrezikuara dhe të kërcënuara në bashkinë Sarandë janë një shqetësim kombëtar dhe ndërkombëtar në shumë raste. Studimet tregojnë se nga dukuria e mbushjes së detit, llogaritet që rreth 52 mijë metra katrore i janë"rrëmbyer" sipërfaqes ujore. Kjo mbushje ka ardhur si rezultat i ndërtimeve abuzive apo edhe si rezultat i mungesës së kulturës mjedisore. Mbetjet e ndërtimit dhe ndërtimi pa kriter mbeten një kërcënim për vijën bregdetare të Sarandës. Ekosistemi i Lagunës së Burintit është i pasur, kompleks dhe i brishtë. Si i tillë ai është i kërcënuar nga një numër faktorësh që kanë nxitur edhe një numër të madh studimesh shkencore lidhur me shkallën e dëmtimit të tij. Disa nënekosisteme të tij si Liqenet (Butrintit, Bufit dhe Ujit të qelbur), fushat përreth që e rrethojnë nga jug-lindja dhe veriu si dhe kodrat e malet që e rrethojnë nga lindja (mali i Milesë) ndikojnë mbi të në mënyrë indirekte. Kështu ndërhyrjet antropogjenike (kanalet ujitës bujqësor, përdorimi i pesticideve etj) të këtyre viteve, kanë ndikuar në ekuilibrat e ekosistemit sidomos në cilësinë e ujit.

Hartimi i planeve të menaxhimit ka ndikuar pozitivisht në këtë ekosistem por megjithatë problematika është e gjerë. Prodhimi i midhjes dhe peshkimi në liqen, si rrjedhojë e kushteve jo favorizuese të qarkullimit të ujërave në sezonin e verës, ka sjellë varfërimin në oksigjen, rritjen e temperaturës së ujit dhe pranisë së anhidridit sulfuror në shtresat e sipërme të sipërfaqes liqenore.



Figura 9 Pamje të strukturave të rritjes së midhjes në Liqenin e Butrintit
Burimi: Foto të Eksperteve

Prania e porteve në zonën e Sarandës dhe shtimi i numrit të turistëve, bën që atje të operojnë anije peshkimi të kapaciteteve të ndryshme, anije udhëtarësh (tragete të linjave ndërkombëtare), anije të transportit të mallrave etj. Afërsia me Greqinë e rrit këtë numër anijesh në mënyrë të ndjeshme. Sasia e karburantit të konsumuar në harkun e një vitit bazuar edhe në të dhënat detare të administratës portuale si dhe të studimeve të kryera e tejkalon sasinë prej 900 000 litrash. Ndikimi negativ në mjedisin detar të Sarandës dhe zonave përreth (zona e ndikimit deri në 500m) vjen si pasojë e sasisë së naftës së shkarkuar në mjedisin detar, si rezultat i mosdjegies së plotë të naftës në motorët. Dihet se rreth 10% e ujit nga mbetjet e motorëve të anijeve të peshkimit është mbetje, duke i detyruar ato t'i nxjerrin jashtë në det. Këtu mund të shtohet edhe derdhje e ujit që përdorin anijet çisternë që mbushin depozitat e tyre për qëllime të ekuilibrimit të tyre. Nisur nga shtimi aktivitetit turistik dhe ekonomik portet dhe marinat në këtë

bregdet do të përbëjnë një kërcënim të vazhdueshëm, nga ku lind dhe nevoja e një monitorimi të rreptë dhe kontrolli të zbatimit të rregulloreve për të shmangur katastrofat si në rastin e petroliferës në Vlorë. Gjithashtu në trupin e anijeve rriten lloje të cilat dëmtojnë llojet endemike që gjenden në gjirin e Sarandës.

Figura 10 Grumbullime mbetjesh
Burim: Foto te Eksperteve

Në zonën tonë të studimit drejtimet ekonomike në këto 25 vjet kanë qenë të paqarta pavarësisht orientimit qendror. Nga momenti që orientimi parësor ka qënë turizmi, ndërtimi i planifikuar ka sjellë një rënie të cilësisë së shërbimit si edhe të orientimit të ndërmjetëm bujqësi-industri (si asete kryesore të Sarandës) dhe kjo e fundit i ka tejkaluar përmasat e një zhvillimi të qendrueshëm. Ekziston një lidhje e fortë midis përdorimit të materialeve, energjisë së përdorur, përdorimit të tokës për aktivitetet prodhuese dhe konsumuese të të mirave materiale me njësitë ekonomike, shoqërinë dhe politikat territoriale. Perspektiva e rritjes ekonomike në bashkinë Sarandë, e ndikuar kryesisht nga zhvillimet në sektorin e turizmit, duhet të marrë parasysh dhe të fuqizojnë potencialin e rikthimit të emigrantëve me një eksperiencë disavjeçare në aktivitet dhe sipërmarrjet turistike jashtë vendit. Kjo fuqi punëtore e pajisur me eksperiencën e duhur për të kontribuar në këtë sektor ekonomik, do të shërbejë si shtysë për fuqizimin e ardhshme të kohezionit social dhe bashkëveprimit gjithnjë e më frytdhënës kryesisht me Greqinë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË SEKRETARIA

3. PLANI I SHËRBIMEVE DHE INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE

3.1 Infrastruktura publike e propozuar

Transporti Ajror

Një aeroport në Sarandë do të ndryshojë tërësisht karakteristikat e rajonit duke siguruar një aset shumë të rëndësishëm për promovimin e zonës jo vetëm si një destinacion ndërkombëtar për turistët që mund udhëtojnë nga vende shumë larg nga Shqipëria, por edhe për fluturimet e brendshme të cilat mund të programohen nga Aeroporti i Tiranës si dhe nga aeroporti i Kukësit i cili është airporti i dytë civil në vend, aktualisht jo funksional.

Figura 11 Pozicioni i propozuar, aeroporti i Sarandës
Burimi: Studimi Teknik

Vendndodhja e propozuar e aeroportit të Sarandës. Nëse zhvillohet do të ndikojë në të gjitha parametrat e planit lokal.

Transporti Detar

Në Sarandë pritet të rritet roli i portit të pasegjerëve nëpërmjet shtimit të lidhshmërisë me portin e Korfuzit. Në qytetin bregdetar të Sarandës mungojnë fasilitetet e marinës detare si edhe sportet detare. Një plan për zhvillimin e turizmit detar është i nevojshëm për integrimin e bregdetit në intinerarët e gjerë të lundrimit nga Adriatiku në bregdetin e Jonit, nisur nga fakti se, aktualisht, Shqipëria përbën një lidhje përgjatë bregdetit lindor të Adriatikut dhe të Jonit. Mundësia e transportit detar me anije për vizita turistike, por edhe për pasagjerë, është me shumë interes për t`u promovuar. Kjo është një ide e përshtatshme duke pasur parasysh qasjen e vështirë të plazheve në bregdetin e Sarandës dhe Ksamilit. Gjithashtu, porti po zhvillohet mbi bazën e Masterplanit, si port me funksion turistik për transportimin e pasagjerëve, ndërsa transportimi i mallrave do të bëhet në portin e Limanit (rreth 3 km larg portit të qytetit).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Transporti Publik

Për bashkinë Sarandë zhvillimi i një transporti të qëndrueshëm dhe të aksesushem do të jetë një orientim mjaft i rënësishëm strategjik. Kjo pasi krijimi i një aeroporti të ri rajonal që do të shërbejë për Jugun e vendit. Po kështu e rendesishme do të jetë përmirësimi i lidhjes ndërkufitare midis Sarandës dhe Greqisë (Igumenicë-Janinë-Korfuz). Përmirësimi i lidhjeve rrugore midis Sarandës dhe Gjirokastrës. Hierarkia e rrjetit të brendshëm rrugor. Promovimi i transportit publik dhe përmirësimin e aksesueshmërisë për këmbësorët. Të gjitha këto komponente si pjesë e këtij orintimi strategjik janë në përputhje me PPK dhe PINS Bregdeti.

- *Aksesueshmëria dhe transporti i qëndrueshëm*

Në mbështetje me këtë orientim strategjik janë përcaktuar 3 objektiva strategjike të përcaktuara si më poshtë:

- Përmirësimi i lidhjes ndërkufitare dhe ndërrajonale
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe lidhjeve të transportit detar
- Përmirësimi i transportit publik dhe vendparkimit

Realizimi i objektivave strategjikë sipas orientimeve strategjike kërkon edhe ndërtimin e programeve specifike për çdo objektiv si dhe projekte të llojeve dhe natyrave të ndryshme për arritjen e objektivave strategjik konkretë

- *Përmirësimi i lidhjes ndërrajonale ne infrastukturë*

Në kuadër të realizimit të këtij programi propozohen projektet e mëposhtme për infrastrukturën:

- Ndërtimi i lidhjes me urë midis Sarandës dhe Korfuzit.
- Ndërtimi i një aeroporti të ri rajonal
- Krijimi i lidhjeve të reja rrugore që bëjnë të mundur reduktimin e kohës së udhëtimit midis Sarandës dhe Gjirokastrës, të cilat do të kenë akses në aeroportin e propozuar.
- Lidhja e Sarandës me rrjetin e ri tranzit të autobuzëve të korridorit të pasëm të rivierës i cili operon përgjatë SH4.
- Ndërtimi i terminalit të ri të autobuzëve dhe krijimi i zonës për vendparkime në pjesën ku ndodhen tregu dhe depot e vjetra (Idriz Altima).

- *Përmirësimi i infrastrukturës dhe lidhjeve të transportit detar*

Në kuadër të realizimit të këtij programi propozohen projektet e mëposhtme për infrastrukturën:

- Përmirësimi i lidhjes së transportit detar midis Sarandës dhe Korfuzit
- Ndërtimi i marinës detare; "Port Jahtesh" në pjesën urbane të bregdetit përballë hotel Butrintit
- Funksionimi i taksive ujore përgjatë bregdetit shërbim, i cili është kompetencë e bashkisë Sarandë

- *Përmirësimi i transportit publik dhe vendparkimit*

Në kuadër të realizimit të këtij programi propozohen projektet e mëposhtme për infrastrukturën:

- Përmirësimi i shërbimit lokal me autobus mes Sarandës - Manastirit -Ksamilit -Butrintit - Finiqit – Konispolit
- Krijimi i zonave të parkimit brenda zonës urbane Ksamil (300 hapësira)
- Krijimi i zonave të parkimit për plazhet e Ksamilit (500 hapësira)
- Krijimi i zonave të parkimit brenda zonës urbane Sarandë (500 hapësira)
- Krijimi i zonave të parkimit për plazhet e Sarandës (800 hapësira)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA



Figura 12 Skema e propozuar për rigjenerimin urban për projektin Sunset Strip

Burimi: Punuar nga ekspertët

- *Itinerari i varkave Taksi të propozuara gjatë sezonit të verës*
- Kakome – Sarandë. Vendndodhja e sugjeruar në vendin ekzistues të portit të Kakomesë
- Porti i vjetër i peshkimit Sarandë. Vendndodhja e sugjeruar në udhëkryqin e rrugëve pranë detit
- Pikë kryesore për vendosjen e varkave taksi përballë Hotel Butrintit
- Hotel Butrinti – Mango Beach
- Manastir – Plazhi i Pasqyrave
- Plazhi i Sarandës qendër – Plazhi i Ksamilit
- Plazhi i Ksamilit-Kepi i Skelës- Kalaja e Ali Pashës – Kanali i Vivarit.
- Kanali i Vivarit – Liqeni i Butrintit
- Kalaja e Ali Pashës – Kepi i Stillos
- Ksamil-Gryka e Vrinës- Kepi Stillos – Gjiri Ftelias

- *Mintragetet gjatë sezonit të verës*

- Gjiri i Ftelias -Ksamil- Sarandë -Himarë-Dhërmi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA



Harta 18 – (19g) Transporti Publik

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

3.1.2 Infrastrukturë rrugore e propozuar

Rrjeti i rrugëve është një pjesë integrale e një zone urbane apo rurale, pasi lidh zonat dhe vendet, si dhe lehtëson lëvizjen e njerëzve, automjeteve dhe mallrave. Përveç kësaj, rrjeti rrugor luan një rol vendimtar në mbështetjen e zhvillimit dhe më konkretisht në zhvillimin e turizmit, duke lejuar qasje në zonat e zhvilluara rishtazi, zonat e interesit dhe tërheqjeve të tjera. Për këto arsye, është shumë e rëndësishme për të zhvilluar një rrjet të qartë dhe të mirëpërcaktuar rrugor, që ndjek një hierarki duke përcaktuar madhësinë e tij, funksionin dhe qëllimin.

Eshtë në çdo rast e një rëndësie të madhe duke marrë parasysh se alternativa kryesore e transportit për njerëzit në këtë rajon është makina. Në këtë moment nuk ekzistojnë rrugë të vazhdueshme bregdetare. Duhet të depërtohet në brendësi dhe të kalohet shpesh herë nëpërmjet luginave gjë që e bën të gjithë përvojën një eksperiencë shumë të fragmentuar. Bëhet i nevojshëm në këtë kuadërt koncepti i një qasje bregdetare në tri nivele nëpërmjet

a) rrugës së vazhdueshme pejzazhistike bregdetare

b) rrugës kryesore bregdetare që vazhdon më tej në brendësi duke lidhur të gjitha vendbanimet malore

c) korridorit ekspres të autostradës ndërrajonale.

Projektet më të rëndësishme për aksesibilitetin e rrugëve janë si më poshtë:

Rruga Bregdetare Pejzazhistike – [Velipojë – Shëngjin - Patok - Durrës - Divjakë - Seman - Vlorë -Dhërmi - Sarandë - Butrint]

Eshte një nga lidhjet më strategjike përsa i përket forcimit të ekonomisë së turizmit bregdetar të vendit dhe agroturizmit. Rruga do të jetë e tipit pejzazhistik, me impakt të ulët në mjedis (jo e projektuar për trafik të rëndë) që pajiset me infrastrukturën e duhur në nyjet kryesore lidhëse-stacionuese, të cilat përkojnë me qendra lokale apo lokalitete të rëndësishme përgjatë këtij itinerari. Vlen të theksohet se për shkak të ndjeshmërisë së lartë mjedisore të zonave ku pritet të kalojnë segmente të caktuara të këtij itinerari, duhet të tregohet kujdes i veçantë në projektimin e brezave të gjelbërimit përgjatë tij. Pins Bregdeti

Përmirësimi i rrugës ndërlidhëse Gjirokastër-Delvinë-Sarandë.

Ndërtimi i këtij segmenti rrugor me tunel do ta përmirësojë ndjeshëm aksesueshmërinë e Sarandës dhe bregdetit të jugut nga Tirana, por edhe nga aeroporti i Janinës. Gjithashtu sipas PINS dhe PKK-së, ai do të krijojë lidhshmëri midis dy qyteteve të rëndësishme të Jugut të Shqipërisë duke nxitur rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe të zinxhirëve të prodhimit midis zonave në brendësi dhe atyre bregdetare. Ky duhet të mbështetet nga zgjerimi i shërbimeve që janë shtylla kurrizore, domethënë nga rrjeti i fibrave optike, ujit dhe kanalizimeve, deponimive të mbetjeve dhe rrjetit të zgjeruar të energjisë elektrike në gjendje për të përballuar a) zhvillimin e teknoligjisë b) kërkesën për makina hibride c) kërkesën për infrastrukturë të re transporti d) furnizimin me energji të rinovueshme. Në nivel ndërrajonal vërehen dy prioritete të lidhshmërisë: a) përmirësimi i kushteve të trafikut brenda qyteteve bregdetare dhe territoreve të urbanizuara dhe përmirësimi i fluksit në periudhën e verës i shkaktuar nga turistët, vizitorët e përditshëm dhe trafiku lokal që përshkon zonat; b) përmirësimi i lidhjes nëpërmjet rrjetit interurban dytësor midis qendrave kryesore dhe fshatrave. Kjo e fundit është shumë e

rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së jetës për popullsinë permanente, por edhe për tërheqjen e vizitorëve për të vizituar fshatrat dhe për të nxitur agroturizmin.

Projekti i Rrugës Borsh- Tepelenë
Ky është një projekt shumë i rëndësishëm që i kombimuar me bypass-in e Vlorës mund të përmirësojë ndjeshëm aksesin ndaj Rivierës së Himarës duke krijuar një pikë të re hyrëse për në rivierën e Borshit dhe duke reduktuar kështu kohën e udhëtimit nga Tirana në Sarandë.

Projekti i "Rrugës së Lumit" përmirëson lidhshmërinë e zonës Vlorë-Sarandë zhvillimin e zinxhirëve të turizmit bregdetar.

Përshkrim i *përgjithshëm Bashkia Sarandë*
Saranda është jo vetëm një qendër e rëndësishme urbane por edhe kryqëzimi i disa prej korridoreve të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Kësisoj Saranda, përtej rrugëve detare preket nga dy akse rrugore të rëndësishme si: Korridori Blu dhe Unaza Gjirokastër-Sarandë-Igumenicë-Janinë. Korridori Blu është një korridor paneuropian i cili kërkon të krijojë vazhdimësinë e aksit bregdetar i cili fillon nga Italia, Sllovenia, Kroacia, vazhdon më tej në Mal të Zi, lidhet me Shqipërinë dhe më pas vazhdon për në Greqi, ku lidhet më pas me rrugën Egnatia. Të qënit pjesë e këtij korridori Strategjik Europian është tejet i rëndësishëm dhe vjen si pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit Adriatiko Jonian. Saranda është pjesë e Unazës ndërkufitare Gjirokastër-Sarandë-Igumenicë-Janinë-Sarandë, e cila lidh katër qytete tejet të rëndësishme të Ballkanit Jugperëndimor me njëra- tjetrën. Kjo unazë është një itinerar i rëndësishëm tregtar por edhe turistik. Shkëmbimi i turistëve dhe fuqizimi i kësaj unaze do të ofronte një rritje të mëtejshme ekonomike të këtij rajoni.

Njësia administrative Sarandë
Mungesa e planit urbanistik gjatë gjithë 20 viteve të fundit reflekton direkt kaosin në infrastrukturën si urbane dhe rurale të Sarandës, ndonëse ka patur invesime nga bashkia Sarandë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit ajo vazhdon të mbetet problematike. Në vështrim të parë Saranda karakterizohet nga një rrugë e vetme qëndrore që ka funksion dhe hyrës dhe dalës në qytet. Kjo është rruga Skenderbeu Sh8. Një numër i kosiderueshëm rrugësh urbane në Sarandë kanë nevojë për mirmbajtje, asfaltim, ndriçim etj. Gjithashtu për shkak të mënyrës intensive të zhvillimit të ndërtimeve, infrastruktura nuk ka arritur të përshtatet me të njëjtën shpejtësi. Si rrjedhojë shumë rrugë kane mbetur pa përfunduar
Rrjeti rrugor, si në akset kombëtare ashtu dhe në arteriet kryesore që lidhin këto akse me destinacionet turistike dhe fshatrat, Metoq dhe Gjashtë është në kushte jo të mira fizike.

Rrjeti rrugor kryesor
Qyteti i Sarandës karakterizohet nga pesë rrugë kryesore paralele dhe në disa akse kemi rrugët pingule me to. Të gjitha rrugët e qendrës së qytetit janë jashtë standarteve dhe mungojnë distancat e trotuareve në shumë segmente të tyre

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Rrugët pingule me këto të mësipërmet janë të ngushta dhe jo të mirëmbajtura. Hyrja e qytetit lidhet me qytetin e Sarandës nëpërmjet një rruge në qafën e Gjashtës e cila është e paorganizuar. Kjo është një rrugë e Kategorise B, interurbane kryesore me karrexhata të pavarura por të pandara me trafik ndarës, me 2 korsi levizje. Ekziston mundësia e lidhjes me rrugën nacionale të bregut nëpërmjet rrugës së Teqesë, e cila do të shfrynte trafikun në hyrje dhe do të ndihmonte në zgjerimin e Bashkisë në drejtim të Veriut, ku ka dhe plazhe të tjera.
Rruga që lidh Sarandën me Butrintin nëpërmjet Ksamilit është rregulluar dhe është në gjendje të mirë. Kjo është një rrugë e Kategorisë C, SH81 me gjatësi 17km. Kjo rrugë e rindërtuar dhe sitemuar së fundmi duhet të përballojë trafikun turistik për të vizituar Butrintin, për të mundësuar lëvizjen për në liqenin e Butrintit për ata që merren me akuakulturë, si dhe për shfrytëzimin e plazheve të mrekullueshëm të Jonit në Ksamil, Manastir apo pika të tjera. Megjithatë segmente të saj janë tepër të ngushta dhe jashtë standarteve.

Rrjeti dytësor
Përsa i përket rrjetit dytësor të rrugëve në qytetin e Sarandës qytet, rrugët e brendshme ndërlidhese të lagjeve të qytetit janë në gjendje të keqe edhe për shkak të investimit për rrjetin e ujësjellës-kanalizime. Ka mungesë parkimi në qendër të qytetit si edhe në hyrje dhe në dalje të tij. Qyteti gjithashtu nuk ka terminal të automjeteve për udhetarët.
Rruga përgjatë bregut të detit nga hotel Butrinti deri në Çukë me rreth 3 km aktualisht është në rikonstruksion. Rikualifikimin dhe vitalizimin i qendrës së qytetit - Rr. Flamurit.
Sipas inventarit nga FSHZH mbi gjendjen e rrugëve përmendim si problematike segmentet rrugore:
Rruga Nr.1, Nr.2 Lëkurës - Kryqëzimi i Rrugës Nacionale 1.55 km
Rruga Nr.1 Unaza Mbi Port - Ish Fabrika 0.70 km
Qyteti i Sarandës ka 5 rrugë paralele me detin që lidhin rrugën hyrëse me pjesën veriore të qytetit duke krijuar dhe unaza në nivele të ndryshme skemike. Shumica e tyre janë me 1 kalim për të lehtësuar qarkullimin dhe problematike mbetet zgjidhja e ndërimit të parkingjeve.
Rruga që lidh portin e qytetit me Portin e Limionit rreth 2 km është ndërtuar rishtas. Rruga është me dy kalime dhe me trotuar në të sy krahët por gjërësia e tyre është e limituar prej ndërtimeve dhe janë jashtë standartit.

Metoq
Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të madh të automjeteve veçanërisht gjatë sezonit të verës. Ato janë në gjendje të keqe dhe me dëmtime. Përkatësisht si të tilla radhisim segmentet rrugore:
- Metoq - Fitore - Aliko 5.70 km
- Pllakë - Çukë 11.50 km

Çukë
Rruga e Çukës shërben si unazë për qytetin dhe transporti urban për momentin bëhet nëpërmjet kësaj rruge Metoq-Çukë, duke ndihmuar në lehtësimin e trafikut përgjatë bregut. Kjo është rrugë e kategorisë C me dy korsi me gjatësi 6 km. Në zonat informale kemi mungesë rrugësh.

Gjashtë
Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të vogel të automjeteve.Ato janë në gjendje

të keqe dhe me dëmtime.

Shelegar

Rrugët e fshatit klasifikohen si rrugë me qarkullim të vogël të automjeteve.Ato janë në gjendje të keqe dhe me dëmtime.

Njësia administrative Ksamil

Në këtë njësi kalon rruga nacionale Sarandë-Butrint (rruga Butrintit) që përbën dhe boshtin kryesor për zhvillimin e tij. Kasamili është një vendbanim i ri që pas viteve 1990 është zhvilluar si vend pushimi dhe sot përbën për nga rëndësia, qendrën urbane të dytë pas Sarandës në Bashki. Në këtë zonë në perëndim të aksit që të çon në fasadën e bregdetit shquhen tre seksione.

Në veri, në hyrje të vendbanimit me fasadë kryesore rrugën Butrinti dhe shtrirje ne thellësi 150-200 m në kodër.

Ekziston një konfiguracion i ri me rrugë për këmbësorë dhe biçikleta në fasadën e bregdetit me zgjerim në hapësirat publike në hyrje të vendbanimit, në të cilën një gji i vogël i mbyllur krijon një plazh privat që shfrytëzohet nga një hotel.

Seksioni i mesëm përfshin pjesën më të vjeter të vendbanimit me godina të shpërndara, shumëkatëshe dhe të vjetra (të ndërtuara para viteve 1990) ndërsa në shumicën dërmuese ekzistojnë ndërtesa të reja që përdoren si banesa, dhoma me qera dhe hotele si në fasadën e bregdetit ashtu dhe në brendësi. Ka dhe mjaft ndërtime të papërfunduara. Karakteristikë e zhvillimit janë strukturat informale, rrjeti rrugor elementar dhe mjaft ambjente dhe banesa private të mbyllura.

Më në jug në seksionin e tretë të kësaj zone, zgjerimet shtrihen në faqet e kodrës deri në këmbët e malit Bajame dhe në luginën Almiros, me godina që përdoren si shtëpi banimi, mjaft ndërtesa bujqësore, me oborre, kopshte dhe kafshë shtëpiake, ndërsa me fasade kundrejt bregdetit gjenden hotelet e vogla dhe ambjentet argëtuese. Ekziston mundësia e aksesit të lirë në zonën e bregdetit. Megjithatë, disa pika të bregdetit janë të paarritshme për shkak të terrenit shkëmbor por gjithsesi paraqesin interes për shkak të pejzazhit natyror, me pyje të dendura me ullinj që arrijnë deri në nivel të detit dhe sipërfaqe të mbuluara me shkurre dhe bime të ulëta karakteristike mesdhetare (makia). Shtrirja e këtij seksioni deri ne aksin qendror të rrugës,është strukturë informale, me rrjet rrugor elementar dhe mjaft prona private me pamje të mbyllur.

Rivitalizimi i qendrave urbane të bashkisë Sarandë

Rivitalizimi i qendrave urbane do të realizohet nëpërmjet një seri projektesh të propozuara të cilat synojnë aksesueshmërinë, lëvizshmërinë, rijetëzimin në pjesë të braktisura të qytetit dhe zgjerimin e shëtitores në pjesën urbane të bregdetit.

- Zgjerimi i shëtitores në pjesën urbane të bregdetit me 600 m duke vazhduar në jug të hotelit të Butrintit.
- Brandimin e Sarandës, si qyteti i luleve me krijimin e kopshteve të vegjël publike dhe kopshteve mbi çatitë.
- Transformimi i fabrikës së vjetër të miellit pranë portit në qendra kulturore me ekspozita dhe biblioteka.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Krijimi i një poli rekreativ argëtues në portin e peshkimit duke ripërdorur ndërtesat e braktisura.
- Zhvillimi i amfiteatrit për organizimin e koncerteve në parkun e ri bregdetar
- Zhvillimi i një shëtitore publike me funksione rekreative, nga plazhi Mango - kanali i Çukës.
- Krijimi i rrugëve karakteristike në qendrën historike të Sarandës.
- Revitalizimi i shakllarëve dhe ndërtesave karakteristike përgjatë rrugës nr.3.
- Përmirësimi i zonës së Manastirit në Sarandë

Udhëzime për infrastriukturën e sistemit rrugor

- Përfundimi i aksit të 5-të rrugor, sektori deri në portin tregtar, Sarandë
- Zgjerimi i rrugës në hyrje të qytetit Sarandë
- Zgjatja e segmenteve rrugore panoramike kryesore të Rivieres nga Kanali i Çukës deri në Ksamil –Butrint
- Për vendbanimet (Metoq, Shelegur, Cukë, Manastir) është i nevojshëm përmirësimi i rrjetit rrugor (asfaltimin e rrugëve, zgjerimin e rrjetit rrugor dytësor)
- Zgjerimi i infrastuktures rrugore për këmbësorët në qytetin Sarandë
- Përmirësimi i qasjes në bregdet, krijimi i aksesueshmërisë publike në plazhet e Limionit
- Përmirësimi i aksit «Sunset Strip" (Idriz Altima) duke ripërdorur strukturat e braktisura për përdorime urbane
- Përmiresimi i trotuareve në aksin Sunset Strip
- Zhvillimi i një rrjeti për këmbësorët nga porti e deri në stadium përgjatë bulevardit "Sunset"
- Krijimi i një rruge për çiklistët nga Saranda në Ksamil si dhe përreth gadishullit të Ksamilit (8 km)
- Krijimi i një shtegu për këmbësorë që lidh Eko - Park me Manastirin e 40 Shenjtorëve dhe Kalane e Lekurësit (1.5 km)
- Zhillimi i Eko-Park-ut
- Përmirësimi i mjedisit urban dhe tipareve karakteristike për fshatrat e Sarandës
- Përmirësimi i mjedisit urban dhe tipareve karakteristike për fshatrat e Sarandës
- Menaxhimi i integruar i plazheve përgjatë gadishullit të Limionit - sigurimi i aksesit publik
- Riorganizimi dhe rregullimi i infrastrukturës së rrugëve për qytezën e Ksamilit
- Asfaltimi i rrugëve dytësore Ksamil

3.2 Rrjeti i propozuar i infrastrukturës së shërbimeve publike

Shumica e sistemeve të infrastrukturës (ujë, energji elektrike, kanalizime dhe telekomunikacioni), do të vendosen nën sipërfaqen e tokës dhe do të jenë të sistemuara në një korridor qendror infrastrukture, përgjatë zonës urbane dhe në drejtim të rrugëve. Edhe pse sistemet do të jenë të vendosura në korridorin qendror të infrastrukturës, çdo sistem do të qëndrojë më vete brenda korridorit dhe nuk do të pengohet apo të nderpritet nga një sistem tjetër - si p.sh.., kullimi dhe kanalizimet të rrjedhin së bashku, sikurse mund të jetë rasti në disa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

fshatra sot. Kjo do të sigurojë funksionim të mirë dhe efikas të sistemit dhe do të lehtesojë mirëmbajtjen dhe punimet riparuese.

Në lagjet e qytetit do të bëhen zgjerime me degëzime përpendikulare në drejtim të lagjeve. Lidhjet me rrjetin duhet të bëhen në korridoret sekondarë më të afërt të linjës kryesore qendrore. Monitorimi i rregullt i cilësisë së ujit të pijshëm, të parametrave kimike dhe mikrobiologjike duhet të bëhet në vazhdimësi në stacionet e pompimit, si edhe në pikat fundore të çdo degëzimi sekondar.

Relievi i Sarandës është faktor përcaktues për *sistemin e kullimit* të gjithe zonës. Në zonat e vendosura në shpate kodrash, kryesisht të ndodhura në zonën veri-perëndimore të qytetit, graviteti dhe forma natyrore e shpatit do të përdoret për kullimin dhe furnizimin me ujë. Në zonat fushore të qytetit dhe në veçanti në zonat e identifikuara me rrezik për përmbytje, infrastruktura kulluese duhet të vendoset në thellësi, nën sipërfaqe për të parandaluar çdo përmbytje të zonave të ulta.

Me studimin e Sarandës, Bashkia do të mund të realizojë rehabilitimin e sistemit të kanalizimeve ekzistuese, sikurse zgjerimin e rrjetit në mënyrë që të lidhë të gjitha zonat e banuara me rrjetin kryesor të kanalizimeve. Trajtimi i sotëm mekanik i ujërave të ndotura duhet të mbyllet/përmirësohet dhe trajtimi i kombinuar mekaniko - biologjik duhet të ndërtohet.



Figura 13 Prerje tërthore e infrastrukturës në rrugët këmbësore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Sistemi i kanalizimeve

Sistemi i kanalizimeve do të ndjekë aksin qendror të infrastrukturës. Kanalizimet do të orientohen jashtë qytetit për në impiantin e trajtimit të qytetit vendosur në Çukë . Për ndërtimet e reja (dhe infomale) ata do të lidhen në zgjerimet e rrjetit grumbullues sekondar dhe terciar, ndërsa gropat ekzistuese septike duhet të monitorohen/rehabilitohen/mbyllen në mënyrë që të shmanget ndotja e tokës dhe e ujërave nëntokësore. Meqënese kjo do të kërkojë investime të mëdha, është propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit të përqendruar në çështje të

rëndësishme institucionale dhe parametrave të cilësisë (p.sh. marrja e mostrave në rrjet, në vendin dhe në kohën e duhur për CSB, E.coli, etj). Në këtë mënyrë mund të arrihet me zbutjen e situatës së tanishme.

Energjia elektrike dhe telekomunikacioni

Kabllot duhet të vendosen në një kanal në njërën anë të rrugës në mënyrë të rregullt. Tubat ujore (të kullimit, kanalizimeve dhe të furnizimit me ujë), duhet të kalojnë në anën e kundërt. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen pranë sipërfaqes (për të parandaluar kontaminimin e mundshëm nga ujërat e ndotura urbane dhe ato të kanalizimeve), tubat për ujërat e ndotura urbane/industriale në mes dhe kanalizimi më poshtë.

3.2.1 Rrjeti i propozuar i furnizimit me ujë

Zgjidhja më e mirë për infrastrukturën ujore duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro - ekonomike afatgjatë të burimeve të ujit, duke marrë parasysh të gjitha burimet sipërfaqësore dhe të ujërave nëntokësore si nga pikëpamja sasiore ashtu dhe nga ajo cilësore. Kjo punë tashme ka filluar me Studimin e Fizibilitetit mbi Burimet Ujore në jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), të cilat mbulojnë të gjithë zonën në jug, nga qyteti i Vlorës në Sarandë. Meqënëse investimet afatgjata duan kohë dhe vlera të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet infrastrukturore aktuale afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë, për të mbuluar sa më shumë të jetë e mundur zonat e populluara.

Vlerësimet e kushteve hidrogjeologjike dhe hidrologjike

Vlerësimi i rrjetit hidrografik dhe burimeve nëntokësore të ujit në zonë, i kapaciteteve të tyre dhe mundësitë për projekte në perspektivë të zhvillimit të infrastrukturës ujore, janë bazuar në studimet ekzistuese, si edhe në disa studime të ndërmarra rishtazi në zonë.

Situata hidrologjike

Zona e studimit përshkohet nga një numër rrjedhash ujore, ku më i rëndësishmi është *Uji*, i cili merret nga burimi i Navaricës, që ndodhet rreth 13 km nga Saranda me kapacitet 120 l / sek.. Ujëmbledhësi (puset) i Vrioni lidhet me linjën e transmetimit te Navaricës në afërsi të ujëmbledhësit dhe në këtë mënyrë furnizon edhe rezervuarin në Qafën e Gjashtës.

Rezervat e ujërave nëntokësore

Kushtet hidro-gjeologjike varen nga struktura gjeologjike dhe morfologjike e zonës bregdetare. Ekzistojnë burime natyrore të shumta ujore, me sasi uji të kufizuar pothuajse në të gjithë zonën e studimit. Ujërat janë të një cilësie shumë të mirë. Këto burime kanë një origjinë karstike dhe dalin në nivele të ndryshme hipsometrike. Tre puse të thellë te Vrionit qe përbëjnë një kapacitet total prej rreth 225 l/ sek. t).

Bazuar nga sa u përmend më sipër, mund të thuhet se shfrytëzimi i burimeve ujore në zonën e studimit (bashkia e Sarandës) nuk janë perdorur mjaftueshmërit për të përmbushur kërkesat për

ujë, që rrjedhin nga një konsumim në rritje të tij në të ardhmen, duke pasur parasysh kërkesat në rritje nga zhvillimi i turizmit.

Konsulenti mendon se shërbimet definitive të furnizimit me ujë në zonën e projektit duhet të zgjidhen në një fokus më të gjerë hapësinor, ekonomik dhe teknik dhe jo duke u përqendruar në çdo njësi në veçanti. Zgjidhjet e veçanta dhe lokale duhet të mbështeten dhe të zbatohen, duke ju referuar zgjidhjes përfundimtare të të gjithë territorit të bashkisë Sarandë, ose edhe më gjerë, gjithmonë nëpërmjet studimeve të thella dhe të detajuara të burimeve ujore, jo vetëm në zonën e bashkisë Sarandë, por edhe në nivel rajonal duke u lidhur me burimet e Konispolit. Ky koncept do të çojë në përdorimin më të mirë të mundshëm të pasurive ujore për zhvillimin e duhur perspektiv të këtij territori.
Uji i nxjerrë nga puset e cekëta shtetërore dhe private të hapura, është shpesh i ndotur për shkak edhe të efekteve infiltruese të ujërave të zeza, duke bërë që direktivat përkatëse të BE-/778/EEC dhe 98/83/EEC të mos jenë plotësuar deri me sot. Kjo situatë rrezikon drejtpërdrejtë dhe në vazhdimësi shëndetin e njeriut, prandaj kërkon t'i jepet prioritet i lartë kapërcimit të këtij problemi.

Mundësite e furnizimit me ujë- Furnizimi i kombinuar
Ky opsion i referohet propozimit të konsideruar më të përshtatshëm në studimine parafizibilitetit mbi "Burimet Ujore në Jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), i cili sugjeron përdorimin e:

- Pellgut ujëmbajtës të Vrionit;
- Burimin e Navaricës;

Këto janë disa mundësi, por zgjidhja më e mirë e mundshme e furnizimit me ujë duhet të bazohet në studime më të detajuara teknike makro-ekonomike afatgjata të burimeve ujore. Kjo punë ka filluar me studimin e para-fizibilitetit mbi "Burimet Ujore në Jug të Shqipërisë (DFAA-MPP & T), e cila trajton të gjithë zonën jug-perëndimore nga qyteti i Vlorës deri në Sarandë. Meqënëse zona e projektit për bashkinë e Sarandes është pjesë e bregdetit jugor shqiptar, të gjitha ndërhyrjet aktuale në rrjetin e furnizimit me ujë duhet të marrin në konsideratë, ndërhyrjet e planifikuara në shërbimin e furnizimit me ujë të studimit të mësipërm. Duke qene se investimet afatgjata kërkojnë kohë dhe sasi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme që investimet afatshkurtra dhe afatmesme të fokusohen në zgjerimin e rrjetit shpërndarës ekzistues të ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur territore të populluara.

Sikurse u përmend edhe më sipër kjo do të arrihet nëpërmjet investimeve të konsiderueshme. Aktualisht duhet propozuar një zbatim gradual i sistemit të monitorimit, duke u përqendruar në çështje të rëndësishme institucionale dhe atyre të parametrave të cilësisë së ujit (p.sh. përcaktimit të vendeve dhe kohës për marrjen mostrave të ujit, CSB, E.coli). Në këtë mënyrë mund të zbutet pakënaqësia për cilësinë e shërbimit të furnizimit me ujë.
Ka disa burime të ujit në zonën e burimeve natyrore me ujë të ujëmbajtësve të ndryshëm. Të gjitha ato kanë sasi të tyre (të qëndrueshme ose të ndryshueshme gjatë vitit), të cilësisë dhe të vendndodhjes. Duke marrë parasysh dhe kombinim e secilës prej tyre me rezultat në skenarë të ndryshëm, për përmirësimin e zgjidhjes së shkurtër/afatgjatë për këtë çështje të rëndësishme,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANE

veçanërisht në zonën e bashkisë së Sarandës, me vlera të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit. Detyra kryesore e pushtetit lokal në infrastrukturën e ujit është që të fokusohet në:

(a) përmirësimin e situatave ekzistuese (afatshkurtër);

(b) përgatitja e zgjidhjes përfundimtare lokale apo rajonale (afatgjatë);

Natyrisht mënyra e sipërmendur do të varej nga mbështetja financiare dhe institucionale, si edhe bashkëpunimi në nivel qendror dhe lokal. Krahas perspektivës se furnizimit me ujë, Bashkia duhet të jetë e përqendruar në përmirësimin e gjendjes ekzistuese, përmes:

i. Kontrollit dhe furnizimit me cilësinë e ujit (p.sh. përcaktimin e vendndodhjes dhe kohës për marrjen e mostrave të ujit, CSB, E.coli);
ii. Zgjerimit dhe furnizimit me ujë dhe rrjetin ekzisues të kanalizimeve për të mbuluar shtëpitë e reja;
iii. Eliminimin e të gjitha rrjedhjeve të ujit;
iv. Instalimi i matësave të ujit (ujëmatësve);
v. Përmirësimi i shpërndarjes së ujit;
vi. Rritja e masave të menjëherëshme për mbledhjen e taksës së ujit, për shërbimet e ujit, duke u përqëndruar në çështjet e rëndësishme institucionale dhe parametrat e cilësisë së ujit.

Infrastruktura e ujit të pijshëm

Kompania e furnizmit me ujë është UK Saranda, sh.a, furnizon qytetin por edhe Ksamilin. Kjo ndërmarrje furnizon qytetin por edhe Ksamilin. Megjithë investimet që po bëhen përseri rrjeti i ujësjellësit nuk mund të sigurojë furnizimin pa ndërprerje të Sarandës pasi prurja e ujit nga burimi është e pamjaftueshme. Qyteti i Sarandës ka dy burime ujore të furnizimit me ujë: Burimi i Navaricës, që ndodhet rreth 13 km në lindje të Sarandës dhe burimet e Vrionit.

Fshatrat Gjashtë, Metoq furnizohen me puse dhe me ngritje mekanike. Fshatrat Çukë dhe Shelegar furnizohen nga ujësjellësi i Çukës. Sot po investohet 6,624,889 Euro për rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit nga KFW për Sarandën dhe Ksamilin. Projekti ka filluar 1.03.2015 dhe përfundon 31.08.2016

Zgjidhja rajonale

Zgjidhja rajonale e cila do të fillojë nga stacioni i pompimit të ujit të Vrionit (250l/s), do të mbledhë burimet kryesore përgjatë rrugës në zonën ndërmjet Sarandës dhe Himarës, dhe burime të pjesës së Tatzatit (deri në 1000 l/s)-Syri Kaltër. Nga llogaritja rezulton, që burimet mund të furnizojnë me ujë zonën e bashkisë Sarandë nëpërmjet stacionit të pompimit të Vrionit dhe burimet me rënie të lirë.

Secila prej zgjidhjeve ka avantazhet dhe disavantazhet përkatëse, kështu që vetëm një ekip profesional, duke analizuar çdo opsion, jo vetëm gjate fazës se zbatimit, por edhe gjatë kostimit, dhe fazës së funksionimit dhe menaxhimit të këtyre shërbimeve, mund të vendosë për mundësinë e zbatimit të këtij projekti. Zgjidhjet e rrjeteve përkatëse janë treguar në hartën e infrastrukturës te propozuar bashkisë Sarandë +Hartë

Ndërhyrjet specifike për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për çdo njësi do të jenë si më poshtë:

Njesia administratine Sarandë

Sarandë

- Krijimi i opsioneve alternative të furnizimit me ujë nga burimet e "Tatëzatit"ose "Syrit të kaltërt`
- Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë në zonën periurbane të vendbanimeve të Sarandës
- Zëvedësimi i tubacionit të ujit nga stacioni i pompimit Vrion-Rezervuari i Qytetit
- Përmirësimi i furnizimit me ujë në vendbanimet informale përreth qytetit të Sarandës
- Përmirësimin e administrimit të ujit dhe reduktimin e humbjeve teknike.
- *Metoq*
- Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë për të mbuluar të gjithë popullsinë. Shtimi i depove.
- *Çukë*
- Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë për të mbuluar të gjithë popullsinë. Shtim i depove.
- *Gjashtë*
- Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë për të mbuluar të gjithë popullsinë. Shtimi i depove. Përmirësimi i furnizimit me ujë në vendbanimet informale
- *Shelegar*
- Përmirësimi i furnizimit me ujë i zonës së sipërme të fshatit

Njesia administratine Ksamil

Fshati Ksamil

- Zgjerimi i rrjetit të furnizimit me ujë për të mbuluar të gjithë popullsinë. Shtim i depove. Përmirësimi i furnizimit me ujë në vendbanimet informale.

3.2.2 Rrjeti i propozuar i kanalizimeve

Në lidhje me sistemin e kanalizimeve, me një projekt të mëparshem është bërë e mundur mbledhja e ujërave të zeza për trajtim në impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura në qytetin e Sarandës. Ky impiant mbledh ujërat e ndotura të zonave Sarandë dhe Ksamil, është projektuar për një popullsi prej 70.000 banorë dhe ka një kapacitet prej 12240 m3/ditë. Po punohet për një projekt për sistemimin e ujërave të zeza, zona hotel Butrinti deri te kanali i Çukës i cili ka filluar në dhjetor 2015 me një vlerë 120,145,961 lekë. Zona e Limionit duke qenë nën kuotë ka nevojë për energji për të ngritur ujerat e zeza mekanikisht drejt impiantit të derdhjes së ujërave të zeza.

Impianti i tajtimit të ujrave të zeza është parashikuar në zonën e Çukës (80l/s). Mbledhja e ujërave të ndotura të zonave të Sarandës dhe Ksamilit do të kryhet nëpërmjet stacioneve të pompimit. Në zonën e Ksamilit propozohet krijimi i vaskave të grumbullimit të ujrave të ndotura, të cilat më pas nëpërmjet stacionit të pompimit do të kalojnë në impiantin e trajtimit në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Çukë.

Ndërhyrjet specifike për trajtimin e ujrave të ndotura për çdo njësi do të jenë si më poshtë:



Harta 19 (19a) - Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Njësia administratine Sarandë

Sarandë

- Rikonstruksioni i infrastrukturës së ujërave të ndotur në zonën urbane dhe atë informale të Sarandës
- Përmirësimi i ujërave të zeza dhe të ujërave të ndotura në qytetin e Sarandës.
- Kontrolli i kushteve teknike të gropave septike. Për shtëpitë e shkëputura, lidhja me rrjetin e ri të kolektorit ose sigurimi i një zgjidhje trajtimi të veçantë (impiant trajtimi të parafabrikuar kompakt ose gropa septike), sipas rasteve individuale.
- Përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve në qytet H. Butrinti-Kanali Çukës.
- Pastrimi i plazheve dhe kontrolli i cilësisë së ujit të detit (programi flamujt blu).
- Planifikimi i impianteve sanitare për pushuesit në bregdetin e Sarandës:
  - (i) Tualet publik të lidhur me rrjetin e kolektorëve lokalë;
  - (ii) Tualet publik trajtimi të parafabrikuar.

Metoq

- Fshati nuk i ka të rregulluara kanalizimet e ujërave te zeza, por funksionojnë me gropa septike. Propozohet përmirësimi dhe shtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza duke u lidhur me impiantin e trajtimit në Çukë.

Çukë

- Impianti i trajtimit të ujërave të zeza ka filluar ndërtimin e tij në zonën e Çukës.

Gjashtë

- Fshati nuk i ka të rregulluara kanalizimet e ujërave të zeza por funksionojnë me gropa septike. Propozohet përmirësimi dhe shtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza duke u lidhur me impiantin e trajtimit në Çukë.

Shelegur

- Fshati nuk i ka të rregulluara kanalizimet e ujërave të zeza, por funksionojnë me gropa septike.

Njësia administratine Ksamil

Ksamili

Në këtë njësi është nëproces ndërtimi i rrjetit mbledhës të ujërave të zeza dhe krijimi i vaskave të grumbullimit të ujrave të ndotura, të cilat më pas nëpërmjet stacionit të pompimit do të kalojnë në impiantin e trajtimit në Çukë.

- Planifikimi i impianteve sanitare për pushuesit:
  - (i) Tualet publik të lidhur me rrjetin e kolektorëve lokalë:
  - (ii) Tualet publik trajtimi të parafabrikuar.

Projektet e infrastrukturës ujore dhe kanalizimeve në vendbanimet e bashkisë Sarandë, përshkruhen në listën e projekteve, të grupuaranë katër lloje të ndërhyrjeve të nevojshme (si më poshtë). Projektet specifike do të bazohen në studimet e fizibilitetit përkatëse, sipas kushteve të vendbanimeve.

Tipi i ndërhyrjes së nevojshme të kërkuar:

1. Zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet ekzistuese për të mbuluar të gjithë zonën e populluar/sigurimin e impiantëve të trajtimit për çdo njësi banimi, në funksion të kushteve;
2. Ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura: (i) Të veçantë për çdo zonë ose (ii) impiant trajtimi të përbashkët me zonën bashkëngjitur.
3. Ndërtimi i objekteve sanitare turistike në afërsi të plazhit, tualet publik lidhur me impiantin e trajtimit më të afërt, (ii) impiant kompakt i ndarë.
4. Ndërtimin e impiantëve kompakt të parafabrikuar ose gropave septike të rregullta për shtëpitë e veçuara.

Në fazën e dytë të trajtimit radikal duhet të realizohet rehabilitimit, kontrollit, ose heqja e gropave septike në afërsitë objekteve ujore/stacioneve të pompimit dhe respektimin e standarteve të funksionimit dhe menaxhimit të mbetjeve të tyre. Në çdo rast duhet të ekzistojë monitorimi sistematik i cilësisë së ujërave nëntokësorë dhe atij në rrjetin e furnizimit. Monitorimi i rregullt dhe permanent i parametrave kimikë dhe mikrobiologjikë për cilësinë e ujit të pijshëm duhet të respektohet dhe zbatohet.

Udhëzues për projektet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet

A. Faza e projektim/planifikimit:

- Duhet bërë një studim kompleks (ekonomik, hidrogjeologjik, social), që të ofrojë më shumë se një alternativë. Më i miri duhet të zgjidhet bazuar në:
  - koston;
  - mundësitë e financimit;
  - kohës së zbatimit;
  - kostove të funksionimit;
  - teknologjisë;
  - fleksibilitetit të funksionimit të rrjetit, etj.
- Zbatimi në faza i planit, sipas burimeve të financimit.
- Ndarjen e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në seksione, bazuar në njësitë hidraulike (burim, puse, vepërmarrje);
- Disa fshatra të bashkisë së Himarës mund të kenë rrjete të përbashkëta kolektorësh të ujërave të zeza, në varësi të kushteve duke bërë vlerësime për çdo rast dhe sigurisht i realizuar/zbatuar në faza.

B. Faza e zbatimit:

- Të gjitha projektet parciale duhet të marrin në konsideratë studimin afatgjatë dhe rajonal të furnizimit me ujë.
- Monitorim të rregullt të cilësisë së ujit të pijshëm nëpërmjet analizave kimike dhe bakteriologjike (sipas kritereve të Këshillit të Evropës).
- Shpërndarje dhe menaxhim sa më të mirë të ujit për një funksionim sa më të mirë të sistemit;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

Duke ditur që investimet afatgjata kërkojnë kohë dhe sasi të konsiderueshme financiare, është e rëndësishme, që *investimet afatshkurtra dhe afatmesme në infrastrukturë të jenë të fokusuara në zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit për të mbuluar sa më shumë që të jetë e mundur zona të banuara.*

Përmirësimi i gjendjes aktuale duhet të ndjekë aktivitetet/projektet e mëposhtme:

- Detajimi i një programi investimesh në bazë të vlerësimit realist të kostove përkatëse.
- Përmirësimi i shpejtë afatshkurtër që mund të zbatohet deri në tre vjet, për të minimizuar ndryshimin midis nevojës/kërkesës për ujë dhe pasurisë ujore të zonës, *e financuar nga qeveria qendrore/lokale;*
- Hartimi i një plani infrastrukturor afatmesëm dhe afatgjatë, që mund të plotësojë nevojat për ujë familjar, industrial, tregtar dhe atë të sektorit të turizmit, të *financuar nga qeveria qendrore ose donatorët;*
- Formulimi dhe miratimin i një rregulloreje për trajtimin e ujërave të ndotura për shërbimet e reja, hotelet dhe apartamentet (*për më shumë se 20 shtretër/persona)* për:
  - ndërtimin nga ana e tyre të impiantëve biologjikë të trajtimit të ujërave të ndotura;
  - funksionimin e tyre nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e inspektoratit publik të Bashkisë;
  - ujërat e mbetura pas trajtimit të derdhen në përrenj ose të filtrohen në tokë pa efekte ndotëse;
  - të organizohet në mënyrë permanente largimi i mbetjeve fekale sipas një rregulloreje përkatëse, e monitoruar gjithmonë nga inspektorati bashkiak.
  - Për hotelet/shtëpitë "BB" apo dhomat me qera, me më pak se *20 shtretër* duhet të formulohet dhe miratohet një rregullore për:
  - ndërtimin e impiantit të tyre bashkëkohor të trajtimit të ujërave /gropa septike pa efekte mjedisore;
  - pastrimin/shkarkimin permanent të gropave septike individualisht apo të organizuara nga Bashkia (kundrejt një takse të caktuar);
  - organizimin e derdhjeve të këtyre gropave në një rrjedhë të përcaktuar/kanal;
- kontrollin, rehabilitimin ose mbylljen e gropave septike në afërsi të burimeve ujore apo stacioneve të pompimit;
- zbatimin e standardeve për funksionimin dhe menaxhimin e mbetjeve.
- Në çdo rast duhet të ketë kontroll sistematik të cilësisë së ujërave në rrjetin e furnizimit me ujë.

Konceptimi i kostos për projektet e propozuara

Për furnizimin me ujë

Kostoja e projekteve të veçanta do të kërkojë një studim rajonal të fizibilitetit dhe do t'i referohet *zgjidhjes dhe teknologjisë përkatëse*, e pranuar nga qeveria dhe pushteti vendor.

Kostoja në vetvete është funksion i:

a) numrit të popullsisë që do t'i shërbejë;
b) kërkesës specifike për ujë;
c) relievit të zonës;
d) teknologjisë dhe materialit të përdorur;
e) pronësisë mbi tokën, etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Në stadin e këtij studimi, bazuar dhe në informacionin që disponojmë mund të themi se, sikurse u përmënd edhe në raport, Konsulenti është i mendimit për një zgjidhje rajonale të furnizimit me ujë dhe atij të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura. Për një vlerësim të shpejtë mund të merren në konsideratë kostot aktuale të përafërta për këto lloje punimesh si:

i. Kosto për furnizim për vendosjen e tubacionit DN nga 150 - 900 në 330-350 Euro/m;
ii. Kosto njësi për rezervuarët me kapacitet 1000 m³ deri 170.000 - 200.000 Euro.

Kostoja progresive duhet të marrë në konsideratë koston e veprës së marrjes, stacionet e pompimit dhe puseve, të cilat të gjitha së bashku formulojnë koston e projektit për çdo projekt të furnizimit me ujë.
Për ujërat e ndotura: për projektet e largimit dhe të përpunimit të ujërave të zeza, kostoja e projekteve të veçanta do të kërkojë një studim rajonal të fizibilitetit për mundësitë e zgjidhjes për çdo zonë të bashkisë së Sarandës. Ajo do të jetë në varësi të *zgjidhjes së propozuar dhe teknologjisë së përdorur*, të pranuara nga Qeveria dhe pushteti lokal.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA



Harta 20 (19b) -Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

3.2.3 Rrjeti i energjisë elektrike dhe telekomunikacioni

Shpërndarja e energjisë tashmë është nën administrimin e kompanisë OSHEE. Për përmirësimin e shërbimeve të ofruara në zonën e projektit, janë planifikuar investime specifike, që konsistojnë në përmirësimin dhe furnizimin nëpërmjet projekteve rajonale. Sipas informacionit të marrë nga zyra përgjegjëse për funksionimin e sistemit të furnizimit me energji, në pjesën jugore të zonës së studimit (përfshirë të gjitha vendbanimet nga Vlora në Sarandë), ndërhyrja e fundit ka si qëllim reduktimin e humbjeve dhe përmbushjen e kërkesave deri në 50 vitet e ardhshme. Projekti përbëhet nga:

- Modifikimi i karakteristikave teknike në shpërndarje (ndarjen e dy linjave të tensionit të lartë nga 35 në 110 kV);
- Modifikimi i voltazhit të mesëm nga 10 KV në 20 kV;
- Modifikimi i duhur i nënstacioneve;
- Rehabilitimi i rrjetit të tensionit të ulët.

Në këtë kuadër është ndërmarrë modifikimi i veçorive teknike të shpërndarjes (ndërtimi i dy linjave të tensionit të lartë nga 35 deri në 110 kV dhe të tensionit të mesëm nga 10 deri në 20 kV si dhe modifikimi i stacioneve).

Mundësia e furnizimit të Zonës Jugore, krijohet nëpërmjet fluksit të fuqisë që futet nga nënstacioni 400/110 kV i Zëmblakut. Për pasojë reduktohet fluksi i fuqisë që vjen nga linjat e largëta të rrjetit 220 kV, duke balancuar më mirë edhe vet unazën 220 kV të Jugut, që përbën një problem për sigurinë e furnizimit të një zonë të gjerë.Ndërkohë në fazë po bëhet ndërtimi i dy n/st 110 kV në zonën e bregut të detit Jon: Orikum dhe Himarë.

Telekomunikacioni

Zhvillimi i infrastrukturës së telekomunikacionit nuk është aspak një faktor kufizues për zhvillimin e rajonit. Sapo të fillojnë proceset e zhvillimit, infrastruktura e telekomunikacionit do të zgjerohet dhe do të përmirësohet për të përballuar kërkesat shtesë. Albtelekomi ka realizuar projekte, në mënyrë që të fusë shërbime të reja përveç telefonit, të tilla si interneti ne shpejtë dhe televizionin kabllor. Për këtë arsye është e nevojshme të ndryshojë teknologjia ekzistuese e rrjetit, me qëllim zgjerimin e përdorimit të fibrave optike. Qëllimi është që të zvogëlojë gjatësinë mesatare të linjave.

Aktualisht ka një mbulim shumë të kufizuar nga sistemi i AlbTelekom. Ky operator është në gjendje të mbulojë një pjesë të madhe të territorit të vetëm me telefoninë valore. Përdorimi i kabllove optike për internet dhe shërbime të tjera në gjendjen e tanishme mbulohen nga operatorë të fuqishëm mobile si T-Mobile, Vodafone, Eagle.

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA



Harta 21 (19d) - Rrjeti i furnizimit me energji të propozuar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË

3.2.4 Menaxhimi i mbetjeve urbane

Mbetjet përpunohen në landfillin e Bajkaj. Ky Landfill i shërben bashkive të Delvinës, Sarandës, Himarës. I ndërtuar në një zonë kodrinore me lartësi rreth 150 m mbi nivelin e detit, në një sipërfaqe prej 12 ha, landfilli do të ketë një kapacitet përpunues ditor prej 140 ton mbetje dhe kapaciteti depozitues në total është për 365.000 m3 mbetje për një periudhë shfrytëzimi prej 25 vitesh. Ai ndodhet afërsisht 12 km në veri të qytetit të Sarandës, në distancë 1,5 km nga fshati Bajkaj dhe 1,4 km nga fshati Palavli.

Sasia vjetore e mbetjeve të ngurta (shtëpiake) për bashkinë Sarandë është 10.000 ton.Vendosja e kolektorit të ujërave urbane të 2003 ka ulur dukshëm pjesën më të madhe të shkarkimeve të këtyre ujërave në Gjirin e Sarandës sidoqoftë shkaku kryesor i ndotjes me tregues bakterialë

janë: mosfunksionimi i duhur i impianteve të trajtimit të ujërave dhe shkarkimet urbane të patrajtuara. Evidentohet një mungesë e strukturave të mirëfillta mbledhëse dhe shkarkuese në shumë zona të banuara të Ksamilit.

3.2.5 Administrim mbetjesh dhe mbrojtja e mjedisit

Me zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe rritjes së agro-turizmit në zonë premisat janë për rritje të sasisë së mbetjeve dhe autoritet vendore duhet të synojnë një ulje të gjenerimit të tyre. Kjo mund të arrihet duke u bazuar në një numër të madh ligjesh dhe VKM-së (*Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"; Vendim nr. 705, datë 10.10.2012 " Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës";Vendim nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr. 178, datë 6.3.2012 " Për incinerimin e mbetjeve";Vendim nr. 452, datë 11.7.2012 "Për landfillet e mbetjeve"; Vendim nr. 765, datë 7.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura"; Vendim nr. 866, datë 4.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre"; Vendim nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike"; Vendim nr.117, datë 13.02.2013 "Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje; Vendim nr. 52 datë 5.2.2014 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.117, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret që përcaktojne kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje"; Vendim nr. 798, datë 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore"; Vendim nr. 229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit"; Vendim nr.371, datë 11.06.2014 "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre"; Vendim nr.418, datë 25.06.2014 " Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; Vendim nr.608, datë 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre";Vendim nr. 641, datë 01.10.2014 "Per miratimin e rregullave per eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit te mbetjeve jo te rrezikshme e të mbetjeve inerte" dhe ligjin për importin e mbetjeve 2016*) parimet e strategjisë kombëtare dhe ligjin mbi menaxhimin e mbetjeve si dhe duke zbatuar tri parimet e BE-së lidhur me reduktimin e sasisë së mbetjeve.

Parandalimi të krijimit të mbetjeve duke ndihmuar në riciklim dhe ripërdorim, duke përmirësuar grumbullimin final të mbetjeve.

Kjo qasje e re do të çojë në një përmirësim të gjendjes së mbetjeve në Bashki si dhe duke marrë masat specifike për të:

1. **Parandalimi i krijimit të mbetjeve**: Ky është një faktor kyç në strategjinë e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia duhet të synojë pakësimin e krijimit të sasisë së mbetjeve që në origjinë si dhe reduktimin e rrezikut që vjen prej tyre nga pakësimi i substancave të dëmshme, për pasojë edhe hedhja e grumbullimi i tyre do të jetë automatikisht më i thjeshtë.

2. **Ndihmë për industrinë e riciklimit**: Organizimi nga ana e Bashkisë i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, do të rrisë interesin e industrisë së riciklimit për grumbullimin dhe largimin e tyre nga zona.
3. **Përmirësimi hedhjes së mbetjeve dhe monitorimi**: Atje ku është e mundur, për mbetjet të cilat nuk mund të riciklohen dhe të ripërdoren ato duhet të dërgohen në incinerator dhe në mundësi të fundit në landfill. Të dyja këto mundësi kërkojnë një monitorim të kujdesshëm pasi mund të sjellin dëmtime serioze për mjedisin.
4. **Shmangie të hedhjes së mbetjeve** në det, në shtretërit e përrenjve dhe lumenjve, buzë rrugës apo në çdo vend tjetër jo të destinuar për hedhje mbetjesh. Një synim i menjëhershëm duhet të jetë monitorimi i aktivitetit të ndërtimit, industrive prodhuese dhe turizmit.

3.2.6 Administrimi i burimeve natyrore dhe kulturore

Kodrat në Sarandë mbeten aktualisht pa qasje dhe përfshirje në identitetin historik dhe turizmin kulturor të qytetit. Kjo qëndron pavarësisht nga fakti se në to janë të vendosura monumente të rëndësishme arkeologjike dhe pikat tërheqëse të trashëgimisë kulturore si Manastiri i Sarandës dhe kështjella e Lekursit.

Në këtë Projekt është propozuar përmirësimi i kushteve të përgjithshme të malit të Eremesit veçanërisht të kodrës së Germalit deri në lartësinë e Isoipsit 250m, me pasurim të bimësisë, prishjen e ndërtimeve pa leje, rehabilitimin dhe rikualifikimin e monumentit historik të Manastirit të Sarandës. Tek ky i fundit është krijuar dhe një pikë 'Belvedere' në lartësi prej 214 m në veri të manastirit. Ky administrim do të bëhet nga Ministria e kulturës në bashkëpunim me bashkinë Sarandë.

Një rrjet i rrugëve për ecje, lidh monumentin me qytetin e Sarandës dhe vendbanimin e Gjashtës dhe kalon më në jug në kodrën e Lëkursit, ku gjejmë kalanë e Sarandës. Kalaja do të restaurohet dhe do të transformohet në një zonë rekreative. Është propozuar përmirësimi i plotë i kodrës me një pasurim të bimësisë, prishjen e ndërtimeve pa leje dhe rikualifikimin monumentit. Këtu është krijuar një pikë 'Belvedere' në lartësi prej 238 m në jug të kështjellës.

Gjithashtu e një rëndësie tepër të veçantë është mirëmbajtja e zonave arkeologjike në qendër të qytetit, `A` dhe `B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Zonat e mbrojtura natyrore

Në territorin e bashkisë së Sarandës ndodhet një pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, për të cilin është miratuar Plan Menaxhimi. Zona e parkut kombëtar rregullohet me VKM-në 693 i 10.11.2005, **për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrinit "Park Kombëtar"**, ndryshuar me VKM-në 134 i 20.02.2013. VKM-ja nr. 134 mbi disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 693 për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit "Park Kombëtar" ka përcaktuar qartë dhe zonat strikte, duke i kategorizuar ato në A,B,C dhe nënzona. Ky park është i një rëndësije ndërkombëtare pasi përmbush kushtet e një zone RAMSAR dhe si i tillë kujdesi në ruajtjen e këtij ekosistemi ligatinor duhet të jetë i veçantë. Plani i menaxhimit saktëson dhe rregullat për secilën nga këto zona.

Parku realizon një ndarje të zonës mjedisore në 4 kategori të mbrojtura: A (Zona Qëndrore) B (Zona Rekreative) C (Zona e Përdorimit Tradicional) dhe D (Zona e zhvillimit të qëndrueshëm) me nënndarjet (A1, A2, B1, B2). Në secilën kategori, veprimtaritë e lejuara dhe ato që nuk plotësojnë kriteret janë të përcaktuara në planin e menaxhimit. Në parim kategoritë A përfaqësojnë zonën qëndrore të mbrojtjes së mjedisit, kategoritë B i referohen zhvillimit të turizmit dhe veprimtarive të tjera lehtësuese, përfshirë edhe qytetin e Ksamilit, kategoritë C përfshijnë aktivitete që lidhen me tokën e punueshme, peshkimin brenda liqenit të Butrintit dhe ekoturizmit dhe përjashton veprimtaritë me ndikim të madh mjedisor, kategoritë D përfaqësojnë zonat pa kufizime.

Parku Kombëtari Butrintit zë një zonë me bukuri natyrore të shquar. Marrëdhëniet simbiotike të bashkëekzistencës së njeriut me natyrën i japin një vlerë të veçantë dhe mjaft domethënëse pejzazhit të Butrintit nëkuptimin historik dhe atë arkeologjik. Pejzazhi është tejet i bukur me malet e larta dhe fushat e ulta, me kënetat, liqenet dhe bregdetin shkëmbor ranor/ baltor. Ndërhyrjet njerëzore janë ende në harmoni me natyrën dhe nuk e dominojnë atë. Burimet historike konfirmojnë rëndësinë e pyjeve të Butrintit për lëndë drusore, ndërtim anijesh dhe eksport. Ky park luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe konservimin e biodiversitetit, pasi këtu gjenden 16 lloje të rrezikuara të florës. Në territorin përreth kësaj Bashkie shtrihen edhe disa rezervate, si ai i pyllit të Butrintit, që janë të pasura në lloje por njëkohësisht shërbejnë edhe si një vend gjuetie mjaft i përshtatshëm për amatorët e këtij sporti. Pylli i Butrintit është mbetje e pyllit tipik mesdhetar, mjaft i shprehur me ilqe (Quercus ilics), rrënjë (Q. Robur), verri (Alnus glutinosa), vidh (Ulmus campestris), frashër (Fraxinus angustifolia), dafinë (Laurus nobilis), etj, të klasës (Qurcio-Ilics). Ky pyll është relativisht i ruajtur mirë në krahasim me situatën e pyjeve në vend. Pronësia e kullotave përgjatë brezit litoral bregdetar Bredeneshi-Ksamil-Stillo është ende e pa qartë.

Liqeni i Butrinti dhe ai i Bufit (Rrezes) është pronësi shtetërore. Liqeni i Butrintit është i një rëndësi ndërkombëtare dhe si i tillë kujdesi në ruajtjen e këtij ekosistemi ligatinor duhet të jetë i veçantë.
Ndotja e ujërave të lumit të Bistricës është një tjetër problem i nxehtë që lidhet me mungesën e kulturës qytetare. Në grykëderdhjen e tij, ku dhe lumi hyn në kufirin e Bashkisë vihen re mbetje të depozituara të kategorive të ndryshme si rezultat i prurjeve por edhe i hedhjes në mënyrë abusive

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Harta 22 (2f) - Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore

3.2.7 Mbrojtje kombëtare, civile dhe kundër zjarrit

Në kuadër të politikave për mbrojtjen e zonave të rrezikuara në bashkinë Sarandë, të cilat kryesisht i referohen rrezikut të dëmtimit nga zjarri, janë parashikuar një sërë objektivash dhe politikash për parandalimin dhe reduktimin e dëmit në zonat pyjore dhe të gjelbra.

Hapësira e pyllëzuar e bashkisë Sarandë është 282 ha ndërsa ajo e kullotave 530 ha. Për këtë është e domosdoshme nevoja e një monitorimi të rreptë dhe aplikimit të plotë të Ligjit për pyjet nr 9385/2005 ndryshuar me nr. 48/2016. Monitorimi i pyjeve është i domosdoshme për ti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

mbrojtur ato nga djegiet aksidentale si pasojë e praktikave të gabuara në zonë për djegien e kullotave apo për shkak të prerjes së drurëve për qëllim ngrohjeje. Zonat e mbrojtura janë të rrezikuara si pasojë e presioneve të zhvillimit në zonë. Dëmi që vjen nga djegiet dhe prerjet e druve nuk lidhet vetëm me pyjet por edhe me llojet e rralla dhe endemike që i përdorin ato si habitate.

Tabela 23 Monitorimi i pyjeve dhe zonave të mbrojtura dhe të gjelbra

Parime	Objektiva	Nga viti
Parandalimi i dëmtimit të kullotave dhe pyjeve	Reduktimi i dëmtimit 100%	2018
Hartimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura	Për zonat e reja të shpallura dhe përditësimi/rishikimi i planeve ekzistuese në masën 100%	2019
Shtimi i sipërfaqes së pyllëzuar	Rritje me10%	2020

Burimi: Ministria Mjedisi

3.3 Konsiderata mbi planet e niveleve të tjera dhe ndikimi i tyre mbi territor

Një element shume i rëndësishëm që plani merr në konsideratë, janë dhe dy dokumentat bazë ku përshkruhen zhvillimet e ardhshme të territorit si dhe zhvillimet strategjike të tij. Plani Kombëtar dhe PINS bregdeti. PINS bregdeti jep direktiva të rëndësishme, të cilat janë marrë në konsideratë në plan në lidhje me infrastrukturën rajonale dhe mënyrën e zhvillimit të transportit në zonat të ndryshme te bregdetit. Këto dokumente janë marrë në konsideratë gjithashtu për polet e zhvillimit në territorin në studim, duke përmendur polin bujqësor, ekonomik, energjitik etj. Gjithashtu elementet strategjike të impaktit kombëtar mbi gjithë territorin e vendit si, aeroport, hekurudhë, itinerare të ndryshme të lëvizjes turistike etj. Harta tregon lidhjen me rajonin që Bashkia siguron si shembull i planifikimit të infrastrukturës në nivel kombëtar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA



Figura 14 Drejtimet Zhvillimit per Sistemi Infrastrukturor të Bregdetit të Jugut sipas PINS Bregdeti

Burimi: AKPT

REPUBLIKA E SHQIPERISE · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT · TIRANE SEKRETARIA

3.4 Tipologjia dhe shpërndarja në territor e shërbimeve sociale

Organizimi dhe shpërndarja e mirë e objekteve arsimore, kujdesit shëndetësor, gjelbërimit, objekteve kulturore e sportive, jep një kontribut të madh për krijimin e zonave funksionale dhe tërheqëse urbane dhe rurale. Planifikimi ka për qëllim të sigurojë, që këto objekte të jenë të mjaftueshme dhe të arritshme. Në lidhje me shërbimet sociale, bashkia Sarandë ka nevojë për të përmbushur sfidat e një popullsie heterogjene. Megjithatë planifikimi i infrastrukturës sociale duhet të marrë në konsideratë një peshë të madhe të hierarkisë të dy qendrave të Bashkisë (Saranda qendër urbane kryesore dhe Ksamili si qendër lokale e specializuar).

Qëllimi kryesor është te sigurojë mundësinë e përmirësimit të shërbimit social të popullsisë, e cila është duke shërbyer si qendra e Sarandës (funksionale, ekonomike dhe varësia administrativenga bashkitë e tjera). Sikurse dihet një shërbim social i referohet nje grupi specifik të popullsisë ose vendi/zone të veçantë. Edukimi që i referohet banorëve të përhershëm të një zone, duhet të llogaritet në bazë të të dhënave aktuale të popullsisë. Në mënyrë të ngjashme objektet sportive i referohen kryesisht strukturës së një zone urbane (duke mos llogaritur sportet e ujit dhe ato që lidhen me turizmin dhe aktivitetet e kohës së lirë nuk llogariten). Nga ana tjetër, objektet e kujdesit shëndetësor duhet të mbulojnë sa më shumë të jetë e mundur nevojat e të gjithë territorit dhe popullsisë, konkretisht nevojat e popullsisë së përhershme gjatë gjithë vitit, por edhe të turistëve dhe vizitorëve, që kryesisht përqendrohen përgjatë zonave bregdetare dhe përkohësisht gjatë sezonit të verës. Në mënyrë të ngjashme, objektet kulturore i shërbejnë banorëve vendas, por shërbejnë në të njëjtën kohë si atraksione të rëndësishme për turistët dhe vizitorët e zonës.

Së fundmi, hapësirat e gjelbëra dhe të hapura, në kontekstin e hapësirave publike, parqeve dhe shëtitoreve, kryesisht i referohen zonave urbane të Sarandës dhe Ksamilit.
Në këtë kapitull nevojat për shërbimet sociale janë përcaktuar dhe llogaritur në bazë të standardeve dhe treguesve të VKM-së 671/2015. Metodologjia përfshin vlerësimin e tokës minimale të kërkuara dhe njësitë e qëndrueshme për të mbuluar nevojat e popullatës për shërbime sociale dhe infrastrukturë. Vlerësimi bazohet në programatikë / projektimi popullsisë të vitit 2031, sipas parashikimeve përkatëse të grupit planifikues, dhe në kategori të veçanta popullsia sezonale është përfshirë (për të dy njësitë administrative të Ksamilit dhe Sarandës).
Vlerësimi gjithashtu, bazohet në njësitë administrative për shkak të mungeses së të dhënave të detajuara nga (Cesnus për vendbanimet). Bazuar në këto të dhëna, propozimi i kërkuar për njësitë/sipërfaqet duhet të shpërndahet në vendbanime të ndryshme, duke ndjekur nevojat kryesore, potenciale dhe trendet e secilit. Në mënyrë paralele, kjo procedurë është në përqasje me synimin dhe rolin kryesor që ka secili vendbanim (në distancë: qendra administrative, qendra turistike etj) Një tjetër parametër i rëndësishëm është direktimi dhe parashikimi nga plani kombëtar (PPK dhe PINS Bregdeti) duke definuar strukturën e vendbanimit dhe hierarkinë e qendrës urbane.Këto direktiva janë specifikuar në nivel lokal dhe janë marrë në konsideratë nga PPV-ja. Së fundmi, një parameter bazë është shërbimi radius për të siguruar një shpërndarje më të mirë hapësinore dhe akses në shërbime

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Për arsye qartësie "njësitë hapësinore" të analizuara dhe fazat e vlerësimit janë të lidhura në këtë fazë me njësitë administrative bazuar në standarted e planifikuara per secilën. Meqë organizimi i propozuar për vendbanime është duke u organizuar në këtë mënyrë.

Njësi administrative Ksamil: (vendbanimet: Ksamil, Manastir)
Njësi administrative Sarandë: (vendbanimet: Saranda, Çuka, Gjashtë, Metoq, Shelegar)
Sipas projektimit të residencave per banorë në 2031 (projektim i grupit planifikues). Njësia e Ksamilit është përfshirë në kategorinë e parë (deri në 10.000 banorë), ndërsa njësia e Sarandës në kategorinë e dytë (mbi 10.000 banorë) të standardeve të planifikimit.(Tabela 17)

Tabela 24 Standardet e kërkuarapër shërbimet sociale në Shqipëri

Qendra e banuara	Sipërfaqe bruto banimi	Hapësire e gielbër	Kopsht, çerdhe, shkolla	Struktura për përdorim publik	Territor sportiv	Parkimi publik	Shërbim tregtar kufizuar	**Gjithsej**
	m^2/ban.	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**	**m^2/ ban.**
Deri në 10,000 banorë	25	5	4	2	1,6	6	5	**48,6**
Mbi 10000 banorë	**25**	**9**	**4,5**	**2**	**1,6**	**6**	**5**	**53,1**

Udhëzimet e përgjithshme për organizimin dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale hapësinore:

- Njësitë e reja / fushat e infrastrukturës sociale mund të gjendet brenda zonës ekzistuese të banimit, ose në zonat peri-urbane apo zgjerimet e propozuara (në varësi të llojit të shërbimit).
- Njësitë e reja / fusha mund të gjendet në komunale / e infrastrukturës publike, por kusht që të mos anulojë standardet minimale ekzistuese.
- Gjatë ndarjes së njësive të reja, është preferuar për të valorizuar infrastrukturën ekzistuese (ndërtesat komunale, aksionet tradicionale të ndërtimit, publik tokës etj) me qëllim të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore (konsumit të tokës, materialeve etj) dhe të vlerësimit të trashëgimisë kulturore.
- Gjatë ndarjes së njësive të reja, një nga qëllimet kryesore është përqendrimi hapësinor i shërbimeve sociale (nëse është e mundur) në strukturën e vendbanimeve, duke formuar bërthamat e vogla.

Ndarja e saktë / numri dhe madhësia e njësive të propozuara, parcelat dhe zonat mund të konsiderohen dhe të përcaktohen edhe nga niveli më i ulët i planifikimit (Planet Lokale të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

detajuara). Në çdo rast, PDV-ja nuk duhet të jetë në konflikt të ashpër me drejtimet / propozimet e PPV-së, nuk mund të jetë anulimin e standarteve minimale. Gjithashtu, disa nga njësitë e propozuara mund të kenë nevojë për studime fizibilitetit, ose analiza specifike dhe të hollësishme, para zhvillimit të tyre

Vlerësimi i standardeve të planifikimit (bashkia Sarandë) – Nevoja e tokës për infrastrukturë sociale dhe përdorimet urbane të tokës

Njësia Administrative e Ksamilit

Njësia Administrative e Ksamil përqëndrohet në hapësirë dhe në mënyrë periodike ka një përqindje të popullsisë sezonale (turistike, vizitorët dhe popullsinë vendase turistike). Projektimi i banesave dhe popullsia turistike ekzistuese është vlerësuar në bazë të përllogaritjes së berë nga grupi planifikues:

Tabela 25 Projeksionet e popullsisë + Të dhënat për përllogaritjen e popullisë së turizmit

Indikatorët	Njësia administrative
	Ksamil
Popullsia Rezidente e projektuar 2031	3083
Popullsi e rikthyer në periudhën e verës	3829
Pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore	150
Turistët (për ditë)	2000
Visitorë Ditorë	1000
Të punësuarit sezonal	145
Totali	**10207**

Planifikimi i propozuar i shërbimit social të specifikuar duhet të marrë në konsideratë nevojat totale të përdoruesve duke supozuar që këto shërbime duhet të planifikohen që të mbulojnë në të njëjtën kohë nevojat e gjithë popullsisë. Për këtë arsye, planifikimi standard per shërbimet e hapësirës së gjelbër (AR) Shëndetësore (SH) dhe Parkimi publik (IN) janë propozuar të bazohen në popullsinë rezidente në mënyrë paralele me turizmin total ekzistues/ popullsi sezonale për shkak të rolit turistik që ka njësia në kulmin e sezonit turistik.

Shërbim tregtar i kufizuar është propozuar të planifikohet, duke marrë në konsideratë nevojat vendase dhe turistike/ popullsinë sezonale duke përjashtuar kategorinë e "të punësuarit sezonal".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Në metodologjinë e propozuar, popullsia turistike ekzistuese është selektuar per planifikim, si një "status quo" e popullsisë. Çdo lloj konsiderate tjetër bazohet në projektimin e ardhshëm turistik që mund të përfshijë një shkallë të lartë pasigurie.

Opsionet e planifikimit për kategori:

Hapësirë e gjelbër (AR):

Rrjeti i hapësirave të gjelbëra dhe të hapura luan një rol të rëndësishëm ekologjik në përmirësimin e mikroklimës, komfortin klimatik dhe kontrollin e balancave të rrjedhave ujore. Ai gjithashtu rrit strukturën urbane dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës urbane dhe të imazhit të përgjithshëm të një zone, duke e bërë atë tërheqëse. Kuadri i ri ligjori ndan zonat e gjelbëra urbane në tri kategori të gjera:

- Gjelbërimi i përgjithshëm publik;
- Gjelbërimi i kufizuar publik;
- Gjelbërimi i veçantë.

Përdoruesit e kësaj kategorie janë vlerësuar:

Kategorite e Shërbimit	Kategoritë e shërbimit në përdorim të popullsisë nga:	Vlerësimi i përdoruesve
Hapësirë e gjelbër (AR)	Popullsia rezidente + popullsia e rikthyer në periudhën e verës + pronarët e banesave të destinuara për qëllime dytësore + turistët (për ditë) + visitore ditorë + të punësuarit sezonal	10.207

Lidhur me sigurimin e standardeve për "***Gjelbërimin e përgjithshëm publik***":

Çdo njësi (vendbanim) duhet të ketë hapësira publike për shërbime të nevojave të vendasve (kënde lojërash etj), pavarësisht popullsisë së saj. Në një situatë të tillë gjendja në njësinë e Ksamilit ka disa zhvillime me zhvillimin e hapësirave publike të kësaj kategorie ("kategoria a" sipas VKM-së). Kryesisht në Ksamil disa prej tyre janë kombinuar me disa hapësira te tjera publike (këndlojërash brenda lagjeve/ hapësirave të lira etj)

Në Manastir ka një mungesë të madhe të këtij lloj shërbimi. Për këtë arsye zhvillimi për realizimin e të paktën një këndlojërash për nënnjësi banimi është esencial. Prioritet duhet t'i jepet Ksamilit, i cili përqëndrohet me shumë në popullsi vendase. Për më tepër, nëpërmjet këtij Plani, njësitë e gjelbërta dhe hapësirat publike janë propozuar për zhvillimin në mënyrë që të arrijnë standardet minimale të kërkuara (bazuar në standardet e planifikuara).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT TIRANË SEKRETARIA

Njësia e qëndrueshme e një sheshi lojërash individuale është propozuar për të zënë 0,01 - 0,1 sipërfaqe ha, ndërsa hapësirat e tjera të hapura në nivel lagjeje janë propozuar për të zënë të paktën 0,1 - 0,5 ha për njësi. Një nga zgjidhjet e mundshme të projektimit është formësimin e hapësirave publike kombinuar zhvillimin e sheshit dhe shesh lojërash në të njëjtën njësi / zonë (sipërfaqe minimale totale: 0,1 ha).

• Standardi për hapësirat e gjelbra me gjelbërim masiv (p.sh. parqe dhe kopshte) është e rëndësishme për qendër urbane të Ksamilit. Sipas standardeve dhe vlerësimit, përdoruesit e sipërfaqeve minimale të nevojshme për formimin e një zone park është vlerësuar në rreth 1 ha. Njësia e qëndrueshme e një parku është propozuar për të zënë të paktën 0,5 - 1,5 ha.

• Sipërfaqja e përgjithshme e gjelbërimit në hapësirat e tjera publike (sheshe, shëtitoret, rrugët dhe bregdeti) duhet të rritet në sasi dhe cilësi. Më konkretisht, përmes planit, një rrjet i unifikuar i hapësirave të gjelbra është propozuar në strukturën urbane të Ksamilit. Ky rrjet mund të përfshijë sheshet, rrugët e këmbësorëve dhe shëtitoret bregdetare, formimin e një rrjeti të integruar transporti të qëndrueshëm, si dhe një faktor të rëndësishëm për përmirësimin e hapësirave publike në zonën urbane.

• Në lidhje me planifikimin e zonave park periferik, duhet theksuar se përmes planit të veçantë, zona që është propozuar të shërbehet përreth vendit natyror (zonë N.7) në zonën midis Ksamilit dhe Manastirit. Kjo zonë mund të përfshijë strukturat për objektet rekreative, kulturore, sportive, shtigjet për këmbësorë etj sipas legjislacionit. Megjithatë, në çdo rast strukturat e ndërtuara nuk duhet të zënë më shumë se 5% të sipërfaqes totale të parkut.


• Të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private,që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;

• rregullat e nënndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi:

• rregullat e sistemit rrugor dhe të transportit që përmbajnë, të paktën:

- përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor në përputhje me legjislacionin e

posaçëm, kushtet teknike dhe përmasat;
- parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit, sipas legjislacionit të posaçëm;
- përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë anëve të trupit të rrugës;
- rregulla arkitektonike, sipas rastit;
- rregullat për përdorimin e hapësirave nga "Personat me aftësi të kufizuara".

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, procesi i hartimit të PDV-së shoqërohet nga përgatitja e studimit paraprak të fizibilitetit, ku llogariten përqindje të përfitimeve nga zhvillimi, në mënyrë të drejtë dhe proporcionale me kostot dhe kontributin në zhvillim. Përfitimet, kontributi dhe kostot janë financiare ose të mira materiale që përfshijnë të drejtat për zhvillim dhe vlerën e rritur të tokës si rezultat i planifikimit ose investimeve publike.

4.6 Përcaktimet kryesore për termat e referencës për planet sektoriale

Dokumentat më të rëndësishme ku duhet bazuar hartimi i Planit Vendor Sektorial janë: Plani Vendor dhe Plani Kombëtar Sektorial. Pikëprerja e këtyre dy instrumentave përbën pikën e nisjes së hartimit të planit vendor sektorial. Nje elment tjeter, që duhet marrë në konsideratë është hartimi i buxhetit afatmesëm dhe afatgjatë i Bashkisë në zbatim të këtij plani. Plani Vendor sektorial, teksa hartohet e zbatohet, duhet të ndjekë parimet e planifikimit si një proces pune përherë në vazhdimësi. Autoriteti përgjegjës, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, përmbajtja e dokumentit të PVS-së, nisma për hartimin e PVS-së; hartimi i PVS-së, bashkërendimi i PVS-së, këshillimi dhe takimi publik në kuadër të PVS-së, botimi në regjistër i PVS-së, miratimi, hyrja në fuqi e PVS-së kryhen duke ndjekur si bazë procedurat e përcaktuara për PPVdhe PKS.

Disa nga planet sektoriale që duhet të hartohen në vijim të zbatimit të kësaj PPV-je janë:

1. Plani sektorial për një turizëm të qëndrueshëm:
Ky plan do të tentojë të përfshijë prioritetet në tipet e turizmit të cilat do të zhvillohen në zonë:

- Krijimi i formave të reja të turizmit natyror dhe kulturor dhe ekoturizëm, sport, aventurat në natyrë
- Prezantimi i vazhdueshëm i produkteve të reja alternative në programin e paketave turistike
- Eksplorimi i destinacioneve të turizmit arkeologjik-kulturor, Butrinti dhe Kanali i Vivarit.
- Rritja e segmentimit të tregut edhe nëpërmjet promovimit të trageteve
- Promovimi i turizmit kulinar me produkteve lokale të zonës Konispol-Sarandë-Ksamil

1- **Plani sektorial i transportit, fokusuar në transportin detar:**
Me qëllim dhënien e zgjidhjeve afatgjata për të përmirësuar dhe evidentuar fluksin e transportit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

privat dhe publik si dhe transportit te mallrave në bashkinë Sarande, nëpërmjet planit duhet të synojë:

a. Zgjidhje të skemës së transportit në çdo plazh dhe veçanërisht do të synojë promovimin e transportit alternativ, atë me taxi ujore përgjatë gjithë bregdetit si dhe gjithë sezonit turistik.
b. Mundësimin e krijimin e disa shtigjeve për biçikleta pergjatë vijës bregdetare nëpërmjet pedonaleve përgjate drejtimit Sarandë-Ksamil.
c. Promovimin e lëvizjës së gjelbër dhe uljen e emetimeve të vetëkarbonit në ajër
d. Promovimi i portit të Sarandës si port, por me synim për t`u zgjeruar si destinacion dhe për tragetet.
e. Lidhje më efiçente të zonave të brendshme me zonat përgjatë bregdetit, me qëllim që të kemi përmirësim të shërbimeve shëndetësore, arsimore dhe sociale përmes transportit publik.

2- Plani sektorial i menaxhimit të mjedisit:

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së mjedisit në bashkinë Sarandë dhe mbrojtjen e pasurive/burimeve natyrore si avantazhi me i fortë që kjo zonë ka. Ky plan duhet të përmbajë minimalisht:

a. Menaxhimin e zonës së mbrojtur Parku Kombëtar i Butrintit.
b. Menaxhimi i gjithë zonave të plazhit dhe i zonave portuale.

3- Plani sektorial i strehimit:

Ky plan synon të garantojë mundësitë vetëstrehimit të përballueshëm financiarisht për të gjithë popullsinë rezidente të bashkisë Sarandë.Ky plan duhet të përmbajë minimalisht:

a. Analiza të thelluara demografike, duke evidntuar edhe zonen informale të Bashkisë, analizen e zonave si dhe problematika të tjera, që ka kjo Bashki.
b. Analizë të thelluar mbi situatën aktuale të strehimit në bashkinë Sarandë, si dhe evidentimin e stokut të banesave të pa shfrytezuara.
c. Propozime të skemave të ndryshme financiare dhe rolit që duhet të luajë Bashkia për të garantuar strehim të përballueshëm.
d. Propozime konkrete mbi projekte komunitare me fokus strehimin social

4.7 Evidentimi i faktorëve që mund të shkaktojnë një rishikim të pjesshëm të PPV-ve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

PPV-ja është një dokument i cili hartohet nga Bashkia mbi bazen e kërkesave dhe zhvillimeve kombëtare nën drejtimin e AKPT-së bazuar në Ligjin 107/2014, dhe është dokumenti bazë udhëzues për zhvillimin në 15 vitet e ardhshme të territorit. Faktorët të cilët shkaktojnë rishikimin e PPV-se, sipas pikës2, të Nenit 26-të Ligjit 107/2014 janë konform procedurës që përcaktohet në të. Këta faktorë janë:

- Në rastin kur kemi ndryshime të caktuara territoriale si ndarje administrative që çon në ndryshime dhe në ndarje të re territoriale,
- Ne rastin kur kemi ndryshime të paparashikuara demografike, sociale dhe ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore,
- Në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Procesi i rishikimit dhe i miratimit të planit realizohet sipas përcaktime të vetëprocedurës së thjeshtuar në përputhje me nenin 14, të VKM- së 607,"Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit". Procedura e thjeshtuar është procedura, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatetet e procesit të rishikimit të dokumenteve të planifikimit sipas parashikimeve ligjore përkatëse. Përjashtim nga ky rregull përbëjnë planet e detajuara vendore.

Procedura e thjeshtuar, zbatohet kur:

- PPV-ja e bashkisë Sarandë do të rishikohet për çështje që nuk prekin qëllim e në përmbajtjen e saj dhe nuk cënojnë vlerat natyrore, cilësinë e mjedisit, zonat e mbrojtura, tokat bujqësore, biodiversitetin dhe trashëgiminë natyrore e kulturore;
- Rishikimi i rregullore vetë planifikimit nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale dhe me parashikime të vetë planit përkatës;
- Rishikimi i dokumenteve sipas pikës 1, më lart, shoqërohet me kritere apo kushte më të hollësishme sesa dokumenti në fuqi;
- Parashikohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial.

Përdorimi i procedurës së thjeshtuar ka për efekt përjashtimin e miratimit të nismës, si dhe përgjysmimin e afateve të përcaktuara për bashkërendimin e këshillimin dhe takimin publik sipas ligjit të planifikimit dhe akteve nënligjore përkatëse.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT TIRANË SEKRETARIA

5. SHTOJCA E PPV-VE

5.1. Vlerësimet për Planin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TEKSTI I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË____ MIRATOHET
KRYETARI I KKT-së

_____

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

_____

Miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë _nr. _____datë___
Hartuar nga: Bashkia_____
Subjekti i kontraktuar:_____
Subjekti mbështetës:___
Me financim të:_____

1. Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë			
	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
1.1	Sipërfaqja e njësisë vendore	7949.68 ha	Sipërfaqet natyrore, tokat bujqësore, tokat urbane, infrastruktura
1.2	Numri i popullsisë ekzistuese	20,227 banorë	Popullësia rezidenciale sipas INSTAT-it
1.3	Zona të rëndësisë kombëtare dhe zona të mbrojtura natyrore dhe kulturore	2651.60 ha	Parku kombëtar i Butrintit Kalaja e Lekursit Manastiri i Sarandës Monumente individuale të deklaruara
1.4	Siperfaqet e miratuara të zonave informale	20ha	Zonat e miratuara nga ALUIZNI
1.5	Problematika mjedisore	-	Mbrojtja e pejzazhit dhe e vijës bregdetare / kontroll i ndërtimeve

2. Propozime të PPV-së			
	Emërtimi	Vlera dhe njësia	Specifikime
2.1	Lloji i zhvillimit të pritshëm në 15 vitet e ardhshme	-	Form e mesme e turizmit masive (Hotele dhe Resorte) Zhvillime rezidenciale Aktivitete me interes të veçantë turistik
2.2	Përdorimet kryesore të propozuara të tokës	-	Rezidenciale, turizëm, bujqësi, gjendje natyrale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

2.3	Numri i popullsisë së pritshme shtesë në 15 vitet e ardhshme	700-1200 banorë	Vlerësimi sipas studimeve ekonomike dhe demografike
2.4	Numri total i turisteve te pritshem per 15 vitet e ardheshme	60.000 turistë	Duke përfshirë edhe emigrantë që kthehen, punësimet sezonale dhe banorë të shtëpive të dytë.
2.5	Sipërfaqja totale ekzistuese e urbanizuar	974.62 Ha	Sipas hartës orthophoto të vitit 2013 dhe 2015
2.6	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar për banim	198.62 Ha	Shtepitë kryesore dhe të dyta në zonat e zgjerimeve të vendbanimeve dhe zonat e reja
2.7	Sipërfaqja totale e ndërtimit e shtuar për zhvillimin e turizmit	42.63Ha	Zonat e projektimit turistik përfshirë kampingjet dhe aktivitet ekologjike
2.8	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit të shtuar jo për banim	65.68 Ha	Shërbimet dhe zonat e aktiviteteve
2.9	Sipërfaqe e përgjithshme e zonave në mbrojtje	6815.77 Ha	Monumentet natyrore dhe zonat e trashëgimisë natyrore, pejzazhet e mbrojtura (pejzazhet detare dhe kreshtat malore), ara dhe pejzazhe bujqësore-kulturore të mbrojtura
2.10	Sipërfaqe e përgjithshme e banesave për strehim social	0.5ha	
2.11	Sipërfaqe të gjelbra shtesë	59.13 Ha	Strukturat e hapësirave të gjelbëra dhe hapësirat e hapura urbane
2.12	Numri i njësive strukturore	317	Harta e njësive strukturore

3: Të dhëna financiare

	Emërtimi	Vlera dhe Njësia	Specifikime
3.1	Vlera e përgjithshme e planit të investimeve kapitale	153,914,208 Euro	Në përputhje me programin buxhetor afatmesëm
3.2	Fazat e zbatimit të zhvillimit	Çdo 5 vite ose periudhat përkatëse.	Të ndara në periudha brenda vlefshmërisë kohore, të planit për njësitë dhe nënnjësitë strukturore përkatëse\
3.3	Studimin teknik të parafizibilitetit		Argumentohet zgjidhja e propozuar dhe kostot e përafërta me zërat kryesore

4. Dokumenti i PPV-së për dorëzim

Nr	Kapitulli/Dokumenti	Hartohet / miratohet	Referenca Ligjore	Check list
1	Strategjia territoriale	Hartohet dhe miratohet	Sipas Nenit 52 i VKM-së 671, 29.07.2015	✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

2	**Analiza dhe vlerësimi i territorit**	Hartohet dhe miratohet	Sipas Nenit 53 i VKM-së 671, 29.07.2015	✓
3	**Parashikimet e planit**	Hartohet dhe miratohet si pjesë e planit	Sipas Nenit 54 i VKM-së 671, 29.07.2015	✓
4	**Vlerësimi strategjik mjedisor**	Hartohet dhe miratohet	Sipas Ligjit Nr. 91/2013	✓
5	**Materiali hartografik**	Hartohet dhe miratohet	Sipas Nenit 57 dhe Shtojca 1 e VKM-së 671, 29.07.2015	✓
6	**Rregullorja e PPV-së**	Hartohet dhe miratohet	Sipas Nenit 56 të VKM-së 671, 29.07.2015	✓

5. Hartat bashkëlidhur dokumentit të shkruar të PPV-së sipas rregullores së planifikimit

Nr	Tematika e hartës	Lloji i hartës	Shkalla	Kodi i Hartës	Check list
1.	Harta Bazë	Harta bazë vektoriale e njësisë vendore dhe topografia	1:25.000	1	✓
2.	Harta përjashtimore	Harta e elementeve përjashtuese	1:25.000	1a	✓
3.	Harta administrative	Hartë kufijtë administrative	1:25.000	1c	✓
4.	Harta topografike	Harta terrenit	1:25000	2	✓
5.	Hartat e elementeve ekzistuese të territorit	Harta gjeologo – inxhinierike	1:25.000	2a	✓
6.		Harta hidrogjeologjike	1:25.000	2b	✓
7.		Harta e rreziqeve gjeologjike	1:25.000	2c	✓
8.		Harta hidrografike	1:25.000	2d	✓
9.		Harta e burimeve natyrore	1:25.000	2e	✓
10.		Zonat e mbrojtura natyrore dhe kulturore	1:25.000	2f	✓
11.		Harta e bonitetit të tokës	1:25.000	2g	✓
12.		Rrezikshmëria sizmike	1:100.000	2h	✓
13.	Pozicionimi strategjik në raport me	Kufijtë territorialë në rajon; Identiteti historik, urban, ekonomik	1:100.000 1:300.000	3	✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

	rajonin				
14.	Vlerësimi ekonomik	Pozicionimi dhe përqendrimi i burimeve dhe poleve ekonomike lokale; elementet e konkurrueshmërisë; shpërndarja e sektorëve dhe e fuqisë punëtore.	1:100.000	4	✓
15.	Vlerësimi Social	Shërbimet sociale; shkollat; shëndetësia	1:25.000	5	✓
16.	Vlerësimi demografik	Përqëndrimi i popullsisë në territor	1:25.000	5a	✓
17.	Pronat	Përdorimi i pronave publike; problemet në marrëdhëniet e pronësisë në territor; zonat informale sipas llojeve dhe ecurisë së integrimit	1:25.000	7 7a	✓
18.	Harta e rëndësisë kombëtare	Zonat dhe strukturat	1:25.000	8	✓
19.	Problemet mjedisore	Vendndodhja e elementeve ndotëse dhe me ndikim negativ; Shkalla e ndikimit negativ të burimeve ndotëse në territor	1:25.000	9	✓
20.	Përdorimi ekzistues i tokës	Kategori bazë; funksionet dhe aktivitetet	1:25.000	10	✓
21.		Nënkategoritë; funksionet dhe aktivitetet	1:10.000	10a	✓
22.	Infrastrukturat	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm	1:25.000	11a	✓
23.		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza	1:25.000	11b	✓
24.		Rrjeti rrugor eksistues	1:25.000	11c	✓
25.		Rrjeti ekzistues i furnizimit me energji	1:25.000	11d	✓
26.	Cilësia fizike e strukturave	Nivelet e cilësisë; rekomandime për riparim, rigjenerim, rizhvillim.	1:25.000 1:10.000	12 12a	✓
27.	Tipologjitë hapësinore	Zona sipas njëtrajtshmërisë së llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes në parcelë dhe në territor, skemës rrugore dhe të hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave	1:25.000 1:10.000	13 13a 13b	✓
28.	Periferaliteti	Zona sipas largësisë nga qendra e zonës së banuar; largësisë nga qendrat e punësimit; lidhjes me sistemin rrugor; furnizimin me rrjete infrastrukturë dhe shërbime	1:100.000	14	✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

		sociale; nivelit të kriminalitetit; problemeve të ndryshme sociale			
29.	Elemente të veçanta territoriale	Objekte dhe struktura, natyrore apo artificiale, me ndikim në qytet dhe hapësirëformim	1:25.000	**15**	✓
30.	Metabolizmi Urban	Harta e fluksit të ujit	1:25.000	**16a**	✓
31.		Harta e fluksit të energjisë	1:25.000	**16b**	✓
32.		Harta e fluksit të mbetjeve	1:25.000	**16c**	✓
33.		Harta e fluksit të ushqimit	1:25.000	**16d**	✓
34.	Sistemet Territoriale – (situate eksistuese)	5 Sistemet territoriale	1:25.000	**17**	✓
35.		Sistemi urban	1:25.000	**17a**	✓
36.		Sistemi natyror	1:25.000	**17b**	✓
37.		Sistemi ujor	1:25.000	**17c**	✓
38.		Sistemi bujqësor	1:25.000	**17d**	✓
39.		Sistemi Infrastrukturor	1:25.000	**17e**	✓
40.	Vizioni strategjik i zhvillimit të territorit	Drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit; objektivat;fazat kohore të zbatimit të programeve.	1:25.000	**18**	✓
41.	Parashikimi i përdorimit të tokës	Harta e 5 sistemeve territoriale	1:25.000	**18a**	✓
42.		Harta e kategoritë bazë të përdorimit të tokës të propozuara	1:25.000	**18b**	✓
43.		Harta e nënkategoritë të përdorimit të tokës të propozuara	1:10.000	**18c**	✓
44.		Harta e zonave, poleve, korridoreve ekonomik të propozuara	1:25.000	**18d**	✓
45.		Harta e mënyrave të ndërhyrjes të propozuara	1:25.000	**18e**	✓
46.		Harta e tipologjisë së ndërtimeve	1:10000	**18f**	✓
47.		Harta e objekteve dhe zonave të rëndësisë kombëtare të propozuara	1:25.000	**18g**	✓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

48.		Harta e zonave subjekt i PDV-së të propozuara	1:25.000	**18h**	✓
49.		Harta e njësive strukturore	1:25.000	**18i**	✓
50.		Harta e shpërndarjes së popullsisë dhe plani i strehimit	1:25.000	**18j**	✓
51.	Shërbimet dhe infrastrukturat e propozuara	Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm të propozuar	1:25.000	**19a**	✓
52.		Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza të propozuar	1:25.000	**19b**	✓
53.		Rrjeti rrugor dhe vendparkimeve publike të propozuar	1:25.000	**19c**	✓
54.		Rrjeti i furnizimit me energji te propozuar	1:25.000	**19d**	✓
55.		Hapësirave publike, rrugëve të biçikletave dhe këmbësore të propozuar	1:25.000	**19e**	✓
56.		Objektet e shërbimeve sociale	1:25.000	**19f**	✓
57.		Transport Publik	1:25.000	**19g**	✓
58.	Instrumentet e drejtimit të zhvillimit	Harta e instrumenteve të zhvillimit të proposuara	1:25.000	**20**	✓
59.	Plani i veprimeve	Harta e fazimit të zhvillimit sipas njësive strukturore dhe sipas infrastrukturave;	1:25.000	**21**	✓

6. RAPORTI PËR KAPACITETET INSTITUCIONALE

Në kuadër të reformës së decentralizimit, përgjegjësitë e qeverive vendore janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme dhe të shumëllojshme. Me gjithë përparimin e bërë gjatë dekadës së fundit, sigurimi me efikasitet dhe përgjegjshmëri i shërbimeve cilësore publike në nivel vendor po përballet ende me sfida të konsiderueshme në aspektin e kapaciteteve të burimeve institucionale dhe njerëzore. Kapaciteti i kufizuar për të hartuar dhe zbatuar strategji të integruara të zhvillimit vendor dhe planeve të zhvillimit territorial, për hartimin e programit buxhetor afatmesëm vendor, aftësia për të trajtuar kompleksitetin rregullator dhe qëndrueshmërinë e strukturave të trajnimit kanë qenë disa nga sfidat kryesore për funksionimin e administratës së qeverisjes vendore.

Në kuadër të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë është i domosdoshëm angazhimi i një sërë sektorësh/departamentesh në vënien me sukses në praktikë të tij, duke qënë se planifikimi është një proces i vazhdueshëm dhe jo vetëm një koncept urbanistik. Në këtë kontekst, përfshirja e drejtpërdrejtë dhe marrja e përgjegjësive

institucionale gjykohet tepër thelbësore veçanërisht për sektorët që përballjen me zinxhirin e zbatueshmërisë së PPV-ve:

Drejtoria Juridike jep konsulencë juridike dhe këshillime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, që dalin gjatë aktivitetit dhe funksionimit të drejtorive dhe sektorëve të tjerë të aparatit të administratës së Bashkisë. Përbëhet nga 2 specialistë.

Drejtoria Ekonomike, së bashku me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorinë e Auditimit janë monitoruese të programit buxhetor dhe sigurohet që parashikimet e PPV-ve reflektohen në PBA. Monitoron situatën e buxhetit dhe çdo vit paraqet raportin për buxhetin ku ofrohen dhe rekomandimet përkatëse për zbatimin e planit. Monitoron të ardhurat të cilat gjenerohen nga Bashkia dhe të ardhurat të cilat vijnë drejtpërdrejtë nga parashikimet dhe zbatimi i PPV-ve. Në fund ofron rekomandimet përkatëse dhe ndryshimet e nevojshme në PPV-të.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbështet drejtori të e tjera në zbatimin e PPV-ve.

***Institucionet në varësi** të bashkisë Sarandë*. Secili institucion në varësi të bashkisë Sarandë koordinon me drejtorinë e planifikimit të territorit të Bashkisë zbatimin e PPV-ve si dhe të programeve përkatëse. Çdo vit, drejtoritë hartojnë raportet përkatëse të monitorimit, të cilat i paraqiten bashkisë Sarandë së bashku me rekomandimet specifike dhe konkrete.

Njësitë Administrative. Koordinojnë me drejtoritë e planifikimit dhe të kontrollit të territorit zbatimin e planit dhe monitorimin e tij. NjV-të ofrojnë shërbime këshilluese ndaj qytetarit.

6.1. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale të Departamentit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Sarandë.

Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor kërkon një qasje më realiste ndaj burimeve njerëzore, që disponon sot bashkia Sarandë. Funksione specifike, që lidhen me zhvillimin e turizmit dhe proceset e lejeve të ndërtimit për objekte të ndryshme turistike, të mëdha e të vogla, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e pranisë së arkitektëve/urbanistëve/planifikuesve të kualifikuar dhe ekspertë GIS, që do të kenë përgjegjësi kryesore në procese teknike, si dhënia e përshtatshmërisë apo aplikueshmërinë e legjislacionit në projekte. Po kështu, inxhinierët e mjedisit do të duhet të vlerësojnë të gjitha impaktet mjedisore, si dhe të ndjekin zbatueshëminë e VSM-së hap pas hapi me PPV-në.

Analiza mbi gjendjen e kapaciteteve institucionale të bashkisë së Sarandës arriti të dallojë se, mes kufizimeve, ato me ndikim më të ndjeshëm janë:

- Mungesa e kapaciteteve të specializuara dhe ekspertizës në pjesët e reja të territorit bashkiak, i cili është disa herë më i madh nga ai i që bashkia e vjetër e Sarandës administronte para reformës, duke përfshirë Ksamilin;

- Mungesa e përvojës institucionale në trajtimin e çështjeve urbanistike dhe të turizmit;
- Mungesat në të dhënat dhe informacionin mbi territorin e ri;
- Mungesat e njësive administrative në bazë materiale të domosdoshme për performancë efikase si PC, Printer, Software, etj.;
- Mungesa e kapaciteteve të plota të specializuara në hartimin e planeve sektoriale lokale të menaxhimit të zonave të mbrojtura e mbetjeve urbane, si dhe të planeve të detajuara vendore.

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka për detyrë përmbushjen e të gjitha detyrimeve tekniko - administrative që lidhën me shërbimet dhe veprat publike për komunitetin dhe t'i përmirësojë ato vazhdimisht duke programuar, planifikuar e monitoruar mirëmbajtjen e tyre, të ndërtojë strategjitë për programimin, planifikimin dhe implementimin e investimeve në veprat publike si dhe të harmonizojë gjithë veprimtarinë e enteve të ndryshme, veprimtaria e të cilave ka të bëjë direkt ose indirekt me shërbimet dhe veprat publike. Më specifikisht: (i) Mirëmbajtje dhe ndërtimin e rrugëve te reja; (ii) Ndërtimin e objekteve publike; (iii) Mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të ujrave të bardha, kanalizimeve të ujrave të zeza dhe impianteve të trajtimit të ujrave të larta. (iv) Ndërtimin e veprave hidraulike të kontrollit të përmbytjeve. (v) Krijimin e veprave të mbrojtjes hidrogjeologjike. Kjo drejtori përbëhet nga 11 punonjës, ndër ta janë: 2 specialistë infrastrukture, 1 specialist i kontrollit për shërbimet dhe investimet, 1 specialist i menaxhimit të tokës bujqësore, 1 specialist transporti, 1 specialist prokurimesh.

Drejtoria e Urbanistikës përbëhet nga Zyra e Studimeve dhe Projekteve me 1 specialist, Zyrën e Kadastrës Urbane me 2 specialistë, Zyra e Urbanistikës Ligjore me 1 specialist, Zyra e Infrastrukturës Inxhinierike me 2 specialistë dhe Sekretarinë Teknike me 1 specialist.

Drejtoria e Program Zhvillimit përbëhet nga 3 specialistë.

Drejtoria e Turizmit dhe Zyra e Informacionit Turistik përbëhet nga 3 specialistë.

6.1.1 Rishikimi i kontrollit dhe zbatimit të procedurave aktuale të zhvillimit e planifikimit të përdorura në Bashki.

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të bashkisë Sarandë nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi. Për këtë, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh janë hartuar dhe renditur në vijim. Këto rekomandime prekin si zbatimin e planit vendor, ashtu dhe ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për hartimin e Planeve Sektoriale, Planeve të Detajuar Vendore apo dhe Masterplaneve.

Mangësitë kryesore të vëna në dukje janë:
- Mosfunksionimi i regjistrit të të dhënave të lidhur me AKPT;
- Vështirësi në aplikimin online të lejeve të zhvillimit.
- Mangësi në ekspertë GIS dhe në përdorim GIS në Bashki

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Bazuar mbi gjetjet e mësipërme, gjykohet se një sërë masash do të mund të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Sarandë, sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij. Si më të rëndësishmet ndër të këto masa, renditen:

- Krijimi dhe formalizimi i databazës së informacionit

  - Gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Sarandë është krijuar një bazë e mirë informacioni, të cilën, Bashkia duhet ta mirëmbajë, ta përdorë me efikasitet dhe ta plotësojë në mënyrë vazhdueshme;
  - Të plotësohet databaza e informacionit dhe inventarizimit të pyjeve, kullotave, tokave bujqësore dhe elementeve të tjerë të klasifikueshëm që përfshihen në territorin e bashkisë Sarandë.
  - Të plotësohet baza materiale e vetë Bashkisë, si dhe e njësive administrative me pajisje të domosdoshme për arritjen e këtij objektivi si PC, Printer, software të nevojshëm si Autocad, GIS, etj.

- Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë në fushat më prioritare.

6.1.2. Rishikimi i nevojave të personelit dhe burimeve të Bashkisë, për të aftësuar strukturën ekzistuese të departamentit

Mbështetur në VKB –në e vitit 2015 për ndryshimin e funksioneve të komunave dhe përfshirjen e tyre në bashkinë Sarandë, është hartuar një VKB "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësive administrative 2016", si dhe me vendim te Kryetares të Bashkisë Sarandë "Për disa ndryshime në strukturën" është bërë miratimi i buxhetit për strukturën 2016. Struktura organizative e bashkisë Sarandë përbëhet nga 86 punonjës.

Që stafi i tanishëm i bashkisë së Sarandës të jetë një bërthamë funksionale me përvojë që garanton një proces koordinues efikas të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ka nevojë për specialistë mjedisi, arkitektë e urbanistë dhe ekspertë GIS. Kjo mungesë mund të reflektohet në probleme gjatë zbatimit të planit dhe projekteve të tij veçanërisht në njësi ku ka zona të ndjeshme me vlera dhe nën presion zhvillimi. Zyra e Urbanistikës të zgjerohet minimalisht me 4 ekspertë, nga të cilët: 1 duhet të jetë ekspert GIS-it, 2 të jenë arkitektë dhe 1 inxhinier ujërash. Të hapet Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit me 2 ekspertë inxhinierë mjedisi.

Departamenti i Projekteve të Huaja (*PIU - Project Implementation Unit*) është me 1 specialist, duhet të zgjerohet në 3 specialistë, që të kenë kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve, në research, në gjuhë të huaja dhe të kenë eksperienca të ngjashme të mëparshme. Ky departament mund të jetë me financim të Bashkisë ose në marrëveshje me donatorë të ndryshëm për të koordinuar punën në zbatimin e planit gjatë vitit të parë të zbatimit. PIU gjithashtu do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV-së.

Planifikimi proaktiv; takime me përfaqësuesit e komunitetit dhe grupeve të interesit për përgatitjen e planeve dhe raporteve. Bashkia e Sarandës synon të rrisë transparencën ndaj publikut dhe të përmirësojë shërbimet duke modernizuar dhe digjitalizuar një sërë shërbimesh të cilat lidhen me Bashkinë. Gjithashtu do të krijohen programe të cilat synojnë përfshirjen e qytetarit në hartimin e projekteve komunitare. Do të krijohen mundësi ku qytetarët të shprehin opinionin e tyre dhe dëshirën për hartimin e projekteve të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë.
Në planin afatgjatë, në vizionin e Bashkisë, pas ngritjes së kapaciteteve qëndrat me një ndalesë do të luajnë dhe rolin e katalizatorit përsa i përket planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në bashkëpunim me përfaqësitë komunitare do të ngrihen kapacitetet që të arrijnë të zhvillojnë projekte dhe më pas të zbatojnë ato. Qëndrat me një ndalesë gjithashtu do të konkurojnë me njëra- tjetrën për tërheqjen e financimeve nga Bashkia.
Ndihet e nevojshme ngritja e kapaciteteve për të gjithë stakeholders për procedurat e aplikimitonline te AZHT.

Nevoja për infrastrukturë dhe lehtësimin e kërkesave të agjensive të shërbimeve
Në kuadër të zbatimit të PPV-së, bashkia Sarandë duhet të hartojë një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme qeveritare si dhe me partnerë të tjerë lokale apo edhe me komunitetet. Një sërë marrëveshjesh ndërlidhen me:

- Marrëveshje në fushën e zhvillimit ekonomik, turizmit (me Agjencine Kombëtare të Turizmit dhe Agjencinë e Bregdetit) dhe zhvillimit rural;
- Marrëveshje me seksionin përkatës të Ministrisë së Bujqësisë për përmirësimin e cilësisë së tokës dhe të ruajtjes së tokës bujqësore;
- Marrëveshje në fushën e mjedisit me Agjencinë Rajonale të Mjedisit
- Marrëveshje me MZHU/AKPT për mbështetje në zbatimin e PPV-së;
- Marrëveshje në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar/ rajonal;
- Marrëveshje me ZRPP-në
- Marrëveshje me seksionin e Monumenteve të Kulturës në Ministrinë përkatëse.

Asistenca për procedurat e legalizimit-rregjistrimit të pronës dhe të ballafaqimit me cështjet e tjera të planifikimit dhe të zhvillimit. Kryetari i Bashkisë Sarandë ngre, me urdhër, grupin përbërës për shqyrtimin dhe këshillin teknik për lejet e ndërtimit. Grupi i ngritur me urdhër të kryetarit shqyrton dokumentacionin, si dhe përgatit me shkrim raportin teknik së bashku me rekomandimet dhe vërejtjet përkatëse për Kryetarin e Bashkisë. Grupi duhet të përbëhet të paktën dhe jo vetëm nga:

- Përfaqësues i Drejtorisë Ligjore (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Sektorit të Planifikimit të Territorit (2 përfaqësues, njëri prej tyre Kryetari i grupit të punës)
- Përfaqësues i Sektorit të Kontrollit të Territorit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Sektorit të Mjedisit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit (1 përfaqësues)
- Përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Infrastrukturës (1 përfaqësues)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

- Përfaqësues nga rajoni (për njësinë administrative Sarandë) ose përfaqësues nga Njësia Administrative ku aplikohet leja.

Grupi i punës mund të mblidhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e kërkesave për leje në mënyrë që të respektohen afatet ligjore përkatëse. Gjithashtu, për koordinimin e grupit të punës përdoret sistemi elektronik i lejeve.

6.1.3 Vlerësimi i nevojave të personelit dhe burimeve për hapësirën e departamentit.

Përsa i përket gjendjes fizike dhe pajimit, në këtë institucion mbetet shumë për t'u përmirësuar, veçanërisht në pjesën e teknologjisë dhe pajisjeve në dispozicion të stafeve teknike. Ndërkohë, përsa i përket njësive administrative nevojiten disa ndërhyrje në zgjerimin e mjediseve, në rregullimin dhe rikonceptimin e tyre për t'i bërë efikase e për t'u përshtatur me kërkesat e reja.

Më tej, lidhur me logjistikën që pritet të mbështesë bashkinë e Sarandës në zbatimin e PPV-së dhe kontrollin e zhvillimit të mëtejshëm të territorit, vlen të theksohet se do të nevojitet një përmirësim i kushteve të punës dhe përforcim i kapacitetit logjistik të Bashkisë me mjete transporti, të nevojshme për t'i bërë të gjitha territoret e reja, të përfshirë rishtaz nën këtë Bashki, të arritshme dhe menaxhueshme në kushte optimale.

6.1.4 Vlerësimi i aftësive të stafit ekzistues për të vepruar në departamentin e propozuar.

Gjatë procesit të punës për hartimin e Plani të Përgjithshëm Vendor, analiza e kujdesshme e kryer mbi aspektet institucionale të bashkisë Sarandë nxori në pah një sërë çështjesh kryesisht të lidhura me mangësi në aspektin e kapaciteteve institucionale. Prandaj, një sërë sugjerimesh dhe rekomandimesh, të hartuar dhe renditur në vijim, prekin ngritjen/përmirësimin e kapaciteteve institucionale të domosdoshme për veprim në departamentin e propozuar, si dhe do të kontribuojnë në rritjen e performancës së bashkisë Sarandë, sidomos në çështjet e territorit, administrimit dhe zhvillimit të tij.

Si më të rëndësishmet ndër to renditen:

Organizimi i trajnimeve të vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë në fushat më prioritare si më poshtë:

- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

6.2 Zhvillimi i kapaciteteve dhe Marrëveshjet e Zbatimit

6.2.1 Përgatitja e një raporti të shkurtër, që përcakton marrëveshjet e zbatimit, procedurat dhe strukturën e stafit të nevojshëm për zbatim

Marrëveshjet e ngritura në kuadër të zbatimit të PPV-ve mund të kenë si fokus disa çështje të ndryshme si:

- Marrëveshje për zbatim projektesh të përbashkëta,
- marrëveshje për monitorimin e situatës ekzistuese dhe plotësimin e databazës së të dhënave,
- marrëveshje për hartimin e planeve sektoriale vendore,
- marrëveshje për menaxhimin e hapësirave publike,
- ndërgjegjësimin e publikut
- ngritjen e kapaciteteve vendore
- monitorim të situatës mjedisore.

Pasurimi i Zyës së Urbanistikës minimalisht me 4 ekspertë, nga të cilët: 1 duhet të jetë ekspert GIS, 2 të jenë arkitektë dhe 1 inxhinier ujërash; hapja e Sektorit të Mbrojtjes së Mjedisit me 2 ekspertë inxhinierë mjedisi dhe Departamenti i Projekteve të Huaja (*PIU - Project Implementation Unit*) me 3 specialistë, që të kenë kualifikim të nevojshëm në hartimin dhe menaxhimin e projekteve do të shërbejë edhe në ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve vendore për zbatimin e PPV-ve.

6.2.2 Korniza e zbatimit, e cila përdor gjetjet nga pika 4.1 dhe identifikon fazën, në të cilën shkrihen propozime organizative, administrative dhe politike dhe/ose ndryshime që mund të prezantohen.

Reforma territoriale e ka vendosur bashkinë e Sarandës në një status krejt të ndryshëm përsa i takon hapësirës gjeografike-administrative në juridiksion, e si rrjedhojë problematikave dhe kompleksitetit të tyre. Vetëm fakti që bashkia e Sarandës ka tashmë në përgjegjësinë e vet edhe hapësira jo urbane, zona rurale dhe toka me përdorime bujqësore, është një sfidë e konsiderueshme për punën e përditshme të këtij institucioni. Si rrjedhojë, këto ndryshime të mëdha dhe nevojat tepër të ndryshme të qytetarëve dhe të territorit në zhvillim, kërkojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale në të tjera nivele, për të përballuar me sukses realizimin e këtij Plani të Përgjithshëm Vendor.

Sipas Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020, fuqizimi i administratës vendore është një objektiv kryesor në sukesin e një sërë reformave. Veçanërisht një sfidë e madhë është ajo e zbatimit të planeve të përgjithshme vendorë. Strukturat e bashkive të reja po rishikohen në mënyrë që të përshtaten me ndryshimet e reja, për të siguruar koherencë të mirë mes politikave të hartuara dhe të zbatuara në nivel vendor. Performanca e kërkuar dhe kapaciteti adekuat i administratës vendore do të arrihen përmes

promovimit të të mësuarit të vazhdueshëm dhe trajnimeve afatshkurtër dhe afatgjatë. Trajnimet e vazhduara dhe plotësuese të stafit të Bashkisë duhet të organizohen në fushat më prioritare si në:

- Planifikimi dhe menaxhimi i territorit;
  - Hartim politikash zhvillimi
  - Përdorimi i instrumentave të drejtimit të zhvillimit
  - Përdorim i GIS-it dhe i Regjistrit të Territorit
  - Menaxhim projektesh
  - Rregulla të përdorimit të tokës

- Trajtim i çështjeve sociale (duke përfshirë konfliktin mbi pronën, etj.)
- Zhvillim rural dhe menaxhimin e pasurive natyrore;
- Menaxhim të pasurive ujore (lumenj, rezervuarë etj.)
- Turizëm dhe guida turistike;
- Menaxhim i rreziqeve natyrore;
- Transport (publik) dhe lëvizshmëri e butë.

Tabela 27 Modulet e trajnimit

Module trajnimi	Përmasat	Kosto e trajnimit	Fazat e zbatimit			Institucionet përgjegjëse	Burimet / Ekspertët	Përfituesit
			I: '16 - 20'	II: '21 - 25'	III: '26 - 31'			
Aplikimi i instrumentave tatimore mbi tokën në përputhje me ligjin e urbanistikës	2 herë në vit	30,000				Bashkia Sarandë AKPT MZHU	Ekpertë tatimorë, ekspertë të urbanistikës dhe ekspertë ligjorë.	Kalimi në Këshillin Bashkiak i të paktën dy instrumentave tatimorë për menaxhimin e taksave të pronës dhe turizmit dhe trajnimi i stafit 2 herë në vit.
Vendosja e rregullave për funksionimin e aktiviteteve argëtuese	Min 5 trajnime të vazhdueshme	5,000				Bashkia Sarandë	Ekspertë turizimi, mjedisi, tatimorë.	Departamentet e mjedidit, turizmit, taksave, infrastrukturës dhe punëve publike.

Promovimi i një programi riciklimi nga Bashkia	–	20,000	Bashkia Sarandë PPP	Ekspertë mjedisorë dhe ekspertë riciklimi	1- Komuniteti rrit ndërgjegjësimin ndaj çështjeve të ruajtjes së mjedisit. 2 - Specialistët e mjedisit në Bashki
Promovimi i peshkimit dhe produkteve të peshkut	–	15,000	Ministria e Bujqësisë Ministria e Mjedisit	Ekspertë marketing dhe ekspertë të kultivimit të peshkut	Specialistë të bashkisë dhe bizneset qe operojnë
Marketimi dhe brandimi i produkteve lokale (vaji i ullirit në Ksamil, Mandarina në Konispol, etc)		20,000	Bashkia Sarandë Bashkia Konispol Ministria e Bujqësisë Agjensia Kombëtare e Turizmit	Ekspertë marketingu dhe vecanërisht ekspertë të manaxhimit të markave/brandeve	Fermerët apo prodhuesit e 5 produkteve Bio të zonës (vaji i ullirit në Ksamil , midhjet, frutat e detit, Mandarina në Xarre, limona ne Konispol, etc). 50 familje fermere të vetëpunësuara
Përmirësimi i kapacitetve të bashkisë në zhvillimin e projekteve dhe tërheqjen e fondeve.		50,000	Bashkia Sarandë	Ekspertë për aplikim në projektet IPA, Cross Border.	Specialistët e departamentit të projekteve të huaja (PIU)
Përmirësimi i kapacitetve për zbatimin e planit dhe aplikimin e PDV		30,000	AKPT/MZHU	Ekspertë të urbanistikës, të infrastrukturës dhe ekspertë GIS	Specialistët e Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Territorit

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

Aplikmi i instrumente ve tatimore mbi tokën në përputhje me ligjin e urbanistikë s	2 herë në vit	30,000	Bashkia Sarandë AKPT MZHU	Ekpertë tatimorë, ekspertë të urbanistikës dhe ekspertë ligjorë.	Kalimi në Këshillin Bashkiak i të paktën dy instrumentav e tatimorë për menaxhimin e taksave të pronës dhe turizmit dhe trajnimi i stafit 2 herë në vit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

7. DËGJESA ME PUBLIKUN

U zhvillua në datë 08.12.2016, ora 18:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë. Prezantimi i planit u bë nga eksperti, Z. Thanos Pagonis. Kryetarja e Bashkisë evidentoi rëndësinë e hartimit të planit dhe vlerësoi punën e bërë nga ekspertët, i kërkoi pjesëmarrësve të jenë bashkëpunues dhe të japin mendimet e tyre në shërbim të hartimit të një plani sa më efektiv.

Bebi Stefani, ndërtues kërkoi informacion lidhur me zhvillimin e transportit publik në territorin e Bashkisë dhe evidentimin e pronave publike.

Theodhori Dukshi, përfaqësues i medias kërkoi shtimin e plazheve publike, si dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik dhe të turizmit.

Lluk Dedi, drejtor në Bashkinë Sarandë falenderoi për lejimin e rrugës 6. Ai kërkoi realizimin e planit të shëtitores nga Hotel Butrinti deri në kanalin e Çukës. Ju bënë sqarimet nga ekspertët, Z. Thanos Pagonis dhe Z. Emil Xhuvani se, ndërtimi i shëtitores ka një dëmtim të theksuar mjedisor, por do të bëhet me zgjidhje të pjesshme.

Albert Piro, ndërtues përsëriti çështjen e zhvillimit të shëtitores, si një domosdoshmeri pa u futur në det.

Zoica Koca, inxhiniere e programacionit në bashkinë Sarandë argumentoi pse ndërtimi i shëtitores është investimi numër 1, që duhet bërë në bashkinë Sarandë. Ajo kërkon të merren parasysh të gjitha studimet, që janë bërë më parë.

Taqo Lapa, biznesmen në hoteleri kërkoi rritjen e kapaciteteve turistike, sidomos shtimin e plazheve, rregullimin e trafikut, hapjen e rrugës së nënstacionit elektrik, zgjerimin e trotuareve. Ai mendon se, duhet një prezantim më i mire i hartave. Në zonën e kanalit të Çukës të lejohen ndërtimet.

Jorgo Kore, biznesmen, kërkoi të informohej se cili është vlerësimi ekonomik i turizmit dhe, nëse do të certifikohet ky plan me standartet evropiane.

Feruz Shabani, gazetar kërkoi të informohej se cfarë rregullon ky plan dhe se cfarë do të ndodhë me zonën e mbrojtur të Ksamilit.

Figura 15 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë

Figura 16 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë

Figura 17 Foto nga takimi në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Sarandë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

Forumi

U zhvillua në datën 07.12.2016, ora 11:00, në Hotel Mondial. Morën pjesë përfaqësues të bashkive të LOT 6 dhe të bashkive kufitare, të Agjensisë së Zonave të Mbrojtura, të Ministrisë së Kulturës, të AKPT-së, të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Bujqësisë, të Agjensisë së Zhvillimit të Rajoneve, të Qendrës Rajonale të Mjedisit, të GIZ-it dhe ekspertët e LOT 6.

Sipas përfaqësuesit të bashkisë Sarandë, plani ka pasqyruar kërkesat e Bashkisë, por ata nuk janë dakord me kushtet e parcelës. Porblematika e ndërtimeve informale u prezantua nga Bashkia si një çështje që kërkon zgjidhje në bashkëpunim me ALUIZNI-n.

Drejtoresha e AKPT-së, znj. Adelina Greca, lidhur me zonën Sarandë-Konispol, ra dakord me parkun në fushën e dikurshme të aviacionit. Sipas saj, zhvendosja e varrezave të Sarandës është e vështirë e mund të krijojë probleme sociale.

Koordinatorja në AKPT për LOT6, znj. Fiona Mali pyeti për propozimet e zhvendosjes së landfillit të vjetër. Përgjigja ishte: Afër kufirit të Bashkisë. Landfilli aktual është në Bajkaj dhe Himara e Konispoli i dërgojnë mbetjet në Bajkaj.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës sugjeron të ketë ekstriksione të forta për zonën tampon rreth Butrintit, rrënojave të Butrintit dhe liqenit të Butrintit.

Përfaqësuesi i Agjensisë së Zhvillimit të Rajoneve u interesua për projektet e rëndësishme të infrastrukturës, ra dakord për siluetat mbajtëse, u interesua për komunikimin dhe mundësinë e lidhjes mes fshatrave dhe bashkive, u interesua për rrugët e reja ndërrajonale të propozuara.

Përfaqësuesi i Qendrës Rajonale të Mjedisit u interesua për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe presionin e periudhës turistike, ku manaxhimi i ujërave është i papërballueshëm. A i ka kushtuar vëmendje vlerësimit strategjik mjedisor intensifikimit të rritjes urbane?
Përgjigja - Vlerësimi strategjik mjedisor dhe metabolizmi kanë marrë në konsideratë rritjen e e popullsisë dhe pikun e sezonit turistik. Fshatrat e largët do të grupohen dhe do të lidhen tubacione, ndërsa për shtëpitë e veçuara do të përdorin gropa septike.

Sipas përfaqësuesit të Ministrisë së Bujqësisë u deklarua se, duan të zhvillojnë akuakulturën. Nevojitet infrastrukturë turistike. Mungon sistemi ujor dhe rrjeti i kanaleve. Plani duhet ta orientojë zhvillimin e turizimit.

Përfaqësuesi i bashkisë fqinje, Gjirokastrës. Është një plan i mirë. Për pozicionin e aeroportit duhet të merret një vendim se, ku do të jetë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TRETË TIRANË SEKRETARIA